nxënësve. Vazhdimisht nxënësit vlerësohen në mënyra të ndryshme varësisht nga qëllimi

për çfarë përdoret vlerësimi. Me vlerësim nuk duhet të nënkuptohet vetëm nota në fund,

vlerësimi i nxënësve duhet të bëhet vazhdimisht, sepse ai është pjesë përbërëse e

mësimdhënies siç thonë Shermis & Di Vesta (2011:83) vlerësimi duhet të shikohet si një

“pjesë e brendshme” e mësimdhënies jo si një “shtojcë e ndarë” nga mësimdhënia.

Të qenit të motivuar është një element shumë domethënës për suksesin e nxënëve. Nxënësit

e domotivuar nuk paraqesin interesim gjatë orës mësimore dhe është shume e vështirë,

ndonjëhere edhe e pamundur për ti motivuar dhe për ti angazhuar në mësim. Ndërsa nga

ana tjetër, nxënësit e motivuar janë ato të cilët shkojnë me dëshirë në shkollë, dëgjojnë

mësuesin me vëmendje, janë aktiv gjatë orës mësimore, janë të gatshëm për të zgjedhur

detyrat në klasë, me dëshirë kryejnë detyrat e shtëpisë, si rrjedhojë këto janë nxënësit që

janë edhe më të sukseshëm. Në motivimin e nxënësve ndikojnë shume faktor, si faktor

jashtë klase ashtu edhe faktor brenda klasës. Jo, të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në

motivimin e nxënëve janë në dorën e mësuesve ose nxënësve. Për këtë arsye, ato duhet të

mundohen ti vënë në përdorim efikas ato faktorë të cilët i posedojnë. Një nga faktorët që

mund të ketë një ndër ndikimet kryesore në motivimin e nxënësve është vlerësimi i tyre nga

ana e mësuesve. Vlerësimi në përgjithësi mund të ketë ndikim në motivimin e nxënësve,

llojet dhe metodat e ndryshme të vlerësimit mund të ndikojnë në mënyra të ndryshme në

motivimin e nxënësve, ato mund të ndikojnë edhe pozitivisht edhe negativisht në motivimin e nxënësve. Vlerësimi i nxënësve duhet të bëhen më mënyrë sa më profesionale që të jetë e mundu për ta përdorur atë si një mjet që do të ketë ndikim pozitiv për motivimin e nxënësve për të mësuar. Edhe puna e mësuesit është më e lehtë dhe në të njëjtën kohë edhe më frytëdhënëse kur nxënësit janë të motivuar për mësim.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Vlerësimi i nxënësve mund të konsiderohet si një pjesë delikate e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, që mund të ndikojë drejtëpërdrejtë në mbarëvajtjen e këtij procesi si dhe në marrëdhënien që krijohet midis mësuesit dhe nxënësve. Për më tepër, vlerësimi mund të jetë një faktorë i rëndësishëm që mund të ndikojë në krijimin e personalitetit të nxënësve duke ndikuar në motivimin e nxënësve për të mësuar dhe dëshirën e tyre për të shkuar në shkollë. Qëllimi i këtij studimi është të trajtoj ndikimin që mund të ketë vlerësimi formues në motivimin e nxënësve për të mësuar. Relizimi i qëllimit të këtij studimi bëhet përmes përdorimit të instrumenteve të shfrytëzuara për këtë studim, analizimit të përgjigjeve të mësuesve dhe nxënësve në pyetjet e pyetësorëve dhe intervistave përkatëse dhe gjithashtu opinionit të prindërve të dhënë në përgjigjet e pyetësorit për prindërit. Të dhënat e marra nga çeklistat e përdorura gjatë vëzhgimeve në orët mësimore dhe rezultatet e studim rastit shërbejnë gjithashtu në realizimin e qëllimit të këtij studimi, për të parë ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve për mësim.

Për të patur një atmosferë të përshtatëshme për mësim duhet të ketë një frymë pozitive brenda klasës. Qëllimi i vlerësimi formues nuk është thjeshtë të vlerësoj nxënësit me një notë, por të jetë në funksion gjatë gjithë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, pra ti kenë nën vëzhgim dhe ti vlerësoj nxënësit vazhdimisht, për t'ju dhënë nxënësve një fitbek

për punën e bërë në një detyrë të caktuar, për të informuar nxënësit me përparësit dhe mangësit që mund të kenë dhe për ti shfrytëzuar ato si pikë referimi për të ardhmen. Testet që përdoren për vlerësim formues mund të realizohen thjeshtë për të identifikuar problemet dhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit, pa patur për qëllim vlerësimin e nxënësve me notë (Garo, 2013: 198). Garo (2013: 171) gjithashtu thonë se nota mund të ketë efekte negative të nxënësit dhe një nga këto efekte negative është ndikimi negativ që mund të shkaktoj nota në motivimin e nxënësve. Faktorët të cilët ndikojnë në motivimin e nxënësve për të mësuar janë të shumtë si brenda ashtu edhe jashtë klasës. Gjinia mosha dhe suksesi i nxënësve janë tre nga faktorët që mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve. Këto tre faktor janë marrë në konsideratë për t'u analizuar duke shfrytëzuar të dhënat e marra nga studim rasti. Qëllimi i të cilit ishte për të studiuar ndikim e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve gjatë orëve të gjuhës angleze. Të dhënat e marra për nxënësit dhe analizimi i nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues jepin rezultatin e ndikimit të vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në klasë. Por, të dhënat e marra gjatë studimit u përdorën gjithashtu për të analizuar ndikimin që mund të ketë mosha, suksesi dhe gjinia e nxënësve në motivimin e nxënësve, pra për të parë nëse ekziston korrelacion midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre, suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre, si dhe gjinisë dhe nivelit të motivimit të nxënësve. Të gjithë faktorët që ndikojnë në motivimin e nxënësve si faktorët brenda klasës, por edhe ato jashtë klasës mund të ndikojnë gjithashtu edhe në suksesin e nxënësve.

1.3.Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Metodologjia që përdoret për realizimin e këtij qëllimi është e gjërë duke përfshirë përgatitjen dhe përdorimin e pyetësorëve, intervistave, vëzhgimeve gjatë orëve mësimore si

dhe realizimin e një studim rasti. Metoda për mbledhjen e të dhënave e përdorur në këtë studim është metodë mikse, pasi që në studim janë përdorur të dhëna të mbledhura me anë të pyetësorëve, të dhëna të cilat mund të paraqiten në mënyrë numerike por gjithashtu në studim janë aplikuar edhe intervistat, që japin të dhëna cilësore, ato paraqesin opinionin e të intervistuarve në mënyrë më të zgjeruar. Të dhëna cilësore gjithashtu u mbledhën edhe gjatë vëzhgimeve në orët mësimore. Studimi përfshiu gjashtë shkolla fillore të Strugës. Mendimi i mësuesve, nxënësve dhe prindërve për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve paraqitet përmes përgjigjeve të tyre në pyetësorët përkatës me mundësi të shumëfishta për përgjegje në të gjitha pyetjet e pyetësorëve. Mësuesit dhe nxënësit si dy ndër faktorët të përfshirë për çdo ditë dhe në mënyrë më të drejtëpërdrejtë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, japin mendimin e tyre në mënyrë më të zgjeruar në pyetjet e intervistave. Të dhënat e mbledhura nga vëzhgimet paraqesin të dhëna të marra në teren për aplikimin e vlerësimit gjatë orëve të ndryshme mësimore. Të dhëna për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve mirren nga studim rasti që zgjati 4 muaj, ku morën pjesë 115 nxënës të shkollës fillore „Nuri Mazari” Dollogozhdë, Strugë.

1.3.1. Hipotezat e studimit

Studimi ka një hipotezë kryesore:

1. Vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve për të nxënë në gjuhën angleze.

dhe një nën hipotezë:

1.1. Vlerësimi formues ka të njëjtin ndikim në motivimin e të gjithë nxënësve.

1.3.2. Pyetjet kërkimore

1. A ndikon vlerësimi formues pozitivisht në motivimin e nxënësve për të nxënë në gjuhën angleze?
2. A ekziston korrelacion midis eksperiencës në punë të mësuesve dhe mendimit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësin për mësuesit
3. A ekziston korrelacion midis gjinisë së nxënësve dhe mendimit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësin për nxënësit?
4. A ekziston korrelacion midis klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe mendimit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësin për nxënësit?
5. A ekziston korrelacion midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre?
6. A ekziston korrelacion midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre?
7. A ekziston korrelacion midis gjinisë së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre?

1.3.3 Variablat e studimit

Formulimit i hipotezës së studimit, e cila paraqet korrelacionin që mund të ekzistoj

ndërmjet vlerësimit formues dhe motivimit të nxënësve, paraqet edhe variablat e studimit.

Vlerësimi formues është variabli i pavarur në këtë studim, ndërsa *motivimi i nxënësve* është variabli i varur. Pra, motivimi i nxënësve në klasë mund të ndikohet nga vlerësimi formues, i cili, paraqitet si një variabël nominal, ndërsa motivimi i nxënësve paraqitet si variabël ordinal, pasi që nxënësit ndahen në grupe në bazë të nivelit të motivimit që ato kanë. Për tre pyetjet e fundit kërkimore *motivimi i nxënësve* është variabël i varur ndërsa, *mosha*, *suksesi* dhe *gjinia* e nxënësve janë variabël të pavarur.

1.4. Stuktura e tezës

Kjo tezë është organizuar në katër kapituj Kapitulli I: Hyrje, Kapitulli II: Skeleti teorik dhe modeli analitik i tezes, Kapitulli III: Analiza e rezultateve, Kapitulli IV: Përfundimet, Referencat dhe Shtojcat.

Kapitulli i parë, Parathënia, prezanton dhe shpjegon problematikën e studimit, qëllimin dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore, përmbledhje të shkurtër të literaturës si dhe përmes përshkrimit të shkurtër të metodologjisë jep edhe argumentet kryesore. Pra, ky kapitull është një përmbledhje rreth studimit.

Kapitulli i dytë, Skeleti teorik dhe modeli analitik i tezes, paraqet përshkrimin e literaturës të përdorur në punim në mënyrë më të detajuar duke përmendur konceptet kryesore që janë përdorur në punim. Ky kapitull përfshinë gjithashtu një përshkrim më të detajuar të metodologjisë që përdoret në këtë punim, duke përshkruar strategjinë e përdorur, përshkrimin e pjesëmarrësve në studim, dhe organizimin e studim rasti, si pjesë e kësaj teze.

Kapitulli i tretë është kapitull i analizës që paraqet gjetjet nga puna në teren. Fillimisht paraqet dhe analizon rezultatet e të dhënave të marra nga intervistat e mësuesve dhe nxënësve të intervistuar për këtë studim, pjesa e dytë e analizës bënë paraqitjen dhe analizimin e të dhënave të marra nga pyetësorët e mësuesve, nxënësve dhe prindërve, në pjesën e tretë bëhet paraqitja dhe anaizimi i të dhënave të marra me çeklista nga vëzhgimet e kryera në klasë dhe në pjesën e katër të analizës, bëhet paraqitja dhe analizimi i të dhënave të marra nga studim rasti i realizuar për këtë kërkim.

Kapitulli i katërt, Përfundimet, është një përmbledhje e detajuar e pjesëve kryesore të temës e bazuar mbi rezultatet dhe analizën e të dhënave si cilësore ashtu edhe atyre sasore.

Referenca paraqet listën e literaturës së përdorur.

Shtojcat paraqesin pyetjet e intervistave të mësuesve dhe nxënësve, pyetësorët e mësuesve, nxënësve dhe prindërve, çeklistat e përdorura gjatë studimit, dhe tabela të rezultateve nga studim rasti.

1.5. Problemet e parashikuara

Studimet kërkimore trajtojnë tema aktuale dhe përfshinë në studim pjesëmarrës të ndryshëm, për këto arsye ato ballafaqohen si me problem që mund të parashikohen që para fillimit të studimit ashtu edhe me problem që studiuesi has gjatë studimit. Për të patur një organizim sa më të mirë të studimit bëhet parashikimi i problemeve të mundshme, që mund të ndodhin gjatë studimit. Parashikimi i problemeve para kohe është masë preventive që ndalon që të ndodhin ato problem, ose mund të parashikohet një zgjidhje për problemet e mundshme.

Gjatë këtij studimi ekziston mundësia për paraqitjen e disa problemeve. Një prej tyre mund të jetë kontakti me pjesëmarrësit. Numri i pjesëmarrësve në këtë studim nuk është një numër i vogël dhe për më tepër pjesëmarrësit janë nga vendbanime të ndryshme. Për këtë arsye fillimisht u organizuan takime me drejtorët dhe disa nga mësuesit, të cilët punojnë në shkollat pjesëmarrëse në këtë studim, atyre iu shpjegua qëllimi i studimit kërkimor si dhe mënyra e menduar e metodave që do të aplikoheshin gjatë studimit. Këto njerëz të informuar për organizimin e studimit ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij. Problem tjetër mund të jetë plotësimi i pyetësorëve. Pjesëmarrësit në studim mund të mos jenë të mësuar më plotësimin e pyetësorëve. Për të evituar këtë problem, në formë të shkruar, në fillim të çdonjërit nga pyetësorët, janë dhënë informacione për mënyrën e përdorimit të pyetësorëve.

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEZËS

2.1 Pasqyra e literatures

Në përgjithësi jeta e njerëzve është dinamike, gjithmonë në lëvizje dhe e mbushur me plot ndryshime, të cilat ndodhin në të gjitha sferat e jetës. Procesi arsimor, si një nga fushat më të rëndësishme në jetën e njerëzve ndryshon gjithashtu, duke aplikuar gjithmonë metoda të reja për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Komplexiteti dhe shumëdimensionaliteti i ndryshimeve shoqërore-politike në Republikën e Maqedonisë drejtëpërsëdrejti reflektohen edhe në strukturimin, funksionimin dhe organizimin e sistemit arsimor (Murati, 2004: 384). “Qeveria luan një rol kritik në aplikimin e reformave gjërësisht” (Fullan, 2007, 324). Mësuesit duhet ti aftësojnë nxënësit që të mundohen të gjejnë zgjidhje për sfidat që mund ti hasin, nxënësit duhet të përpiqen “që të dinë se çfarë të bëjnë, në situata kur ato nuk e dinë se çfarë duhet të bëjnë” (Claxton, 1998, e cituar në: Weeden, Winter and Broadfoot, 2002: 9). Nxënësve nuk duhet ti servohen zgjedhje të gatshme për çfarëdolloj problemi, por ato duhet të pregatiten që të ballafaqohen vetë me problemet. “Vetëm një njeri i paisur me dijet e duhura është në gjendje të përpunojë më tej informacionin dhe ta përdorë atë për të ndërtuar dije të re” (Nathanaili, 2013: 3). Informacioni që i jepet nxënësve duhet të jetë i përshtatshëm për nivelin e nxënësve dhe për qëllimet e lëndës mësimore, gjithashtu edhe mënyra e vlerësimit duhet të zgjidhet dhe përdoret me kujdes nga ana e mësuesve, sepse suksesi i nxënësve që paraqitet përmes vlerësimit të dhënë nga mësuesit, ndikon në krijimin e një vetëbesimi te nxënësit, ndjesi e cila i motivon nxënësit për të patur sukses. “Suksesi nuk i vë nxënësit në siklet, por përkundrazi mund ti çojë drejt një vetëbesimi më

të madhe si në situata akademike ashtu edhe në situata sociale”(Jensen,2003: 3). Kraja (2006) “është thënë se të nxënit është një proces i motivuar”, për më tepër, ai thotë se fëmijët mësojnë nga interesi dhe kureshtja që kanë jo nga tendenca për të kënaqyr të rriturit” (Kraja, 2006:246-247).

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është proces i gjatë i përbërë nga disa pjesë.

Vlerësimi i nxënësve është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi sepse finalizon rezultatet e punës së mësuesve, si dhe angazhimit dhe përpjekjes së nxënësve për të arritur sukses.

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është dinamik, vlerësimi si pjesë e këtij procesi vazhdimisht ndryshon me aplikimin e metodave dhe teknikave të reja. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies përbëhet nga disa pjesë dhe vlerësimi është një prej tyre.

“Qëllimi kryesor i përdorimit të vlerësimit duhet të jetë për të mbështetur të nxënit”.

(Black and Ëiliam, e cituar në: Gardner, 2012: 11). “Të nxënëit është një proces kompleks.”

(Broadfoot, Weeden &Winter, 2002: 9). “Të nxësh, do të thotë të përdorësh njohurit e mëparshme” (Karameta 2014: 83). Si pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimi është studiuar nga autor librash dhe studiues të ndryshëm, të cilët kanë paraqitur rezultatet e punës së kryer nga vetë ato në lidhje me vlerësimin, në libra, në artikuj revistash dhe në punime të tyre. Mënyra e kontrollimit dhe vlerësimi të njohurive të nxënësve ka kaluar një rrugë të gjatë me ndryshime në bazë të ndryshimeve që kanë ndodhur në pjesët e tjera të procesit të edukimit. “Kontrollimi i parë është konstatuar që në lashtësi, duke u pasuruar gradualisht” (Kraja, 2006:316). Earl (2003) kur flet për shkollën dhe për ndërthurjen e vlerësimit dhe të nxënit thotë që mësuesit e konsiderojnë “vlerësin si pjesën më të vështirë” (Earl 2003:26). Të njëjtën gjë pohon edhe (Garo 2013:198) i cili thotë se mësuesit gjenden përpara një përgjesësie të madhe kur ato i vlerësojnë nxënësit

duke i vënduar nota atyre, gjë që e bënë vlerësimin një pjesë të vështirë të mësimdhënies, për më tepër ai e konsideronë vlerësimin e nxënësve si një nga përgjegjësitë më të mëdhaja që ka mësuesi në klasë. “Mësuesit duhet të kërkojnë mundësi për ti bashkuar forcat e tyre me të tjerët dhe duhet të kuptojnë se janë pjesë e një lëvizjeje më të gjërë për zhvillimin e një shoqërie të nxënësve përmes punës së tyre me nxënësit dhe prindërit” (Fullan, 2010:61).

Por, përsëri vlerësimi i nxënësve mbetet detyrë e mësuesve të cilën duhet ta kryen në mënyrë sa më korrekte. Por, cila është ajo mënyrë? Vazhdimisht po aplikohen metoda të ndryshme për vlerësimin e nxënësve, për të parë se cila prej tyre është më e përshtatshme për tu përdorur nga mësuesit. Ekzistojnë forma të ndryshme të vlerësimit të cilat aplikohen në bazë të qëllimit për çfarë përdoret vlerësimi, jo çdo lloj vlerësimi është i përshtatshëm në të gjithë raset. Vlerësimi diagnostik përdoret në fillim të një kursi, përpara se të jetë aplikuar mësimdhënia dhe shërben për të përcaktuar nivelin e nxënësve në bazë të njohurive që ato kanë paraprakisht për atë temë apo në përgjithësi për kursin që do të ndjekin. Shpeshherë është i aplikueshëm për rangimin e nxënësve nëpër klasa sipas nivelit të njohurive të tyre në një sferë të caktuar, gjithashtu i përdorur edhe nga mësuesit për ta patur si pikë referimi në përpilimin e kurikulës së kursit apo lëndës mësimore që do të ndjekin nxënësit. Jep informacion për detyrën e nxënësve, çfarë niveli të njohurive kanë në atë lëmi, fushë, apo lëndë mësimore ku ato testohen dhe do të duhet të bëhet ndërlidhja për të vazhduar me pjesën tjetër të diturive që do të duhet të mësojnë nxënësit. Vlerësimi përmledhës paraqet disi të kundërtën e vlerësimit diagnostik, nuk ndodh në fillim, por në fund të një kapitulli, kursi, apo semestri. Ky shërben për të testuar njohuritë që ka marrë nxënësi pasi të jetë zhvilluar mësimdhënia, dhe paraqet rezultatet e nxënësve. Vlerësimi formues paraqet vlerësimin që ndodhë në një periudhë më të gjatë në krahasim me dy llojet e tjera të

vlerësimit, ai ndodhë gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mësuesi i informon nxënësit për: progresin e kryer, për mangësitë që kanë, dhe mbështet vlerësimin e kryer mbi bazën e informacioneve të shumta që kanë mbledhur nxënësit gjatë gjithë kohës. Secili llojë i vlerësimit ka kohën dhe vendin e veçantë kur duhet të përdoret, gjë që i jep atyre rëndësi të posaçme.

Përveç faktit që vlerësimi ka funksion të rëndësishëm për periudhën kur nxënësit janë në shkollë, ai vazhdon të mbetet i rëndësishëm edhe pasi nxënësit e kanë kryer shkollimin, jo vetëm për faktin që rrezultatet që kanë arritur ato gjatë shkollimit ndikojnë në shkollimin e tyre të më tutjeshëm dhe për orientimin e tyre në jetë pas shkollimit, vlerësimi ka ndikim edhe në anën psikologjike të njerëzve, sepse vlerësimi lë mbresa në kujtesën e njerëzve për periudhën kur ato kanë qenë në shkollë. Sipas Broadfoot, Weeden & Winter (2002:15) njerëzit i lidhin edhe momentet më të mira në shkollë, por edhe ato më të vështirat gjatë vlerësimit, nëse do të pyeten të tregojnë, qoftë diçka të mirë ose të keqe gjatë periudhës kur ato kanë qenë në shkollë, njerëzit do të tregojnë ndonjë ngjarje që i ka ndodh atyre në lidhje me vlerësimin.

2.1.1.Përkufizimet e koncepteve kryesore

2.1.1.1.Vlerësimi

Vlerësimi si pjesë përbërëse e procesit arsimor është studiuar dhe definuar nga studiues të ndryshëm të kësaj fushe . “Vlerësimi është mbledhje sistematike e të dhënave për mënyrën se si mësojnë nxënësit, duke përdorur kohën, diturinë, eksperiencën, dhe burimet që i kanë në dispozicion, për të vënë në dijeni vendimet që ndikojnë në mënyrën se si mësojnë nxënësit”. (Ealvoord, 2010: 2) “Vlerësimi është procesi i përshkrimit të progresit të nxënësve drejtë një qëllimi” (National Middle School Association, 2010). “Vlerësimi është

proces i mbledhjes së të dhënave me qëllim për të marr vendime në lidhje me studentët ose shkollat” (Salvia, Yesseldyke & Bolt, 2009: 4). Vlerësimi duhet të jetë i përshtatshëm për nxënësit që të ndikojë pozitivisht në mësimnxënie. Lidz e konsideron vlerësimin si “aktivitet mendor të vlerësuesit” sipas tij “vlerësimi nuk ndodh në një cop letre por në mendjen e presonit që bashkon dhe interpreton informacionin” (Lidz, 2003:2)

2.1.1.2.Vlerësimi diagnostik

Vlerësimi diagnostik përdoret kryesisht për të parë nivelin e njohurive që nxënësit i posedojnë në lidhje me një lëmi të caktuar para se të ndodh procesi i mësimdhënies. “Vlerësimi diagnostik identifikon vështirësit dhe problemet e të nxënit” (Peshkepia, 2012: 164). Ky lloj vlerësimi është “hapi i parë me vlerë” në procesin e gjatë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësim ky që “kontrollon njohuritë paraprake të nxënësve” (Wragg 1997: 25). Vlerësimi diagnostik jep informacion për diturit e nxënësve, për atë që nxënësit e dinë para se të fillohet diçka e re, një kapitull, një temë, një semestër, apo një vit akademik. “Vlerësimi diagnostik ofron informacion të thelluar për aftësitë dhe nevojat e nxënësve”(Chafouleas, Riley-Tillman & Sugai, 2007:7)

2.1.1.3.Vlerësimi formues

Vlerësimi formues ka qenë pikë studimi dhe vazhdon të paraqes interes për shumë studiues. “Termi vlerësim formues është përdorur për herë të parë në vitin 1967 nga Michael Scriven, për të përshkruar rolin që vlerësimi mund të ketë në përmirësimin e kurikulës në vazhdim e sipër” (Scriven, 1967: 41, cituar në: William, 2011). “Ndërsa në vitin 1998, vlerësimi formues u bë i përhapur më gjërësisht me publikimin e artikullit të titulluar „Vlerësimi dhe të nxënit në klasë” nga Paul Black dhe Dylan Wiliam” (Marshall, 2011:48). Vlerësimi formues është definuar në forma të ndryshme. “Termi vlerësim formues nuk ka

një kuptim të definuar ngushtë dhe të pranuar gjerësisht” (Black and William 1998, as cited in: Berry, 2008: 49). Disa autor librash vlerësimin formues e quajn edhe si “vlerësim i vazhdueshëm”, Zajazi, (2003), qëllimi i këtij vlerësimi nuk është ti vëndo një nxënësve nota, por të shoh arritjet e nxënësve në pjesë të veçanta të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe ky fakt i bënë nxënësit të ndihen më të relaksuar gjatë procesit të vlerësimit. (Zajazi 2003: 748).

Peter Airasian (1994) “e definon vlerësimin formues si interaktiv dhe të përdorur kryesisht për të formuar apo shndërruar një proces apo aktivitet që është në vazhdim” (cituar në: Marzano, 2006: 9). “Vlerësimi formues bazohet në atë se vlerësimi nuk është një fund, por mund të përdoret në mënyrë të vazhdueshme nga mësuesit dhe edukatorët në cilëndo pikë gjatë mësimdhënies për të identifikuar nëse, dhe nëse po, ku mësimdhënia dhe mësimnxënia duhet të përmirësohen” (Shermis & Di Vesta, 2011: 88). Ngjajshëm vlerësimi formues definohet edhe nga Harmer, J. (2007: 379) ai thotë se “vlerësimi formues ka të bëjë me llojin e fitbek-ut që mësuesit ja japin nxënësve gjatë procesit të zhvillimit të një kursi, apo lënde mësimore, dhe kjo mund ti ndihmojë nxënësit ta përmirësojnë performancën e tyre”. “Vlerësimi formues është mjet komunikimi ndërmjet nxënësve dhe mësuesit, duke e udhëhequr mësuesin drejt vendimeve të përshtatshme mësimore dhe jep fitbek inkurajues për nxënësit” (Benjamin, 2008:9). Sipas Poham (2008) mësuesit kanë shumë pikëpyetje në mendjen e tyre për vlerësimin formues, gjë që i çon mësuesit në një dilemë, ta përdorin apo mos ta përdorin, vlerësimin formues, Poham (2008:3) thotë se mësuesit duhet ta përdorin vlerësimin formues, sepse sipas tij nëse e aplikojnë në mënyrë korrekte vlerësimin formues, jo vetëm nxënësit por, edhe mësuesit do të përfitojnë nga përdorimi i këtij lloji

vlerësimi. “Vlerësimi formues ka për qëllim ti udhëheq edhe nxënësit edhe mësuesit drejtë hapat tjetër në procesin e të mësuarit” (Benjamin, 2008: 3).

Në vlerësimin formues nxënësit luaj një rolë të rëndësishëm, sepse ato nuk janë thjeshtë nxënësi të cilët vlerësohen vetëm nga mësuesi, por ato janë pjesëmarrës aktiv në procesin e vlerësimit. “Vlerësimi formues varet nga partneriteti midis mësuesve dhe nxënësve, për këtë arsye, nxënësit duhet ti njohin tërësisht standardet që përdoren” (Benjamin, 2008: 23). “Vlerësimi që i përfshin nxënësit në proces dhe që fokusohet në rritjen e të nxënit, nuk mat thjesht njohurit e nxënësve por, edhe i motivon nxënësit” (Chappuis & Stiggins, 2004, cituar në: Chappuis et al., 2004: 171).

2.1.1.4.Vlerësimi përmbledhës

Vlerësimi përmbledhës përdoret në fund të një teme të caktuar me qëllim për të vlerësuar njohuritë e nxënësve dhe për ti vlerësuar nxënësit me nota. Pra “vlerësimi përmbledhës përfundon me notë” (Benjamin, 2008: 3). Por “sigurisht që vlerësimi përmbledhës është i rëndësishëm dhe një pjesë e nevojshme e shkollimit dhe eksperiencës së nxënësve” (Harlen,2007:4). Përdorimi i vlerësimit përmbledhës është kryesisht për të “raportuar suksesin e nxënësve për pridërit dhe për të dhënë raport për fundin e vitit, kur nxënësit do të kalojnë në klasën tjetër” (Chappuis et al., 2004:16).

2.1.1.5.Përdorimi i fitbek-ut në klasë

Përdorimi i fitbek-ut në klasë ka anë pozitive por, mund të ketë edhe anë negativ. “Disa forma të fitbek-ut mund të jenë të padobishme dhe antiproduktive” (Brophy 2010:57).

Kluger dhe DeNisi (1998) thonë se ato kanë zbuluar në studimin e tyre se në një të tretën e rasteve përdorimi i fitbek-ut e ul performancën e nxënësve (cituar në Brophy 2010:57).

Ndodh që mësuesit ti japin nxënësve fitbek jo të përshtatshëm, që nuk i shërben nxënësve.

Përveç të qenit informues për nxënësit, fitbek-u duhet të jepet në mënyrë që të përçojë respekt për nxënësit dhe ndjeshmëri për besimin e tyre në vetëvete (Brinko 1993, Hareli & Hess 2008 cituar në Brophy 2010:58)

2.1.1.6. Motivimi i nxënësve

Motivimi si një koncept kompleks mund të jetë i vështirë për tu definuar dhe për tu shpjeguar, po aq komplekse mund të jetë mënyra e motivimit të nxënësve, roli që ka motivimi i nxënësve në mbarëvajtjen e orës mësimore dhe në suksesin e nxënësve. Por sipas Malikow (2007) “motivimi është më e lehtë të definohet sesa të kuptohet” (fq.118). Ruiz (2012) pohon se “shumë dijetarë të cilët mireme me studime në fushën e edukimit kanë dhënë përkufizime të ndryshme për motivimin”. “Një nga njerëzit me më shumë ndikim në fushën e motivimit është Abraham Masloë, i cili u përpoq të sintetizoj shumë kërkime në lidhje me motivimin e njerëzve” Huitt, W. (2001). Sipas Ryan & Deci, (2000) “të jesh i motivuar do të thotë të jesh në lëvizje për të bërë diçka”, nxënësit e demotivuar karakterizohen si nxënës të cilët nuk paraqesin inspirim për të kryer detyrat e nxënësit, ndërsa nga ana tjetër nxënësit të cilët paraqesin interes dhe janë aktiv gjatë gjithë kohës për të arritur deri në fund janë nxënës të motivuar (Ryan & Deci, 2000: 54). “Motivimi i nxënësve i referohet gadishmërisë, nevojës, dëshirës dhe detyrimit të nxënësve për të marr pjesë dhe për të qenë të sukseshëm në procesin e mësimnxënies” (Bomia et al., 1997: 1). Faktor të ndryshëm ndikojnë në motivimin e nxënësve dhe për këtë arsye nxënësit nuk janë të motivuar njëllë, niveli i motivimit të nxënësve në klasë ndryshon shumë nga njëri-tjetri. “Nxënësit vijnë në shkollë me nivele të ndryshme të motivimit dhe jo të gjithë nxënësit do të jenë të motivuar në të njëjtën mënyrë në të njëjtën kohë” (Hayenga & Corpus, 2010; Kohn, 1994; Meyer, McClure, Ealkey, Eeir, & McKenzie, 2009, e cituar në Ruiz, 2012).

“Nëse nxënësit nuk janë të motivuar, është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që ato të përmirësojnë të arriturat e tyre akademike, pa marrë parasysh se sa i mirë mund të jetë mësuesi, kurikula apo shkolla” (Center on Education, Policy Graduate School of Education and Human Development, The George Washington University, 2012:2). Gjithashtu në këtë raport motivimi i nxënësve shihet si me ndikim të shumëfishtë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, të qenit të motivuar lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrimin e përgjithshëm që kanë nxënësit ndaj shkollës, aktivitetin e tyre në klasë, rezultatet e tyre në teste, përkushtimin e tyre ndaj shkollës si dhe raportin që kanë nxënësit me mësuesit e tyre.

Në studimin e tyre Ryan & Patrick (2001) për ndryshimet që mund të ndodhin në motivimin e nxënësve të cilët kalojnë nga klasa e shtatë në klasën e tetë brenda të njëjtës shkollë thonë se “edhe pse mjedisi social i klasës ka të ngjarë të jetë i rëndësishëm për motivimin dhe angazhimin e nxënësve të gjitha moshave, ai mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm për nxënësit e rinj adoleshent” (Ryan & Patrick, 2001: 439)

Për motivimin e nxënësve ndikojnë shumë faktor si jashtë shkolle ashtu edhe brenda saj, për këtë arsye jo të gjithë nxënësit në shkollë janë të motivuar në të njëjtin nivel. Pa marrë parasysh nivelin e motivimit që kanë nxënësit përsëri ato duhet të motivohen. “Edhe nxënësit më të motivuar kanë nevojë që të mësojnë në shkollë që të jenë të përfshirë në mënyrë aktive duke ndërtuar qëllimet dhe interesat e tyre poashtu edhe njohuritë paraprake” (Brewster & Fager, 2000).

“Të kuptuarit e mundësisë që llojet e ndryshme të motivimit funksionojnë në varg është e rëndësishme jo vetëm për teoricientët që studiojnë motivimin por edhe për praktikuesit të cilët duhet të përshtaten për kompleksitetin e nxënësve individualisht” (Hayenga & Corpus, 2010: 371). Puna e mësuesit nuk është vetëm të dijë të përcaktoj dhe të shpjegoj

motivimin, aplikimi i tij në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme për nxënësit është i rëndësishëm. Sipas (Malikow, 2007:119) “definimi i motivimit dhe rëndësia e kompleksitetit të tij është e nevojshme për mësimdhënien, por nuk është e mjaftueshme. Mësuesit duhet të ekspolorojnë si ta përdorin atë për motivimin e tyre në mësimdhënie dhe motivimin e nxënësve në mësimnxënie”. “Motivimi i brendëshëm i nxënësve do të rritet, nëse mësuesit kur planifikojnë aktivitete dhe detyra marrin parasysh këto komponent: konrollin, kompetencën, përfshirjen aktive, shumëllojshmëri, kuriozitet, sfidë, ndjenjë të përkatësisë dhe tone respekti” (Wilson, 2011:1).

2.2 Metodologjia

2.2.1 Përshkrimi i procedurës së studimit

Vlerësimi është pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Shpeshherë duke e konsideruar vlerësimin si pasqyrë e tyre për angazhimin, punën, aktivitetin dhe sjelljen e tyre në klasë, rezulton që nxënësit ta shohin vlerësimin si pjesë prioritare të procesit mësimor. Mësuesit përdorin metoda të ndryshme për ti vlerësuar nxënësit. Format e ndryshe të vlerësimit mund të kenë ndikime të ndryshme në motivimin e nxënësve. Faktor me rol shumë domethënës në suksesin e nxënësve është motivimi i tyre për të mësuar. Për këtë arsye, gjatë aplikimit të vlerësimit mësuesit duhet ta kenë parasysh se çfarë efekti mund të krijojë në motivimin e nxënësve, lloji i vlerësimit që ato e përdorin. Qëllimi i këtij studimi është të vëzhgoj dhe analizoj ndikimin e vlerësimit formues, si një nga llojet e vlerësimit që përdoren aktualisht në shkollat fillore në Strugë, në motivimin e nxënësve për të mësuar. Qëllimi i këtij studimi u realizua nëpërmjet mbledhjes së të dhënave nga tre lloje të pyetësorëve, pyetësorëve të mësuesve, nxënësve dhe prindërve të nxënësve, pyetësor të cilët u përpiluan për këtë studim kërkimor, gjithashtu për të mbledhur

të dhëna për të njëjtin qëllim të studimit u intervistuan mësues dhe nxënës të shkollave fillore të Strugës. Në njëërën nga shkollat fillore të Strugës, “Nuri Mazari” –Dollogozhdë, u realizua një studim rasti me nxënësit e klasave të gjashta, shtata, teta dhe të nënta, të cilët e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj. Gjatë orëve të gjuhës angleze u aplikua vlerësimi formues për të parë ndikimin e këtij lloji vlerësimi në motivimin e nxënësve për të mësuar në klasë, gjatë mësimi të gjuhës së huaj. Informacione tjera të vlefshme për vlerësimin e nxënësve dhe ndikimin e tij në motivimin e nxënësve në klasë do të mbidhen nga vizitat gjatë orëve të ndryshme mësimore dhe nga analiza përmbajtësore e orëve dhe lëndëve të vëzhguara.

2.2.2 Shkollat fillore

Në Strugë ka 34 shkolla fillore 11 prej tyre janë shkolla qendrore. Ato quhen shkolla qendrore pasi që ato kanë nën udhëheqje të paktën edhe një shkollë tjetër (shiko shtojcën # 8). Shkollat qendrore dhe shkollat periferike nën administrimin e shkollës qendrore kanë të njëjtin drejtor dhe administratë, ndryshimi qëndron në faktin se ato ndodhen në vende të ndryshme.

Gjashtë nga shkollat qendrore të Strugës u përzgjedhën të jenë pjesë e këtij studimi, dhe atë shkolla “Nuri Mazari” –Dollogozhdë, “Ashim Agushi” –Ladorishtë, “Orhan Xhemaili”- Tatesh i Epërm, “Vëllezërit Milladinovci”- Struga, “Murat Labunishti”- Labunishte dhe “Zini Hani” –Veleshtë. Katër nga shkollat fillore janë shkolla ku mësimi zhvillohet krejtësisht me nxënës dhe mësues shqipëtar, ndërsa dy prej tyre janë shkolla të përziera. Pjesëmarrësit në këtë studim ishin nga tri grupe të ndryshme, mësuesit, nxënësit dhe prindërit e nxënësve. Plotësimi i pyetësorëve nga pjesëmarrësit në studim dhe intervistimi i

tyre u bë i mundur përmes takimeve me drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të cilët punojnë në këto shkolla.

2.2.3 Përshkrimi i popullatës dhe kampionit në studim

Mësuesit, nxënësit dhe prindërit janë tre faktorët kryesorë që e formojnë trekëndëshin e bashkëpunimit për një proces të sukseshëm mësimor. Mbledhja e të dhënave nga këto tre faktorë japin informacione të vlefshme, të para nga tre këndvështrime të ndryshme.

Pikëpamja e mësuesve, prindërve dhe nxënësve për përdorimin e vlerësimit formues në klasë nuk është e njëjtë sepse i njëjtë nuk është as roli i tyre, për këtë arsye pjesëmarrja e tyre në këtë studim është shumë e rëndësishme. Në rrethin e Strugës ku u realizua ky studim ka gjithsej 11 shkolla fillore. Këto shkolla paraqesin polullatën e shkollave fillore ($n=11$), këto janë shkolla qendër që kanë nën administrimin e tyre edhe shkolla periferike, ndërsa 6 shkolla përbëjnë kampioni e shkollave fillore, sepse ky studim u realizua në 6 prej tyre ($N=6$).

2.2.3.1 Kampioni i mësuesve pjesëmarrës

Mendimi i mësuesve është shumë me rëndësi kur flitet për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Çdo temë e trajtuar në lidhje me procesin arsimor nuk mund të tejkalohet pa krijuar te mësuesit një mendim personal në lidhje me çështjen e trajtuar. Rëndësia e mendimit të mësuesve për procesin e vlerësimit të nxënësve, e bënë të patjetërsueshme pjesëmarrjen e mësuesve në këtë studim që trajton vlerësimin e nxënësve dhe ndikimin e tij në motivimin e tyre për mësim. Në këtë studim kanë marrë pjesë mësues nga gjashtë shkolla fillore të rrethit të Stugës. Mësuesit pjesëmarrës janë mësues të lëndëve të ndryshme mësimore. Kampioni i mësuesve u zgjodh në mënyrë rastësore, dhe ishin tre grupe respondentësh për kampionin mësues dhe atë: (1) kampioni i mësuesve që plotësuan pyetësorin të përpiluar

për mësuesit, 188 respondentë mësues (N=188) nga një polullatë prej 495 persona të punësuar në shkollat fillore, të cilat ishin pjesëmarrëse në studim (n=495), ky kampion paraqet 37.97% të popullatës ($p=37.97\%$), (2) kampioni i mësuesve të intervistuar, 88 respondentë mësues u intervistuan (N=88), në një polullatë prej 495 persona të punësuar në gjashtë shkollat fillore (n=495), përfaqëson 17.77 % të popullatës. (3) kampioni i mësuesve të vëzhguar, 21 respondentë mësues u vëzhguan gjatë mësimdhënies (N=21), në një polullatë prej 495 persona të punësuar në gjashtë shkollat fillore të cilat ishin pjesë e studimit (n=495), që përfaqëson 4.2% të popullatës

2.2.3.2 Kampioni i nxënësve pjesëmarrës

Nxënësit e shkollave fillore janë grupi i dytë i pjesëmarrësve të këtij studimi. Opinioni i nxënësve për çështjet e mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë i rëndësishëm pasi që ato janë pjesëmarrës të drejtëpërdrejt në këtë proces. Për këtë arsye nxënësve të klasave së shtata, teta dhe të nënta nga shkollat fillore të Strugës u përfshin në këtë studim. Numri i nxënësve pjesëmarrës ishte shumë më i madhë në krahasim me numrin e mësuesve të cilët morën pjesë në studim. 572 nxënës plotësuan pyetësin të përpiluar për nxënësit ndërsa 150 nxënës u përgjigjën në pyetjet e intervistës së nxënësve duke argumentuar opinionin e tyre në lidhje me ndikimin e vlerësimit në motivimin e nxënësve. Në këtë studim kishte dy grupe respondentësh për kampionin nxënës dhe atë: (1) kampioni nxënës që plotësuan pyetësin, i cili përbëhej kryesisht nga nxënës të klasave të: gjashta, shtata, teta dhe të nënta, dhe atë 572 respondentë nxënës (N=572), nga popullata prej 4029 nxënës të shkollave fillore pjesëmarrëse në studim (n=4029), ky kampion paraqet 14.19% të popullatës, (2) kampioni nxënës që u përgjigjën në intervista, dhe atë 150 respondentë nxënës (N=150), nga popullata prej 4029 nxënës të shkollave fillore, të cilat ishin

pjesëmarrëse në këtë studim ($n=4029$), ky kampion përfaqëson 3.72% të popullatës.

Nxënësit e intervistuar argumentuan opinionin e tyre në lidhje me ndikimin e vlerësimit në motivimin e nxënësve. Pasiqë nxënësit pjesëmarrës në këtë studim janë nxënës të shkollave fillore, në takimin me prindër, prindërit u informuan për këtë studim dhe u kërkua nga ato leje për pjesëmarrjen e fëmijëve të tyre në studim.

Përveç plotësimit të pyetësorëve dhe përgjigjeve nëpër intervista nxënësit ishin pjesëmarrës në këtë studim kërkimor edhe nëpërmjet studim rastit të realizuar në njërën nga shkollat fillore të Strugës, edhe atë në shkollën „Nuri Mazari”–Dollogozhdë, 115 nxënës të klasave të gjashta, shtata, teta dhe të nënta ishin pjesëmarrës në studim rastin e realizuar gjatë orëve të gjuhës angleze. Popullata e nxënësve të shkollës fillore „Nuri Mazari” Dollogozhë, që përfshin edhe nxënësit e shkollave periferike, që janë nën administrimin e saj, përbëhet nga 590 nxënës nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, ($n=590$), prej tyre (3) kamipon nxënës pjesëmarrës në studim rastin, dhe atë 115 respondentë nxënës ($N=115$), ky kmapion përfaqëson 19.49% të popullatës.

2.2.3.3 Kampioni i prindërve pjesëmarrës

Prindërit luajn një rol të pazëvendësueshëm në jetën e fëmijëve të tyre, roli i tyre është shumë domethënës edhe në shkollimin e fëmijëve dhe veçanërishtë kur fëmijët e tyre janë në moshë të vogël. Opinioni i prindërve për procesin mësimor dhe qëndrimi i tyre për ndryshimet në shkollë është i rëndësishëm në formimin e mendimit të fëmijëve për të njëjtat çështje. Mendimet e prindërve shpesh mund të kthehen në frymëzim që ndikon në motivimin e fëmijëve për të mësuar. Për këto arsye, pjesëmarrja e prindërve është shumë e rëndësishme edhe për këtë studim, që trajton ndikimin e vlerësimit në motivimin e nxënësve. Në këtë studim u përcaktuan për të marrë pjesë 572 prindër, numër i njëjtë me

numrin e nxënësve por 12 nga prindërit nuk u përgjigjën në asnjërën nga pyetjet e pyetësorit për prindërit. Pra, në studim morrën pjesë 560 prindër. Pra (1) kampioni i përhindërve përbëhet nga 560 respondentë prindër që u përgjigjën në pyetësorin për prindërit (N=560), nga një polullatë prej 4029 prindër, duke u përlogaritur një prind për një nxënës (n=4029), ky kampion përfaqëson 13.89% të popullatës.

2.2.4. Vizita gjatë orëve mësimore

Të dhënat e mbledhura me metoda të ndryshme dhe nga burime të ndryshme japin rezultate përfundimtare më të besueshme sepse ato janë përfundim i të dhënave të marra nga më shumë këndvështrime. Për këtë arsye në studime kërkimore bëhet kombinim i metodave. Vëzhgimi është metodë direkte e mbledhjes së të dhënave. Vëzhgimi gjatë orëve mësimore nënkupton vizita në orë të ndryshme mësimore ku studiuesi mban shënime gjatë orës mësimore duke përdorur çeklista me rubrika të përpiluara për këtë studim. Qëllimi i vëzhgimit gjatë orëve mësimore për këtë studim kërkimor është mbledhja e të dhëna për aplikimin e vlerësimit formues në orë të lëndëve të ndryshme mësimore. Për të mbledhur informacion për çështjen kryesore që trajton ky studim, ndikimin e vlerësimit në motivimin e nxënësve u vëzhguan 21 mësues gjatë orëve mësimore. Mësuesit ishin të informuar paraprakisht se do të vëzhgoheshin gjatë një ore mësimore. Fletat e vëzhgimit të cilat u përgatitën për këtë studim, ishin instrumenti që u përdorë për mbajtjen e shënimeve dhe mbledhjen e të dhënave gjatë orëve mësimore. Pas orës mësimore mësuesit e vëzhguar u pyetën edhe disa pyetje për të parë se a veprojnë ato çdoherë në të njëjten mënyrë ose varësisht nga qëllimi i orës mësimore ndryshojnë edhe metodat që përdorin gjatë orëve mësimore. Gjithashtu në fund të orëve mësimore u bë analiza përmbajtësore për orët e vëzhguara.

2.2.5. Studim rasti

Pjesë e rëndësishme e këtij punimi doktoral është kryerja e një studim rasti. Studim rasti nënkupton vëzhgimin dhe studimin nga afër të nxënësve pjesëmarrës. Kjo mundëson mbledhjen e të dhënave kualitative të cilat i japin një nivel më të lartë besueshmërie rezultateve të studimit.

2.2.5.1. Përshkrimi i studim rasti - ndikimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve gjatë mësimit të gjuhës angleze

Qëllimi i studim rasti është të studioj ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve gjatë mësimit të gjuhës angleze. Nxënësit pjesëmarrës në këtë studim rasti janë 115 nxënës të shkollës nëntëvjeçare „Nuri Mazari”, Dollogozhdë, Strugë. Kjo është një nga shkollat fillore të rrethit të Strugës.

2.2.5.2. Përshkrimi i pjesmërrësve të studim rasti

Të gjithë pjesëmarrësit e studim rasti janë nxënës shqipëtar që e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj. Në tërësi do të marrin pjesë 115 nxënës, 16 nxënës të klasës së VI-1, 17 nxënës të klasës së VII-2, 19 nxënës të klasës së VII-2, 17 nxënës të klasës së VIII-1, 13 nxënës të klasës së VIII-2, 17 nxënës të klasës së IX-1, 16 nxënës të klasës së IX-2, të gjithë nxënës të shkollës nëntëvjeçare „Nuri Mazari”, Dollogozhdë Strugë. Mosha e pjesëmarrësve varion nga 10 deri në 15 vjeç. Në tërësi, 7 klasa të ndryshme dhe 115 nxënës janë pjesë e studim. Në të gjitha klasat ligjeron e njëjta mësuese e gjuhës angleze.

2.2.5.3. Pjesa e parë – ndarja e nxënësve nëpër grupe

Gjatë muajit të parë të gjysëmvetorit, mësuesja mbante shënime për nxënësit në lidhje me motivimin e nxënësve gjatë orëve mësimore dhe gjithashtu për suksesin dhe progresin e nxënësve në mësim. Nxënësit nuk informohen për këto shënime që mban mësuesja gjatë kësaj periudhe. Ajo nuk e ka obligim për ti informuar nxënësit për suksesin e tyre pasiqë

sipas ligjit për shkollat fillore nxënësit nuk vlerësohen me nota gjatë muajit të parë. Pra këto shënime mësuesja i shfrytëzoi si të dhëna për këtë studim. Kjo periudhë është shumë e përshtatshme për fillimin e studimit sepse nxënësit ndahen në grupe në bazë të gjendjes fillestare të tyre pa u ndikuar nga vlersimi formues që do të përdor mësuesja gjatë muajve në vazhdim. Të gjithë aktivitetet e kësaj periudhe janë në formën e para-testeve, në bazë të të cilëve përcaktohet motivimi i nxënësve gjatë orëve mësimore para se të aplikohet vlerësimi formues me to. Gjatë orëve mësimore në muajin e parë mësuesja i vlerëson nxënësit vetëm gojarisht, me fjalët si për shembull: po e saktë, mirë, të lumtë, përpiqu edhe pak etj. Nuk mund të bëhet një eliminim total i vlerësimit sepse në atë mënyrë orët mësimore do të ishin shumë monotone dhe jo motivuese për nxënësit.

2.2.5.3.1. Ndarja e nxënësve në grupe

Për ta parë ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve, fillimisht u përcaktua gjendja fillestare e nxënësve dhe në fund kjo krahasohet me gjendjen e nxënësve pas përdorimit të vlerësimit formues. Krahasimi i motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues jep të dhëna për ndikimin që ka patur përdorimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve. Gjatë muajit të parë të vitit shkollor nxënësit nuk duhet të vlerësohen me nota. Mësuesja përdori këtë periudhë për ti vëzhguar nxënësit dhe për ti ndarë ato në grupe në bazë të shkallës së motivimit të tyre. Ndarja e nxënësve nëpër grupe u bë me anë të përdorimit të çeklistave të përbëra nga rubrikave të formuluar për këtë studim, për të qënë sa më të përshtatshme për pjesëmarrësit. Nxënësit u ndanë në katër grupe dhe atë në: (1)nxënës shumë të motivuar, (2)të motivuar, (3)pak të motivuar dhe (4)të demotivuar

Williams, K.C., & Williams, C.C. thonë se: “Motivimi i nxënësve është një element thelbësor që është i nevojshëm për arsim cilësor” (fq.2). Detyrat e shtëpisë mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve. Motivimi i nxënësve rritet nga bashëpunimi që nxënësit mund të kenë me njëri-tjetrin për ti kuptuar më mirë dhe për ti kryer detyra e shtëpisë. (Booth 2010, fq. 15). Sipas Palmer (2007) ne e dimë se nxënësit janë të motivuar kur ato paraqesin vëmendje, kur menjëherë fillojnë të punojnë në detyrat e dhëna, kur bëjnë pyetje dhe përgjigjen në mënyrë vullnetare, dhe kur ato jenë të lumtur dhe energjik.

Duke u bazuar në studimet e autorëve të përmendur më sipër, kriteret të cilat u morën parasysh në përcaktimin e rubrikave të çeklistave jenë: (1)kryerja e detyrave të shtëpisë nga nxënësit, (2)dëshira e nxënësve për ti lexuar detyrat e shtëpisë në klasë, (3)veprimet e nxënësve në fillim të orës mësiore, (4)aktiviteti i nxënësve gjatë orëve mësimore, (5)entuziazmi i shprehur i nxënësive. Çdonjëra nga kategoritë i ka pikët e përcaktuara.

Nxënësit e motivuar mund të marrin nga 3 pikë nga çdonjëra nga kategoritë e përcaktuara si kriteret për ndarjen e nxënësve nëpër grupe. Grupi i nxënësve shumë të motivuar gjithsej mund të mbledhin 15 pikë, pasi kategoritë janë pesë dhe pikët maksimale janë 3 për çdonjëren nga kategoritë. Në grupin e nxënësve që janë të motivuar maksimumi i pikëve për kategori është 2, grupi i nxënësve që janë pak të motivuar maksimumi i pikëve për kategori është 1 dhe nëse nxënësit janë pjesë e katogorisë të përcaktuar si të demotivuar ato nuk marrin asnjë pikë.

Tabela 1 Kriteret e merra parasyshë për ndarjen e nxënësve nëpër grupe

Kryerja e detyrave të shtëpisë nga nxënësit	Dëshira e nxënësve për ti lexuar detyrat e shtëpisë në klasë	Veprimet e nxënësve në fillim të orës mësiore	Aktiviteti i nxënësve gjatë orëve mësimore	Entuziazmi i shprehur i nxënësve
---	--	---	--	----------------------------------

Grupi i parë (3 pikë) Gjithmonë i bën detyrat e shtëpisë.	Grupi i parë (3pikë) Gjithmonë ka shumë dëshirë që ti lexoj detyrat e shtëpisë në klasë.	Grupi i parë (3pikë) Gjithmonë: I bën gati librt për orën e mësimit. - Është duke lexuar diçka -Pyet mësuesin pyetje për gjërat e paqarta që mund të ketë hasur -Bisedon me shokun e bankës në lidhje me mësimet	Grupi i parë (3pikë) Gjithmonë është i përgatitur për mësim dhe është shumë aktiv gjatë orëve mësimore.	Grupi i parë (3pikë) Gjithmonë është shumë entuziast gjatë orës mësimore, ka dëshirë të madhe për ta shprehur atë që din, reflekton energji pozitive në klasë.
Grupi i dytë (2 pikë) Zakonisht i bën detyrat e shtëpisë.	Grupi i dytë (2 pikë) Zakonisht ka dëshirë që ti lexoj detyrat e shtëpisë në klasë.	Grupi i dytë (2 pikë) Zakonisht mirret me përgatitjen e librave për orën e mësimit. - Në shumicën e rasteve është duke lexuar - Ndonjëherë pyet mësuesin pyetje për gjërat e paqarta që mund të ketë hasur -Bisedon me shokun e bankës edhe në lidhje me mësimet.	Grupi i dytë (2 pikë) Puthuajse çdoherë është i përgatitur për mësim dhe është aktiv gjatë orëve mësimore.	Grupi i dytë (2 pikë) Në shumicën e rasteve dëshiron të tregoj vullnetarisht atë cfarë di, duket i gëzuar gjatë orëve mësimore.
Grupi i tretë (1 pikë) Ndonjëherë i bën detyrat e shtëpisë	Grupi i tretë (1 pikë) Ndonjëherë shprehë dëshirë për ti lexuar detyrat e	Grupi i tretë (1 pikë) Ndodh shpeshë që ti rregulloj librat për orën mësimore edhe	Grupi i tretë (1 pikë) Nuk është i përgatitur për mësim por mund të ndodh që edhe	Grupi i tretë (1 pikë) Nuk është shumë entuziast gjatë orëve mësimore, por

	shtëpisë në klasë	pse kjo mund të jetë në mënyrë rutinore	të jetë ndonjëherë i përgatitur dhe të aktivizohet por zakonisht jo vullnetarisht por me kërkesë të mësuesit.	ka raste kur duket se ndihet mirë në klasë
Grupi i katërt (0 pikë) Asnjëherë nuk i bën detyrat e shtëpisë.	Grupi i katërt (0 pikë) Asnjëherë nuk i lexon në klasë detyrat e shtëpisë.	Grupi i katërt (0 pikë) Pothuajse çdoherë nuk i ka librat mbi bankë dhe ndodh shpeshë që mos i ketë marr fare me vete librat në shkollë, bisedon me shokun e bankës për çështje tjera jo për mësim.	Grupi i katërt (0 pikë) Asnjëherë nuk është aktiv gjatë orëve mësimore.	Grupi i katërt (0 pikë) Nuk paraqet fare interesim për mësim.

1. Grupi i parë - nxënësit shumë të motivuar – nxënësit që kanë prej 13 deri në 15 pikë
2. Grupi i dytë - nxënësit të motivuar - nxënësit që kanë prej 8 deri në 12 pikë
3. Grupi i tretë - nxënësit pak të motivuar – nxënësit që kanë prej 3-7 pikë
4. Grupi i katërt - nxënësit të demotivuar – nxënësit që kanë prej 0-2 pikë

Nxënësit u përcaktuan nëpër grupe në bazë të pikëve totale të grubulluara sipas pikëve të përcaktuara për çdo kategori. Nxënësi mund të ishte pjesë e njërit prej grupeve nëse kishte maksimumin e pikëve që mund të arrinte nëse i kishte të gjitha karakteristikat e atij grupi ose nëse kishte dy pikë më pak ose dy pikë më tepër nga sa ishte maksimumi që arrihet kur nxënësi i ka të gjitha karakteristikat e njërit grupi dmth nxënësi përcaktohet në grupin e nxënësve të motivuar nëse ai arrin të mbledh nga dy pikë për çdonjërin nga kriteret e

përcaktuara për ndarjen e nxënësve në grupe dhe në total arrin 10 pikë, por edhe nëse ai në ndonjërin nga kriteret arrin të mbledh më tepër ose më pak pikë dhe në total ka dy pikë më shumë, 12 pikë ose dy pikë më pakë, 8 pikë ai është përsëri pjesë e të njëjtit grup, grupit të nxënësve të motivuar. Për, ndarjen e nxënësve nëpër grupe në bazë të motivimit të tyre është bërë një ndarje me tolerim + 2 ose -2 nga maksimumi që mundet të arrihet vetëm me pikët e mbledhura nga kriteret e përcaktuara për njërin grup.

Gjatë gjithë muajit të parë mësuesja vëzhgoi nxënësit dhe veprimet e tyre gjatë oreve mësimore. Mësuesja mbajti shënime të detajuara dhe të sakta për secilin nxënë. Në bazë të tyre ajo i klasifikoj nxënësit nëpër grupe.

2.2.5.4.Pjesa e dytë- vlerësimin vetëm me notë

Pas mbarimit të muajit të parë, në muajin e dytë mësuesja filloi t'i vlerësoj nxënësit me nota në listat e përgatitura për mbajtjen e shënimeve për suksesin e nxënësve, jo në regjistrë, por tanimë ajo i njofton edhe nxënësit që të jenë më të përgatitur sepse do të vlerësohen me nota. Në muajin e dytë mësuesja nuk përdori vlerësim formues, por vlerësim vetëm me nota. Në këtë periudhë, mësuesja vazhdoi të mbaj shënime në bazë të fletës së vëshgimit në formë të çeklistës me rubrikat që e ka përpiluar për këtë studim. Këto shënime i shërbejnë mësueses si të dhëna për motivimin e nxënësve në klasë gjatë kohës që nxënësit e dinë se, aktiviteti i tyre në klasë, detyrat e shtëpisë dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me procesin mësimor do të vlerësohet nga mësuesja për t'i vlerësuar ato me nota. Por, nxënësit nuk i dinë kriteret e veçanta të vlerësimit për çdo aktiviteti. Ato e dinë se duet të jenë të përgatitur dhe të mësojnë materialin e dhënë, por jo se çfarë në veçanti është prioritarë në vlerësimin e një aktiviteti të caktuar. Informacione të tilla zakonisht jepen kur aplikohet vlerësimi formues.

2.2.5.5.Pjesa e tretë- përdorimi i vlerësimit formues

Periudha e aplikimit të vlerësimit formues ishte dy muajt në vazhdim, që nënkupton muajin e tretë dhe të katërt të gjysëmvetorit. Gjatë kësaj periudhe mësuesja mbajti shënime për motivimin e nxënësve gjatë aplikimit të vlerësimit formues në forma të ndryshme.

Në bazë të ligjit për shkollat fillore në Maqedoni nxënësit mësojnë gjuhën angleze tre herë në javë dhe çdo orë mësimore zgjatë 40 minuta. Pasi ky studim rasti u zhvillua në një shkollë fillore nxënësit morrën pjesë në studim gjatë tre orëve mësimore në javë. Për të mbajtur shënim veprimet dhe reagimet e nxënësve të cilat janë të lidhura me motivimin e tyre, mësuesja përdor fleta vëzhgimi në formë të çeklistave të ndara në rubrika, në bazë të formës së vlerësimit që përdor. Aktivitete gjatë orëve mësimore janë të ndryshme pasi që duhet të përshtaten për të zhvilluar te nxënësit të katër aftësit e mësimi të një gjuhe të huaj (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit), poashtu fjalët e reja edhe gramatikën e gjuhës. Aktivitetet kryesish i kanë të kombinuara zhvillimin e aftësive, por për të pasur rezultate sa më të dukshme dhe konkrete ky studim rasti u fokusua kryesish në aktivitetet me shkrim.

Vlerësimi formues mund të aplikohet në forma të ndryshme, por gjatë këtij studim rasti mësuesja përdori vetëm disa forma të vlerësimit formues, dhe më konkretisht, përdori (1) fitbekun (fitbek me shkrim dhe me gojë) si një element shumë i rëndësishëm i vlerësimit formues, (2) informimin e nxënësve me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen, (3) pjesëmarrjen e nxënësve në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, (4) vetëvlerësimin e nxënësve, dhe (5) vlerësimin e ndërsjellë.

2.2.5.5.1.Nxënësit pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit

Në një orë mësimore mësuesja i informon nxënësit se ato kanë për detyrë të shkruajn nga një ese, por fillimisht ajo kërkon nga ato që të japin mendimin e tyre në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit . Mësuesja e përdorë këtë teknikë të vlerësimit formues për të motivuar nxënësit. Është shumë me rëndësi mbajtja e shënimeve në këtë fazë, kur nxënësit janë pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit. Ndjesia e të qenit pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve i bën nxënësit të ndihen më të rëndësishëm në klasë dhe i motivon ato edhe më shumë, por gjithashtu ju shton përgjegjësinë për të mësuar më shumë. Kuptohet që versioni përfundimtarë i kriterëve të vlerësimit përpilohet nga mësuesja, por sigurisht duke marrë parasysh mendimin e nxënësve. Përveç që nxënësit janë pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit gjë që i bën ato të ndihen shumë të rëndësishëm në klasë, ato gjithashtu i dinë kriteret e vlerësimit përpara se të vlerësohen. Kur nxënësit i dinë kriteret e vlerësimit para se ato të vlerësohen, ato kanë më shumë mundësi që të tregojnë më shumë sukses, sepse koncentrohen në ato aspekte të vlerësimit të cilat janë të përcaktuara në kriteret për vlerësim të atij aktiviteti mësimor.

2.2.5.5.2.Njoftimi i nxënësve me kriteret e vlerësimit

Nxënësit nuk ishin pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të çdo aktiviteti mësimor, mirëpo edhe në rastet kur mësuesja i përpilon kriteret e vlerësimit për aktivitetet e caktuara ajo përsëri i njofton nxënësit më kriteret përpara se ato të vlerësohen. Si për shembull, në rastë se mësuesja do të vlerësoj te nxënësit aplikimin e sakatë të shenjave të pikësimit gjatë të shkruarit të gjuhës angleze ajo do ti informojë nxënësit për këto që në fillim, që gjatë të shkruarit të paragrafit, esesë ose thjeshtë një pjesë të shkurtër, nxënësit një vëmendje të veçantë ti kushtojnë shenjave të pikësimit. Kjo mënyrë i motivon nxënësit

sidomos ato të cilët në veçanti janë të interesuar të kenë sukses të mirë, dhe nxënësit e ndrojtur që gjithmonë para vlerësimit kanë shumë frikë dhe emocione. Kjo është një mënyrë e mirë për motivimin e nxënësve, sepse i orijenton ato për t'a hequr stresin dhe ja qartëson situatën duke i larguar frikën që mund të kenë nxënësit kur e din se do të vlerësohen.

2.2.5.5.3. Aplikimi i vetëvlerësimit

Në disa aktivitete me shkrim mësuesja kërkoi nga nxënësit që të vlerësojnë veten, të japin një vlerësim për punën e tyre personale. Aplikimi i vetëvlerësimit është pjesë e rëndësishme e vlerësimit formues, pasi që i aktivizon dhe i motivon nxënësit në mësim. Përdorimi i vetëvlerësimit mund të alikohet nëpërmjet fletave për vetëvlerësim që i përpilon mësuesja ose ndonjëherë edhe duke kërkuar ide nga nxënësit. Fletat për vetëvlerësim përbëhen nga rubrika në bazë të së cilave nxënësit vlerësojnë punimet e tyre. Gjatë aplikimit të vetëvlerësimit mësuesja vëzhgoi në përgjithësi reagimin fillestar të nxënësve për vetëvlerësimin. Gjithashtu edhe gjatë kohës kur nxënësit ishin duke mbushur fletat për vetëvlerësim. Mësuesja mbante shënime për angazhimin e nxënësve në kryerjen e vetëvlerësimit, dëshirën e tyre, kënaqësin që mund të shprehin ose mosinteresimin që mund të kishte ndonjë nxënës. Të gjitha këto ndikojnë në motivimin që dëshiron të nxis mësuesja nëpërmjet këtij aktiviteti.

2.2.5.5.4. Aplikimi i vlerësimit të ndërsjelltë

Për ti bërë nxënësit edhe më aktiv gjatë orëve mësimore mësuesja përgatiti disa fleta për vlerësim të ndërsjelltë dhe kërkoi nga nxënësit që duke përdor ato të vlerësojnë shokët e klasës. Edhe fletat për vlerësim të ndërsjelltë si ato për vetëvlerësim përbëhen nga rubrika ku përshkruhen kriteret që duhet të ketë punimi, detyra, ose eseja e nxënësve në varësi nga

ajo se për çfarë aktiviteti përdoren. Mësuesja vëzhgonë reagimet e nxënësve për të vlerësuar dhe për t'u vlerësuar nga shokët e klasës. Pas mbarimit të orës mësimore mësuesja i shënonte të gjitha reagimet e nxënësve në fletoren për shënime, për të parë se a ishin nxënësit e motivuar, si reagonin ato nëse dëshironin ose jo të vlerësojnë shokët e klasës dhe a dëshironin të ishin të vlerësuar nga shokët e klasës.

2.2.5.5.5. Përdorimi i fitbek-ut

Fitbeku është pjesë shumë e rëndësishme e vlerësimit formues, edhe vetëvlerësimi edhe vlerësimi i ndërsjellt përdoren për të dhënë në njëfarë mënyre fitbek për nxënësit, mirëpo fikbeku nga mësuesja jepet në mënyrë profesionale dhe ka rëndësi të madhe si në informimin e nxënësve me nivelin e tyre, me përparësit dhe mangësit e tyre deri në fazën aktuale, poashtu jepet edhe me qëllim për të ndihmuar nxënësit për t'u përmirësuar që të kenë më shumë sukses në të ardhmen. Fitbeku do të jepet gojarisht dhe me shkrim.

Detyra e nxënësve ishte të shkruajnë punime të shkurtra. Në punimin e parë mësuesja i jep nxënësve fitbek me gojë, dhe kërkon nga ato që ta rishkruajnë punimin duke përdorur fitbek-un që ka dhënë mësuesja. Poashtu, mësuesja do të kërkoj nga nxënësit që ta rishkruajnë punimin e dytë pasi ajo ti ketë lexuar punimet e dyta. Në fund të punimëve ato kanë të shkruar fitbek-un, të cilin do të duhet ta përdorin për të rishkruar punimin e tyre. Përveç vëzhgimeve në klasë që sa të motivuar janë nxënësit gjatë aplikimit të fitbek-ut ajo do të mund të marr të dhëna edhe nga punimet e rishkruara të nxënësve, se sa interes kanë shprehur ato për ti rishkruar punimet, sa janë përpjekur dhe sa sukses kanë arritur, këto janë elemente që tregojnë se sa të motivuar kanë qenë nxënësit.

2.2.6. Librat shkollor

Librat shkollor që përdorin nxënësit e shkollave fillore në lëndën e gjuhës angleze janë katër në varësi nga klasa në të cilën janë nxënësit. Nxënësit e klasës së gjashtë përdorin librin Message 1, nxënësit e klasës së shtatë përdorin librin Messages 2, nxënësit e klasës së tetë përdorin librin Messages 3 dhe klasës së nëntë përdorin librin, Pet Buster. Të tri librat, Message 1, 2 dhe 3 kanë struktur të njëjtë ato përmbajnë 6 module të ndara në 12 njësi. Ndërsa Pet buster përmban 16 njësi. Të katër librat i japin fokus të veçantë zhvillimit të katër aftësive që duhet të zhvillojnë nxënësit në mësimin e një gjuhe të huaj në shkollë, gjithashtu edhe gramatikës së gjuhës së huaj dhe fjalëve të reja. Të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit janë katër aftësit gjuhësore, ndërsa ky studim fokusohet vetëm në njërin prej tyre, dhe atë në të shkruarit. Në fund të çdo moduli libri ka të planifikuar një detyrë kursi në formë projekti dhe disa detyra me shkrim në formë paragrafi ose eseje të shkurtër në njësitë mësimore. Ndërsa libri Pet buster që përdoret nga nxënësit e klasave të nënta nuk ka detyrë kursi në fund por ka disa detyra me shkrim në formë paragrafi, email, eseje të shkurtër apo dhe historie të shkurtër. Detyrat me shkrim që janë të planifikuara nga mësuesja në bazë të programit të librave shkollor u shfrytëzuan për të mbledhur të dhëna për studim rastin e realizuar për këtë studim kërkimor.

2.2.7. Përdorimi i kompjuterit në klasë

Në shkollat fillore në Maqedoni nga mësuesit kërkohet që në 30 % të oreve mësimore në çdo lëndë mësimore të aplikohet përdorimi i kompjuterit. Për këtë arsye kompjuterët u përdorën edhe gjatë këtij studim rasti. Përdorimi i kompjuterit gjatë studim rasti u bë në dy orë mësimore dhe atë në periudhën e tretë dmth gjatë aplikimit të vlerësimit formues. Në njërin orë mësimore nxënësit përcaktohen të punojnë në çifte dhe u kërkohet ti shkruan një

email një shoku të klasës për ti treguar për një ngjarje dhe nxënësit tjetër ja dërgojnë mësueses emailin e shokut po bashkë me vlerësimin e tyre për emailin e shokut. Në orën e dytë të aplikimit të kompjuterit në klasë mësuesja i angazhon nxënësit që të shkruajn një histori të shkurtër në programin kompjuterik Ëord dhe t’ja dërgojnë asaj në e-mail.

2.2.8. Organizimi i orëve mësimore të gjuhës angleze gjatë studim rastit

Pjesa e parë e studimin zgjati një muaj. Gjatë muajit të parë nxënësit kanë 12 orë të gjuhën angleze dhe në 4 prej tyre ato kanë detyrë në lidhje me aftësin e tyre për të shkruar në gjuhën anglese, jo komplet ora mësimore, por pjesa më e madhe e saj i përkushtohet aftësi së nxënësve për të shkruar në gjuhën angleze. Mësuesja ka në plan që çdo javë, nxënësit të kenë detyrë me shkrim në gjuhën angleze. Kjo do të thotë se gjatë muajit të parë nxënësit kishin katër detyra shtëpie në lidhje me aftësin e tyre për të shkruar në gjuhën angleze dhe katër detyra klase për të njëjtën aftësi, këto detyra përfshijnë kryesisht disa rreshta të shkruar, një paragraf ose një ese të shkurtër në lidhje me temat përkatëse të kapitullit. Qëllimisht mësuesja i planifikon paraprakisht dhe i angazhon nxënësit me detyra me shkrim edhe në klasë edhe në shtëpi, sepse në këtë mënyrë do të përdorë qëndrimin e nxënësve ndaj detyrave të shtëpisë si një kriter për përcaktimin e motivimit të nxënësve në klasë. Mësuesja përdorë dy mënyra kur jep detyrat me shkrim si detyrë shtëpie. Në fund të orës mësimore, në të cilën nxënësit kanë ushtruar aftësinë e të shkruarit në gjuhën angleze, mësuesja u jep për detyrë shtëpie të shkruajn një paragraf ose ese të shkurtër varësisht nga ora mësimore. Ndërsa orën tjetër ku nxënësit ushtronin aftësinë e të shkruarit në gjuhën e huaj, mësuesja nuk u jep detyrë shtëpie të shkruajnë as paragraf dhe as ese të shkurtër pasi që ato ishin angazhuar paraprakisht që në orën e kaluar për të shkruar diçka në lidhje me temën që do ta trajtonin gjatë asaj ore mësimore. Kjo mënyrë u ndoq gjatë gjithë studim

rastit, pra një herë, pasi nxënësit kishin ushtruar të shkruarit në gjuhën angleze, në fund të orës mësimore mësuesja u jep për detyrë shtëpie detyrë me shkrim. Ndërsa rradhën tjetër në orën mësimore ku do të ushtrojnë të shkruarit, që një orë para nxënësit kishin detyrë me shkrim që duheshite ta kishin gati për atë orë mësimi. Gjatë pjesës së parë të studimit nxënësit u vëzhguan dhe për to u mbajtën shënime në bazë të kritereve të përcaktuara paraprakisht për t'u marrë parasysh në përcaktimin e motivimit të nxënësve në klasë, në fund të pjesës së parë të studimit rastit nxënësit ndahen në grupe në bazë të motivimit të tyre në klasë në orët e gjuhës angleze. Nxënësit u grupuan në katër grupe të emërtuar si: grupi i nxënësve shumë të motivuar, të motivuar, pak të motivuar dhe të demotivuar.

Pjesa e dytë e studimit poashtu zgjati një muaj. Sikurse në pjesën e parë të studimit edhe në pjesën e dytë nxënësit kanë 12 orë mësimore të gjuhës angleze dhe 4 orë mësimore në të cilat ushtrojnë aftësinë e të shkruarit. Në muajin e dytë nxënësit poashtu kanë detyra klase dhe detyra shtëpie me shkrim. Në fillim të periudhës së dytë të studimit mësuesja vetëm i njofton nxënësit se ato duhet të jenë të përgatitur dhe ti kushtojnë rëndësi detyrave të shtëpis sepse, kjo është periudhë kur ato do të fillojnë të vlerësohen për aktivitetin e tyre.

Pjesa e tretë e studimit zgjatë dy muaj dhe gjatë kësaj periudhe nxënësit kanë dyfishin e orëve të gjuhës angleze në krahasim me pjesën e parë dhe pjesën e dytë të studimit rastit.

Nxënësit kanë 24 orë mësimore të gjuhës angleze dhe prej tyre në 8 orë mësimore, nxënësit kryesisht aplikojnë aftësin e të shkruarit në gjuhën angleze.

Në orën e parë të kësaj pjese, mësuesja u jep nxënësve një detyrë me shkrim për ta punuar si detyrë shtëpie dhe kërkon nga nxënësit që të japin ide për kriteret që do të duhej të përdorte mësuesja kur ti vlerësoj punimet e tyre me shkrim. Mësuesja mbante shënim për idetë e nxënësve në lidhje me kriteret e vlerësimit dhe kërkon edhe nga nxënësit që ti

kushtojnë vëmendje kritereve që përmendin ato, sepse mësuesja do ti merrte parasysh sugjerimet e tyre në përcaktimin përfundimtar të kritereve të vlerësimit të atij ushtrimi me shkrim, që ato do ta punojnë si detyrë shtëpie. Në orën e ardhshme nxënësit e lexojnë detyrën e shtëpis dhe mësuesja u jep nxënësve fitbek me gojë duke u bazuar kryesisht në kriteret e përcaktuara paraprakisht me nxënësit. Kërkon nga nxënësit që të jenë të vëmendshëm në fitbek-un që u jep ajo. Pastaj kërkon nga nxënësit ta rishkruajnë të njëjtën detyrë, por duke shfrytëzuar fitbek-un që u tha ajo për ta përmirësuar detyrën me shkrim. Mësuesja kërkon nga nxënësit që në fund të orës ti japin asaj të dy detyrat me shkrim edhe verzionin para fitbek-ut me gojë edhe verzionin pas fitbek-ut që u tha ajo gjatë orës mësimore. Mësuesja dëshironte të shoh nëse kishte ndonjë ndryshim në mësim verzionit të parë dhe të dytë të detyrës me shkrim.

Në orën tjetër mësimore mësuesja i informon nxënësit me kriteret e vlerësimit që ajo i ka përpiluar për atë aktivitet me shkrim, si për shembull, përdorimin e saktë të shenjave të pikësimit dhe strukturoren e eses që ato do duhej të shkruanin. Këto janë dy kriteret që do të vlerësoj mësuesja për atë aktivitet me shkrim. Këto janë dy pikat që duhet të fokusohen nxënësit, nuk kërkohet nga ato ti përkushtojnë vëmendje të veçantë gabimeve gramatikore. Mësuesja planifikoi që edhe më shumë ti bëj nxënësit pjesëmarrës në procesin e vlerësimit. Mësuesja përpiloi rubrika për vlerësim të ndërsjelltë dhe ja jep ato nxënësve, i ndau nxënësit në grupe dhe kërkoi nga ato të vlerësonin detyrën e shtëpisë të shokëve të klasës. Si detyrë shtëpie nxënësit kishin për të shkruar një histori të shkurtër. Gjatë orës mësimore ku nxënësit vlerësojnë shokët e klasës në bazë të rubrikave për vlerësim të ndërsjelltë, mësuesja i vëzhgon reagimet e nxënësve, sa të gatshëm ndihen ato të vlerësojnë shokët e tyre dhe si ndihen kur e dinë se do të vlerësohen nga shokët e tyre. Për të gjithë reagimet e

nxënësve gjatë orës mësimore mësuesja mundohet të mbajë shënime. Në fund të orës mësuesja kërkon nga nxënësit ti dorëzojnë asaj edhe esen e shkruar edhe fletën me rubrikat e përcaktuara për vlerësimin e ndërsjelltë.

Në një orë tjetër mësuesja kërkon nga nxënësit të shkruajn një paragraf për një temë të caktuar, kur nxënësit e lexojnë paragrafin në klasë ajo u jep atyre fitbek me gojë për detyrën me shkrim dhe kërkon nga ato ta rishkruajnë atë për detyrë shtëpie, por duke përdorur si referim fitbek-un me gojë që i tha mësuesja gjatë orës mësimore.

Të njëjtën metodë që përdorë mësuesja në një orë tjetër mësimore, por këtë radhë me detyrat e shtëpis dhe me fitbek me shkrim. Për detyrë shtëpie nxënësit kanë të shkruajnë për një histori të shkurtër për një temë nga kapitulli. Mësuesja i mbledh detyrat e shtëpisë, i lexon ato në shtëpi dhe secilit nxënësi i shkruan fitbek me shkrim. Përsëri orën tjetër kërkon nga nxënësit të rishkruajnë historin duke përdorur fitbek-un me shkrim që ato kanë të shkruar në fund të punimeve të tyre.

Në dy nga orët mësimore mësuesja ndërlidhë edhe kompjuterin për detyrat me shkrim të nxënësve. Nga nxënësit kërkohet që ti shkruajn detyrat e tyre me shkrim në programin Ëord të kompjuterit dhe si të tilla ti dorëzohen mësueses. Në këtë mënyrë mësuesja do të vërej ndikimin që mund të ketë programi kompjuterik që mundëson edhe korrigjime për disa gabime drejtëshkrimore dhe gramatikore në gjuhën angleze.

Mësuesja përdori forma të ndryshme të vlerësimit formues për të parë nëse metodat e ndryshme kanë ndikim të ndryshëm në motivimin e nxënësve gjatë orëve të gjuhës së huaj, dhe më saktësisht motivimi i nxënësve në aftësin e tyre për të shkruar në gjuhën angleze.

2.2.9. Materialet

2.2.9.1. Kurikulat dhe planet ditore të përdorura nga mësuesit

Në këtë studim u bë analizë përmbajtësore e 21 kurikulave dhe 21 plane ditore. Qëllimi i analizës përmbajtësore të kurikulave dhe planeve ditore ishte për të parë nëse mësuesit i kanë planifikuar metodat e vlerësimit ashtu edhe si i zbatojnë ose jo. Rezultatet e analizës përmbajtësore do të japin të dhënat për planifikimin e vlerësimit në kurikulat dhe në planet ditore të mësuesve. Këto të dhëna krahasohen me rezultatet e pyetësorëve, intervistave, dhe të dhënave të marra nga vëzhgimet gjatë orëve mësimore. Në fund të çdo ore mësimore të vëzhguar, nga mësuesi/ja u kerkua kurikula dhe plani ditor për atë orë mësimore, dhe u mbajtën shënime nëse ai/ajo kishte të përfshirë mënyrën e vlerësimit në kurikulën që përdor dhe planin ditor të përgatitur për atë orë mësimore. Shënimet u mbajtën në çeklista të përgatitura për këtë studim (shiko shtojcën # 6).

2.2.10. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Mësuesit, nxënësit dhe prindërit pjesëmarrës janë pjesë e studimit nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave. Përdorimi i pyetësorëve gjatë punimit të një studimi ka rëndësi të madhe. Një prej arsyeve të përdorimit të pyetësorëve në studime të tilla është se ato formulohen lehtë, dmth i kursejnë studjuesit kohë për ti përpiluar ato. Një arsye tjetër e përdorimit të tyre është se pyetësorët janë të lehta për tu përdorur edhe nga të anketuarit, pjesëmarrësit në studim qofshin ato edhe jo shumë të mësuar me mënyrën e plotësimit të pyetësorëve. Arsya e tretë e përdorimit të pyetësorëve në studim është se është e lehtë të bëhet analizimi i rezultateve të pyetësorëve. Pyetësorët zakonisht shërbejnë për të mbledhur të dhëna kuantitative, dhe e tillë është arsyeja e përdorimit të tyre edhe në këtë studim. Pyetjet e pyetësorëve janë me zgjedhje të shumëfishta, dhe pjesëmarrësit duhet

vetëm të rrethojnë një nga përgjigjet e dhëna. Ndërsa për të mbledhur të dhëna më të zgjeruara për çështjet që trajtohen në studim, u përdorën intervistat e përpiluara për këtë studim. Pyetjet e intervistave kërkojnë nga pjesëmarrësit të shprehin opinionin e tyre më mënyrë më të zgjeruar. Për ta parë më nga afër problemin në studim do të kryet një studim rasti dhe disa vëzhgime gjatë disa orëve mësimore.

2.2.10.1 Pyetësorët

Për këtë studim u përlipuan tre lloj pyetësorësh: pyetësorët për mësuesit, pyetësorët për nxënësit dhe pyetësorët për prindërit. Pyetjet e të tri lloje të pyetësorëve janë të ngjajshme pasi që ato janë përpiluar për të mbledhur të dhëna për çështje të temave të njëjta. Nga pjesëmarrësit në studim nuk kërkohet asnjë informacion personal. Të tri llojet e pyetësorëve ishin anonim me qëllim që pjesëmarrësit të ndiheshin të lirë për tu përgjigjur. Në fillim të çdo pyetësi është dhënë informacion në formë të shkruar, tiulli i studimit, arsyeja e përdorimit të atij pyetësi për studimin dhe udhëzime për mënyrën e plotësimit të pyetjeve të pyetësit

2.2.10.1.1. Pyetësorët për mësuesit

188 nga mësuesit që kanë marrë pjesë në këtë studim mbushën pyetësin për mësuesit.

Pyetjet e pyetësit janë të njëjta për të gjithë mësuesit edhe pse ato janë mësues të lëndëve të ndryshme mësimore. Pyetësi i përpiluar për mësuesit përbëhet nga 11 pyetje. Të gjitha pyetjet janë me zgjedhje të shumëfishtë, gjë që e thjeshtëson punën e mësuesve pjesëmarrës pasi që ato vetëm rrethojnë njërin nga përgjigjet, atë të cilën e mendojnë si më të përafërt me mendimin e tyre personal për pyetjet e dhëna.

2.2.10.1.2. Pyetësorët për nxënësit

Numri i nxënësve të cilët e plotësuan pyetësin ishte më i madhë në krahasim me numrin e mësuesve. 572 nxënës e plotësuan pyetësin për nxënësit. Pyetësi i përpiluar posaçërisht për nxënësit e shkollave fillore, që kanë marrë pjesë në këtë studim përbëhet nga 11 pyetje. Të gjitha pyetjet e pyetësit për nxënësit janë pyetje me zgjedhje të shumëfishta, nxënësit thjesht duhet të rrethojnë njërin nga përgjigjet e dhëna.

2.2.10.1.3. Pyetësorët për prindërit

Në fillim të studimit u planifikua që numri i nxënësve dhe prindërve të cilët do të përgjigjeshin në pyetësorët përkatës do të ishte i njëjtë, mirëpo 12 nga prindërit nuk u përgjigjën në pyetjet e pyetësit për prindërit. Kështu që nga 572 prindër që u planifikuan të marrin pjesë në studim vetëm 560 prej tyre plotësuan pyetësin për prindërit. Pyetësi ka 9 pyetje. Sikurse pyetjet e pyetësit për mësuesit dhe për nxënësit edhe pyetjet e pyetësit për prindërit janë pyetje me zgjedhje të shumëfishta, prindërit vetëm rrethojnë një nga mundësit e dhëna.

2.2.10.2. Intervistat

Përdorimi i intervistave për këtë studim ishte i rëndësishëm sepse mundëson mbledhjen e të dhënave kualitative. Përgjigjet për pyetjet e intervistave janë më të gjata sepse paraqesin mendimin personal të pjesëmarrësve të dhënë në një formë më të zgjeruar, përgjigjet përmbajnë gjithashtu edhe arsyetimin dhe argumentimin e përgjigjeve. Dy lloje intervistash u përpiluan për këtë studim: intervista për mësuesit dhe intervista për nxënësit. Numri i mësuesve dhe nxënësve që u intervistuan ishte më i vogël në krahasim me numrin e mësuesve dhe nxënësve që plotësuan pyetësorët përkatës. Nuk u intervistuan të gjithë

mësuesit dhe nxënësit të cilët plotësuan pyetësin, por vetëm disa prej tyre. 88 mësues dhe 150 nxënës u intervistuan.

2.2.10.2.1. Intervistat për mësuesit dhe për nxënësit

Në intervistat e përpiluara për këtë studim, mësuesit dhe nxënësit duhej të përgjigjeshin në 5 pyetje. Intervistat e mësuesve dhe nxënësve përmbajnë pyetje të ngjajshme dhe numri i pyetjeve është i njëjtë në të dy llojet e intervistave.

2.2.10.3. Çeklistat e përdorura gjatë orëve të vëzhguara

Fletat e vëzhgimit që u përdorën gjatë studimit u përpiluan posaçërisht për këtë studim për të qënë të përshtatshme në mbledhjen e të dhënave për temën që trajton studimi. Fleta e vëzhgimit përbëhej nga 8 pyetje me mundësi për tu përgjigjur *po* ose *jo*, dhe në fund të çdonjërës pyetje ishte e lënë hapsirë bosh për të komentuar përgjigjen më gjërësisht (shiko shtojcën #6). 5 nga pyetjet ishin për orën mësimore dhe 3 të tjera u plotësuan pas mbarimit të orëve mësimore. Fletat e vëzhgimit ishin anonime. Në fletat e vëzhgimit nuk u shënuan emrat e mësuesve të cilët u vëzhguan dhe asnjë informacion tjetër personale për mësuesit, por vetëm u plotësuan fletat e vëzhgimit me informacion për çështjet që trajtonte çdo pyetje. Qëllimi i përdorimit të fletave të vëzhgimit nuk ishte mbledhja e të dhënave personale të mësuesve, por grumbullimi i sa më shumë të dhënave për mënyrën e përdorimit të vlerësimit në klasë dhe ndikimin e këtij vlerësimi në motivimin e nxënësve.

3.2.11. Çështjet etike

Gjatë realizimit të këtij studimi i është dhënë një rëndësi e veçantë etikes. Të dhënat e mbledhura me anë të të gjithë instrumenteve që u përdorën gjatë këtij studimi, nuk do të përdoren për asnjë çështje tjetër, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me këtë studim.

Gjithashtu instrumentet për mbledhjen e të dhënave nuk kërkojnë asnjë informacion

personal për pjesëmarrësit në këtë studim, gjë që e mbanë të fshehtë identitetin e pjesëmarrësve.

KAPITULLI III: ANALIZA E REZULTATEVE

3.1. Analiza e intervistave

Të dhënat për këtë studim u mbledhën nga burime të ndryshme duke përdorur disa instrumente për mbledhjen e të dhënave, dhe si rrjedhojë edhe analizimi i të dhënave bëhet jo në përgjithësi por i ndarë në analizim i të dhënave të grumbulluara nga intervistat, pyetësorët, orët e vëzhguara dhe studim rasti i realizuar si pjesë e kësaj studimi. Në këtë studim u përdorën dy lloje intervistash, dhe atë intervista për mësuesit dhe intervista për nxënësit

3.1.1. Analiza e intervistave të mësuesve

3.1.1.1 Testimi i hipotezës dhe nënhipotezës të studimit përmes analizës së intervistave të mësuesve

Për këtë studim u intervistuan 88 mësues. Intervista ka 5 pyetje. Për analizimin e përgjigjeve të të intervistuarve dhe për organizim të mirë të paraqitjes së rezultateve u përdor kodimi i të dhënave të marra nga përgjigjet e mësuesve të intervistuar.

1. Kodim për përgjigjet e pyetjes së parë ishte NDP (ndikim pozitiv), NDN (ndikim negativ), NND (nuk ka ndikim), NDNU (ndikim neutral). Të intervistuarit që mendojnë se vlerësimi ndikon në motivimin e nxënësve thonë se vlerësimi është një faktorë shumë i rëndësishëm në motivimin e nxënësve. 81 nga 88 mësues e konsiderojnë vlerësimin si një mjet shumë delikat dhe që duhet të përdoret nga mësuesit me shume kujdes pasi që ai mund të ndikojë edhe pozitivisht edhe negativisht në motivimin e nxënësve. 4 nga 88 mësues mendojnë se vlerësimi nuk luan ndonjë funksion shumë të rëndësishëm në motivimin e nxënësve për të mësuar, ka faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në mënyrë më të drejtëpërdrejtë

në motivimin e nxënësve. Pasiqë nxënësit që nuk duan të mësojnë nuk mund të ndikohen nga vlerësimi sepse nuk ju intereson vlerësimi dhe ato nxënës që duan të mësojnë, mësojnë sepse janë të interesuar për të mësuar.

2. Kodimi për përgjigjet e pyetjes së dytë ishte NDNJ (ndikim të njëjtë), NDSN (ndikim sipas nxënësve). Mësuesit më pyetjen e dytë përgjigjen se vlerësimi nuk mund të ndikojë në të njëjtën mënyrë të të gjithë nxënësit pasiqë edhe nxënësit nuk janë të njëjtë ato ndryshojnë në çdo aspekt nga njëri tjetri. Mësuesit shprehen se përgjigjja e dhënë në pyetjen e parë nuk vlenë për të gjithë nxënësit në përgjithësi, ato i janë referuar ndonji grupi nxënësit kur janë përgjigjur në pyetjen e parë. Mësuesit përgjithësisht thonë se nxënësit të cilët tregojnë sukses të lartë në mësim mund të ndikohen nga vlerësimi që i jep mësuesi/ja sepse e konsiderojnë të rëndësishëm vlerësimin e marrë, nxënësit të cilët nuk janë të interesuar gjatë orës mësimore, nuk ndikohen nga vlerësimi. Mësuesit të cilët thonë se vlerësimi nuk ndikon në motivimin e nxënësve mendojnë se nxënësit të cilët nuk duan të mësojnë nuk mund të ndikohen nga vlerësimi sepse nuk ju intereson as mësimi dhe as vlerësimi që marrin nga mësuesi/ja dhe ato nxënës që duan të mësojnë, mësojnë sepse janë të interesuar për të nxënë.

3. Kodimi për përgjigjet e pyetjes së tretë ishte GR1NP (ndikim pozitiv për grupin e parë – të demotivuar) GR1NN (ndikim negativ për grupin e parë- të demotivuar), GR1NND (nuk ka ndikim për grupin e parë – të demotivuar), GR1NDNU (ndikim neutral për grupin e parë – të demotivuar). Të njëjtat kode u përdoren edhe për të tre grupet e tjera. Nga përgjigjet e mësuesve vërehet se shumica e mësuesve mendojnë se vlerësimi mund të ndikojë pozitivisht për disa nxënës dhe negativisht për disa nxënës të tjerë, ajo varet nga nxënësit poashtu edhe nga vlerësimi që ato marrin. Të gjithë mësuesit mendojnë se vlerësimi nuk

ndikon të nxënësit e demotivuar. Nxënësit e demotivuar nuk shprehin interes për mësim dhe poashtu nuk i intereson as vlerësimi që ato marrin nga mësuesi, vlerësimi nuk konsiderohet si faktor që mund të ndikojë në motivimin e tyre për të mësuar. 14 mësues të intervistuar mendojnë se kur nxënësit pak të motivuar marrin një vlerësim pozitiv ato motivohen për të mësuar më shumë, dhe poashtu ato demotivohen nëse marrin një vlerësim më të ulët nga ajo se çfarë kanë pritur ato, por mund të ndodh edhe e kundërta, pra të motivohen për të mësuar më shumë, për të patur më shumë sukses. 21 mësues të tjerë mendojnë se vlerësimi mund të ndikojë disi por nuk është një faktor shumë i rëndësishëm në motivimin e tyre, sipas tyre faktorë të tjerë të jashtëm mund të ndikojnë shumë më tepër në motivimin e nxënësve në krahasim me vlerësimin. 20 mësues mendojnë se për nxënësit e motivuar vlerësimi është një faktor i rëndësishëm në motivimin e tyre, ato motivohen kur marrin një vlerësim pozitiv nga mësuesit dhe demotivohen nëse marrin ndonji notë të dobët, ose një vlerësim më të ulët se ajo çfarë kanë pritur ato. 15 mësues mendojnë se vlerësimi ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve, nxënësit motivohen më tepër kur marrin një vlerësim të mirë por ato gjithashtu mund të motivohen edhe kur marrin ndonji notë më të ulët, ajo ndikon që ato të punojnë më shumë që të kenë sukses në të ardhmen. 28 mësues e konsiderojnë vlerësimin si një nga faktorët më të rëndësishëm që ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në motivimin e nxënësve që mund të klasifikohen si nxënës shumë të motivuar. Këto nxënës janë kryesisht nxënës shembullor dhe që punojnë shumë për të patur sukses në mësim. Ato e shohin vlerësimin që marrin nga mësuesi/ja si rezultat të punës së tyre, për këtë arsye ai ka domethënie shumë të madhe për motivim e tyre. Notat e mira dhe vlerësimi pozitiv që nxënësit marrin për aktivitetin e tyre në klasë dhe detyrat e shtëpisë i krijojnë nxënësve siguri dhe i inkurajojnë ato për të punuar vazhdimisht. Për më tepër, për

këtë grup nxënësish, edhe një notë më e ulët mund të ndikojë pozitivisht për ti motivuar për të dhënë maksimumin e tyre për të arritur aty ku duan. 7 mësues mendojnë se vlerësimi pozitiv dhe notat e mira ndikojnë pozitivisht në motivimin e nxënësve por kur nxënësit vlerësohen me nota më të ulta se sa mendojnë ato që meritojnë, vlerësimin mund të ndikojë shumë negativisht te këto nxënës, mund edhe ti demotivoj ato. Mësuesit thonë se ato mundohen të gjejnë te puna e nxënësve elemente pozitive, për tja vënë ato në dukje, ndonjëherë dhe sidomos kur i njohin nxënësit mirë, i kanë dhënë nxënësve një notë më shumë vetëm e vetëm për ti motivuar ato.

4. Kodimi për përgjigjet e pyetjes së katër ishte FJSH (faktorët jashtë shkollë), FBSH (faktorët brenda shkollës). Në përgjigjen e kësaj pyetje, nuk ka ndarje të mësuesve që i konsiderojnë të rëndësishëm vetëm faktorët jashtë shkollës ose vetëm faktorët brenda shkollës që mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve. Të gjithë mësuesit kanë përmendur edhe faktor brenda shkollës por edhe faktor jashtë shkollës që ndikojnë në motivimin; e nxënësve. Faktorët më shumë të përmendur nga mësuesit për tu përgjigjur në këtë pyetje janë: familja e nxënësve, gjendja ekonomike, të paturit shok një nxënës të mirë në mësim, marrëdhënia mësues-nxënës, mosha e nxënësve, suksesi i tyre, metodat e mësimdhënies, mënyra e vlerësimit të nxënësve, etj. Nga 88 mësuesit e intervistuar vetëm 2 nuk kanë përmendur vlerësimin si një faktor të rëndësishëm për motivimin e nxënësve për të mësuar.

5. Kodimi i pyetjes së pestë ishte NDNJ (ndikim i njëjtë), NDJNJ (ndikim jo i njëjtë). Në bazë të përgjigjeve të mësuesve në këtë pyetje vërehet se vlerësimi formues nuk ndikonë në mënyrë të njëjtë për të gjithë nxënësit. Të gjithë mësuesit e intervistuar thonë se ndikimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve varet nga shumë faktor. Se çfarë ndikimi mund të ketë vlerësimi formues në motivimin e nxënësve varet se çfarë lloje të vlerësimit

formues përdor mësuesi/ja, si e aplikon vlerësimin, gjendja emocionale e nxënësve, aftësia e nxënësve për ta kuptuar vlerësimin, dhe poashtu gjendja momentale e motivimit të tyre, në momentin kur e marrin vlerësimin, dhe se sa të motivuar janë nxënësit në përgjithësi për të mësuar.

3.1.1.2. Diskutim për hipotezën e studimit, vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve, sipas mësuesve të intervistuar

Nga përgjigjet e mësuesve vërehet se vlerësimi konsiderohet si mjet i rëndësishëm që ndikon në motivimin e nxënësve. Sipas mësuesve të intervistuar, edhe pse vlerësimi nuk është faktori i vetëm që ndikon në motivimin e nxënësve, përsëri ai i ngarkon mësuesit me përgjegjësi që ta përdorin vlerësimin me kujdes.

3.1.1.3. Diskutim për nënhipotezën, vlerësimi formues ndikon në mënyrë të njëjtë në motivimin e të gjithë nxënësve, sipas mësuesve të intervistuar

Sipas mësuesve të intervistuar vlerësimi formues nuk ndikon në mënyrë të njëjtë te të gjithë nxënësit. Ndikimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve mund të jetë edhe pozitiv por edhe negativ, varësisht nga nxënësit vlerësimi mund të ndikoj pozitivisht ose negativisht në motivimin e nxënësve.

3.1.2. Analiza e intervistave të nxënësve

3.1.2.1. Testimi i hipotezës dhe nënhipotezës të studimit përmes analizës së intervistave të nxënësve

Për këtë studim u intervistuan 150 nxënës të shkollave fillore. Intervista e nxënësve përbëhet nga 5 pyetje. Për të patur një paraqitje më të qartë të rezultateve të përgjigjeve të pyetësorit të nxënësve u bë kodimi i përgjigjeve.

1. Kodimi për përgjigjet e pyetjes së parë ishte NDP (ndjesi pozitive), NDN (ndjesi negative), NND (nuk ka ndonjë ndjesi të veçantë) NDNU(ndjesi neutrale). Shumica e

nxënësve, dhe atë 101 nga 150 nxënësit të intervistuar u përgjigjen se vlerësimi i ka bërë ato të ndihen në disa raste mirë në disa raste keq. Ka patur raste kur vlerësimi ka ndikuar shumë pozitivisht por ka ndodhur edhe e kundërta. Një notë e mire, një vlerësim pozitiv, një koment i mirë i thënë nga mësuesi/ja ka ndikim shumë pozitiv dhe sidomos raset kur vlerësimi ka qënë më i mirë nga ajo çfarë kanë pritur vetë nxënësit. Por një vlerësim më i ulët nga pritshmëritë e nxënësve ka ndikuar negativisht në motivimin e tyre. 20 nga 150 nxënës thonë se vlerësimi çdoherë ndikon pozitivisht për ato, jo vetëm kur kanë nota të mira dhe vlerësime pozitive nga mësuesi/ja por edhe kur nuk kanë marrë notën që kanë pritur ose vlerësimin që kanë dëshiruar ato nuk janë demotivuar por përkundrazi janë motivuar për të punuar edhe më shumë për të arritur suksesin e dëshiruar. 29 nga 150 nxënës shprehen se ato nuk kanë asnjë ndjesi të veçantë kur vlerësohen nga mësues-i/ja, atyre nuk i intereson se çfarë notë kanë marrë Vlerësimi për këto nxënës nuk ka asnjë ndikim në motivimin e tyre.

2. Kodimi për përgjigjet e pyetjes së dytë ishte NDP1 (ndjesi pozitive nga vlerësimi nga shokët e klasës), NDN1 (ndjesi negative), NND1 (nuk ka ndonjë ndjesi të veçantë), NDNU (ndjesi neutrale). Të njëjtat kode por me shifrën 2 u përdorën për ndjesit që kanë nxënësit nga vlerësimi i shokëve të klasës. Nxënësit e shohin vlerësimin nga shokët e klasës dhe vlerësimin e shokëve të klasës si më argëtuese në krahasim nga vlerësimi që ato marrin nga mësuesit. Shumica e nxënësve dhe atë 89 nga 150 nxënës të intervistuar thonë se ato e kanë shumë kënaqësi të vlerësojnë shokët e klasës dhe të vlerësohen nga shokët e klasës. 29 nga 150 nxënës thonë se atyre u pëlqen të vlerësojnë shokët e klasës dhe e bejnë me shumë kënaqësi por ndihen pak në siklet kur vlerësohen edhe ato nga shokët e tyre të klasës, dhe sidomos kur shokët e tyre të klasës janë më të mirë në mësim se ato. 25 nga 150 nxënës

thonë se atyre u pëlqen të vlerësojnë shokët e klasës, gjithashtu u pëlqen edhe të vlerësohen nga shokët e klasës të cilët janë të mirë më mësim por nuk u pëlqen kur atyre i rastis që të vlerësohen nga shokët e klasës të cilët janë të dobët në mësim. Pasiqë sipas tyre, këto nxënës nuk do të mund të japin vlerësimin e duhur për ato, ndoshta edhe me ndihën e rubrikave për vlerësim të përgatitura nga mësuesi/ja. 7 nxënës thonë se nuk ka diçka interesante që do ti jepte atyre ndonjë ndjesi të veçantë as në rastet kur ato duhet të vlerësojnë shokët e klasës dhe as në aktivitetet kur ato vlerësohen nga shokët e klasës.

3. Kodim për përgjigjet e pyetjes së tretë gjithashtu ishte NDP (ndjesi pozitive), NDN (ndjesi negative), NND (nuk ka ndonjë ndjesi të veçantë) NDNU (ndjesi neutrale). Shumica e nxënësve të intervistuar dhe atë 137 nga 150 nxënës të intervistuar mendojnë se të qëniti pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit është ndjesi shumë pozitive, i bënë ato të ndihen më të rëndësishëm duke marrë përgjegjësi në klasë, ato thonë pasi ato kanë qenë pjesëmarrës në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit ato duhet të përpiqen më shumë për ta dhënë më të mirën e tyre për ti respektuar ato kritere. Asnjë nga nxënësit nuk ka thënë që pjesëmarrja në përcaktimet e kriterëve të vlerësimit i bënë ato të ndihen keq, por 13 nga 150 nxënës thonë se nuk kanë ndonjë ndjesi të veçantë gjatë pjesëmarrjes në përcatimin e kriterëve të vlerësimit, ato nuk paraqesin as interes për pjesëmarrje në përcaktimin e kriterëve që do të përdoren për vlerësimin e tyre.

4. Kodimi për pyetjen e katërt të intervistës së nxënësve ishte NDP (ndikim pozitiv), NDN (ndikim negativ), NND (nuk ka ndikim), NDNU (ndikim neutral). Shumica e nxënësve që u përgjigjën në këtë pyetje të intervistës dhe atë 125 nga 150 nxënës të intervistuar thanë që informimi me kriteret e vlerësimit para se ato të vlerësohen ka një ndikim shumë pozitiv në motivimin e tyre. Kur ato i dinë kriteret e vlerësimit ato kanë një model që duhet të ndjekin

që të kenë sukses, gjithashtu njohja e kriterëve të vlerësimit i çliron ato nga emocionet dhe stresi që kanë nxënësit çdoherë kur e din se do të vlerësohen për një detyrë, në një test apo thjesht në një aktivitet gjatë orës mësimore dhe gjithashtu i bën të ndihen më të sigurt në vete. 25 nga 150 nxënës thonë se informimi me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen nuk ka ndonjë ndikim në motivimin e tyre, ato thonë se nuk janë të shqetësuar për mënyrën e vlerësimit dhe as se çfarë vlerësimi marrin nga mësuesi.

5. Kodimi për pyetjen e pestë të intervistës ishte FJSH (faktorët jashtë shkolle), FBSH (faktorët brenda shkollës). Në këtë pyetje nxënësit përmendin edhe faktor brenda shkollës edhe faktor jashtë shkollës që ndikojnë në motivimin e tyre. Si faktor që ndikojnë më së shumti në motivimin e nxënësve u përmendën: notat që u vëndojnë mësuesit, vlerësimet në forma të ndryshme, vlerësimet me shkrim, fjalët e mira që ja thonë mësuesit pas një përgjigje të saktë, vlerësimet pozitive, dhuratat dhe shpërblimet nga prindëri, fjalët e bukura që marrin prej tyre, premtimet që ju bejnë prindërit nëse do të kenë suksese në mësim, por edhe thjeshtë dëshira e tyre për të patur suksese në mësim. Shumica e nxënësve 127 prej 150 nxënësve të intervistuar përmendën se në motivimin e tyre ndikon vlerësimi në forma të ndryshme, si thejstë nota e nxënësve, vlerësimi gojor, vlerësimi me shkrim, komente pozitive, etj.

3.1.2.2. Diskutim për hipotezën e studimit, vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve për të nxënë, sipas nxënësve të intervistuar

Nga analizimi i përgjigjeve të nxënësve në intervistë vërehet se shumica e nxënësve mendojnë se vlerësimi luan një funksion të rëndësishëm në motivimin e tyre, pra ato mendojnë se vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e tyre edhe pse disa nxënës, por në numër më të vogël e mendojnë të kundërtën .

3.1.2.3. Diskutim për nënhipotezën, vlerësimi formues ndikon në mënyrë të njëjtë në motivimin e të gjithë nxënësve, sipas nxënësve të intervistuar

Nxënësit e intervistuar japin mendime të ndryshme për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e tyre, si rrjedhojë, kuptohet se sipas tyre vlerësimi formues nuk ka të njëjtin ndikim te të gjithë nxënësit, shumica e tyre mendojnë se vlerësimi i krijon atyre një ndjesi pozitive, por ka gjithashtu edhe nxënës të tjerë, edhe pse më të pakët në numër, që mendojnë se vlerësimi ndikon te to negativisht, dhe të tjerë që nuk e konsiderojnë vlerësimin si një faktor që mund të ndikojë në motivimin e tyre.

3.2. Analiza e pyetësorëve

Tre lloj pyetësorësh u përdorën për këtë studim dhe atë: pyetësori për mësuesit, pyetësori për nxënësit dhe pyetësori për prindërit.

3.2.1. Analiza e pyetësorit për mësuesit

Pyetësori për mësuesit është njëri nga instrumentet e përdorur për mbledhjen e të dhënave për këtë studim. Në pyetjet e pyetësorit të përgatitur për këtë studim, u përgjigjën 188 mësues të shkollave fillore të Strugën. Mësuesit u klasifikuan në 5 grupe në bazë të eksperiencës së tyre në procesin e mësimdhënies.

3.2.1.1. Shpërndarja e vlerave të frekuencave për kampionit mësues që plotësuan pyetësorin

Tabela 2 Statistika përshkruese për variabëlin eksperiencia në pofesionin si mësues/e

<i>1. Eksperiencia në punë</i>				
	<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid deri në 5 vjet	14	7.4	7.4	7.4
6-10 vjet	35	18.6	18.6	26.1

11-15 vjet	35	18.6	18.6	44.7
16-20 vjet	42	22.3	22.3	67.0
mbi 20 vjet	62	33.0	33.0	100.0
Total	188	100.0	100.0	

Nga tabela e mësipërme shihet se pyetjes për eksperiencën e tyre si mësues/e i janë përgjigjur në total 188 mësues të cilët u klasifikuan në pesë grupe, deri në 5 vjet eksperiencë pune, 6-10 vjet, 11-15 vjet, 16-20 dhe mbi 20 vjet eksperiencë pune në procesin e mësimdhënies. 7.4 % ose 14 mësues të cilët u përgjigjën në pyetjet e pyetësorit janë mësues me eksperiencë pune deri në 5 vjet. 18.6 % ose 35 mësues u klasifikuan në grupin prej 6 deri në 10 vjet eksperiencë pune, gjithashtu në grupin tjetër prej 11-15 vjet eksperiencë pune u klasifikuan 18.6 % ose 35 mësues. 22.3 % ose 42 mësues u klasifikuan në grupin e mësuesve me eksperiencë punë prej 16-20 vjet. Ndërsa 33.0 % ose 62 nga mësuesit që u përgjigjën në pyetësor janë pjesë e grupit të mësuesve që kanë mbi 20 vjet eksperiencë pune si mësues/e. Këto rezultate vizualisht janë të paraqitura në grafikun më poshtë




Figura 1. Grafiku i ndarjes së mësuesve në grupe në bazë të eksperiencës në punë

Tabela 3. Statistika përshkruese e ndikimit të vlerësimit në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve në pyetjen e dytë të pyetësorit

2. Ndikimi i vlerësimit në motivimin e nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	27	14.4	14.4	14.4
	Ndoshta	6	3.2	3.2	17.6
	Po	155	82.4	82.4	100.0
	Total	188	100.0	100.0	

Në pyetjen e dytë të pyetësorit mësuesit pyeten nëse ato mendojnë se vlerësimi në përgjithësi mund të ndikojë në motivimin e nxënësve. Nga tabela më sipër shohim se mësuesit kishim tre mundësi, *Po* , *Ndoshta* dhe *Jo* për tu përgjigjur në këtë pyetje. Kësaj pyetje i janë përgjigjur 188 mësues, 14.4 % ose 27 mësues mendojnë se vlerësimi i nxënësve nuk ndikon në motivimin e tyre për të mësuar. 3.2 % ose 6 mësues nuk kanë një bindje të definuar qartë për ndikimin e vlerësimit në motivimin e nxënësve dhe mendojnë se ndoshta vlerësimi mund të ndikojë në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër, shumica e mësuesve, 82,4% ose 155 mësues mendojnë se vlerësimi ka ndikim në motivimin e nxënësve. Grafiku më poshtë paraqet rezultatet e njëjta në mënyrë vizuale



Figura 2. Grafiku i ndikimit të vlerësimit në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve në pyetjen e dytë të pyetësorit.

Tabela 4 Statistika përshkruese për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve

3. Ndikimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve

		<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid	Ndikim shumë negativ	4	2.1	2.1	2.1
	Ndikim negativ	27	14.4	14.4	16.5
	As pozitiv as negative	34	18.1	18.1	34.6
	Ndikim pozitiv	83	44.1	44.1	78.7
	Ndikim shumë pozitiv	40	21.3	21.3	100.0
	Total	188	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet se pyetjes për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve i janë përgjigjur në total 188 mësues. Në këtë pyetje 2.1% ose 4 mësues janë përgjigjur se vlerësimi formues ndikon shumë negativisht në motivimin e nxënësve. 14.7% ose 27 mësues mendojnë se vlerësimi formues ndikon negativisht në motivimin e nxënësve. Ndërsa 18.1% ose 34 mësues nuk mendojnë se vlerësimi formues mund të ndikojë në motivimin e nxënësve, ato janë përgjigjur, se vlerësimi formues nuk ndikon as negativisht as pozitivisht në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër 44.1 % ose 83 mësues mendojnë se vlerësimi formues ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve, madje 21.3 % ose 40 mësues mendojnë se vlerësimi formues ka ndikim shumë pozitiv në motivimin e nxënësve. Rezultatet e njëjta janë paraqitur në mënyrë vizuale në grafikun më poshtë




Figura 3. Grafik i ndikimit të vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve në pyetjen e tretë të pyetësorit

Tabela 5 Statistika përshkuese për llojet e fitbek-ut që ndikojnë në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve në pyetjen e katërt të pyetësorit.

4. Dallimi midis ndikimit të fitbek-ut me gojë dhe me shkrim në motivimin e nxënësve

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid fitbek-u me gojë	16	8.5	8.5	8.5
fitbek-u me shkrim	44	23.4	23.4	31.9
Asnjëri	54	28.7	28.7	60.6
të dy	74	39.4	39.4	100.0
Total	188	100.0	100.0	

Nga tabela më sipër shohim se pyetjes për llojet e fitbek-ut që ndikojnë në motivimin e nxënësve i janë përgjigjur 188 mësues dhe për 8.5 % ose 16 mësues fitbeku me gojë ndikon më shumë në motivimin e nxënësve, ndërsa 23.4 ose 44 mësues mendojnë të kundërtën, ato e konsiderojnë fitbek-un me shkrim më motivues. 28.7 % ose 54 mësues nuk e shohin as fitbek-un me shkrim as fitbek-un me gojë si motivues për nxënësit. Ndërsa nga ana tjetër 39.4 % ose 74 mësues që u përgjigjën në këtë pyetje mendojnë se edhe fitbeku me shkrim edhe fitbeku me gojë ndikojnë në motivimin e nxënësve. Në mënyrë vizuale të njëjtat rezultate janë paraqitur në grafikun më poshtë



Figura 4. Grafiku për llojet e fitbek-ut që ndikojnë në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve në pyetjen e katërt të pyetësorit.

Tabela 6. Statistika përshkruese për përgjigjet e mësuesve në pyetjen e pestë të pyetësorit, se çfarë mund të jetë më motivuese për nxënësit nota apo fitbeku

5. Dallimi midis ndikimit të notës dhe fitbek-ut në motivimin e nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nota	47	25.0	25.0	25.0
	Fitbeku	122	64.9	64.9	89.9
	te dyja bashkë	13	6.9	6.9	96.8
	asnjëra nga të dyja	6	3.2	3.2	100.0
Total		188	100.0	100.0	

Nga tabela më sipër shohim se pyetjes për dallimin midis ndikimit të notës dhe fitbek-ut në motivimin e nxënësve i janë përgjigjur 188 mësues dhe për 25.0 % ose 47 mësues nota është më motivuese për nxënësit, ndërsa 64.9% ose 122 mësues mendojnë se fitbeku ndikon më shumë në motivimin e nxënësve, 6.9% ose 13 mësues mendojnë se edhe nota edhe fitbeku ndikojnë në motivimin e nxënësve, ndërsa 3.2% ose 6 mësues mendojnë se as nota dhe as fitbeku nuk ndikojnë në motivimin e nxënësve. Në mënyrë vizuale të njëjtat rezultate janë paraqitur në grafikun më poshtë.




Tabela e mësipërme paraqet korrelacionin në mes klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe opinionit të nxënësve për ndikimin e përdorimit të vlerësimit nga shokët e klasës në motivimin e nxënësve. Koeficienti i korrelacionit në tabelën më sipër është 0.035.

Koeficienti i korrelacionit paraqet drejtimin e lidhjes që në rastin tonë është pozitiv sepse koeficienti është pozitiv, dmth më rritjen e njërit variabël kemi edhe rritjen e variabël tjetër. Pra, me rritjen e variabël t të parë, klasës në të cilën ndodhen nxënësit rritet edhe variabël i dytë, mendimi pozitiv i nxënësve për ndikimin e përdorimit të vlerësimit nga shokët e klasës në motivimin e nxënësve. Koeficienti i korrelacionit paraqet gjithashtu edhe forcën e lidhjes që në rastin tonë është korrelacion shumë i dobët, jo i dukshëm pothuajse nuk ekziston. Pra, në mes dy variablëve, klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe opinionit të nxënësve për ndikimin e përdorimit të vlerësimit nga shokët e klasës në motivimin e nxënësve ka një korrelacion shumë të dobët pozitiv. Poashtu tabela e mësipërme paraqet edhe p-vlerën e cila në rastin tonë është $p=0.325$ dmth nuk ka korrelacion statistikisht domethënës në mes klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe opinionit të nxënësve për ndikimin e përdorimit të vlerësimit nga shokët e klasës në motivimin e nxënësve.

3.2.2.7. Diskutim i rezultateve nga testimi i korrelacionit midis gjinisë së nxënësve dhe opinionit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësorin e nxënësve

Për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore për korrelacionin midis gjinisë së nxënësve dhe opinionit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësorin e nxënësve u përdorën tabelat e kombinuara, regresioni dhe Mann & Whitney U test, dhe në bazë të të dhënave të analizuara në këtë mënyrë shihet se nuk ka ndonjë dallim të madhë midis mendimit të djemve dhe vajzave për çështjet e trajtuara në pyetësorin për nxënës, dmth nuk ekziston diferencë

statistikisht domethënëse në mesataret e mendimit të djemve dhe vajzave për të gjitha çështjet e trajtuara në pyetjet e pyetësorit.

3.2.2.8. Diskutim i rezultateve nga testimi i korrelacionit midis klasës dhe opinionit të nxënësve për çështjet e trajtuara në pyetësorin për nxënësit

Për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore për korrelacionin midis klasës së nxënësve dhe opinionit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësorin e nxënësve u përdorën tabelat e kombinuara dhe korrelacioni Kandell's tau, në bazë të të dhënave të paraqitura përmes tyre vërehet se në përgjithësi nuk ka korrelacion statistikisht domethënës midis klasës dhe opinionit të nxënësve për çështjet e trajtuara në pyetjet e pyetësorit.

3.2.3. Analiza e pyetësorit për prindërit

Prindërit kanë marr pjesë në këtë studim nëpërmjet plotësimit të pyetjeve të pyetësorit për prindërit. Pyetësi për prindërit ka nëntë pyetje me mundësi të shumëfishta.

3.2.3.1. Shpërndarja e vlerave të frekuencave për kampionin prindër që plotësuan pyetësorin

Rrezultatet e përgjigjeve të prindërve janë paraqitur në tabelat dhe grafiket më poshtë.

Tabela 93. Statistika përshkuese për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e parë të pyetësorit për prindërit.

1. Ndikimi i vlerësimit në motivimin e nxënësve

	<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid Ndikim shumë negativ	44	7.9	7.9	7.9
Ndikim negativ	79	14.1	14.1	22.0
As pozitiv as negativ	294	52.5	52.5	74.5
Ndikim pozitiv	119	21.3	21.3	95.7
Ndikim shumë pozitiv	24	4.3	4.3	100.0
Total	560	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet rezultatet e pyetjes së parë të pyetësorit për prindërit. Në total në këtë pyetje janë përgjigjur 560 prindër. 7.9% ose 44 prindër mendojnë se vlerësimi ndikon shumë negativisht në motivimin e nxënësve. Poashtu 14.1% ose 79 nxënës mendojnë se vlerësimi ndikon negativisht në motivimin e nxënësve. Ndërsa 52.5 % ose 294 prindër mendojnë se vlerësimi nuk ndikon as negativisht as pozitivisht në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër 21.3% ose 119 prindër mendojnë se vlerësimi ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve. Për më tepër 4.3% ose 24 prindër mendojnë se vlerësimi ndikon shumë pozitivisht në motivimin e nxënësve. Këto rezultate janë paraqitur vizualisht në grafikun më poshtë.



Figura 28. Grafiku për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e parë të pyetësorit për prindërit.

Tabela 94. Statistika përshkuese për ndikimin e fitbek-ut në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e dytë të pyetësorit për prindërit

2. Ndikimi i fitbek-ut në motivimin e nxënësve

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Ndikim shumë negativ	29	5.2	5.2	5.2
Ndikim negativ	89	15.9	15.9	21.1

As pozitiv as negativ	299	53.4	53.4	74.5
Ndikim pozitiv	119	21.3	21.3	95.7
Ndikim shumë pozitiv	24	4.3	4.3	100.0
Total	560	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet të dhënat e marra nga përgjigjet e prindërve në pyetjen e dytë të pyetësorit të prindërve. Në këtë pyetje në total janë përgjigjur 560 prindër. Prej tyre 5.2% ose 29 prindër mendojnë se fitbeku ndikon shumë negativisht në motivimin e nxënësve. 15.9 % ose 89 prindër mendojnë se fitbek-u ndikon negativisht. Ndërsa 53.4% ose 299 prindër mendojnë se fitbeku nuk ka ndikim as pozitiv as negative në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër, 21.3% ose 119 prindër mendojnë se fitbeku ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve dhe 4.3% ose 24 prindër mendojnë se fitbeku ka ndikim shumë pozitiv në motivimin e nxënësve. Këto të dhëna janë paraqitur vizualisht në grafikun më poshtë.




Figura 29. Grafiku për ndikimin e fitbek-ut në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e dytë të pyetësorit për prindërit

Tabela 95. Statistika përshkuese për pyetjen e tretë të pyetësorit të prindërve, në bazë të opinionit të prindërve - çfarë mund të jetë motivuese për nxënësit

3 Dallimi midis ndikimit të notës dhe fitbek-ut në motivimin e nxënësve

		Valid	Cumulative
	Frequency	Percent	Percent

Valid	Nota	163	29.1	29.1	29.1
	Fitbeku	86	15.4	15.4	44.5
	te dyja bashkë	108	19.3	19.3	63.7
	asnjëra nga të dyja	203	36.3	36.3	100.0
	Total	560	100.0	100.0	

Në tabelën më sipër janë paraqitur të dhënat e përgjigjeve të prindërve në pyetjen e tretë të pyetësorit për prindërit. Në total në këtë pyetësor janë përgjigjur 560 prindër. Prej tyre 29.1% ose 163 mendojnë se nota në krahasim me fitbek-un është më motivuese për nxënësit. Nga ana tjetër 15.4% ose 86 prindër mendojnë se fitbeku është më motivues për nxënësit. Ndërsa 19.3% ose 108 prindër mendojnë se të dyja edhe nota edhe fitbeku janë motivuese për nxënësit. Nga ana tjetër, grupi më i madhë i prindërve që janë përgjigjur në pyetjet e pyetësorit mednojnë se as nota dhe as fitbeku nuk janë motivuese. Këto të dhëna janë paraqitur vizuaisht në grafikun më poshtë.




Figura 30. Grafiku për pyetjen e tretë të pyetësorit të prindërve, në bazë të opinionit të prindërve - çfarë mund të jetë motivuese për nxënësit

Tabela 96. Statistika përshkruese për pyetjen e katërt të pyetësorit të prindërve, në bazë të opinionit të prindërve- cili lloj fitbeku është më motivues për nxënësit

4 Dallimi midis ndikimit të fitbek-ut gojor dhe me shkrim në motivimin e nxënësve

	<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid fitbeku me gojë	41	7.3	7.3	7.3
fitbeku me shkrim	102	18.2	18.2	25.5
Asnjëri	238	42.5	42.5	68.0
të dy	179	32.0	32.0	100.0
Total	560	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet rezultatet e përgjigjeve të prindërve në pyetjen e katërt të

pyetësorit të prindërve. 560 prindër u përgjigjën në total në këtë pyetësor. Prej tyre 7.3%

ose 41 prindër mendojnë se fitbeku me gojë është më i motivues në krahasim me fitbek-

un me shkrim. Nga ana tjetër, 18.2% ose 102 prindër mendojnë se fitbeku me shkrim është

më i motivues për nxënësit. Por, grupi më i madh i prindërve që janë përgjigjur në

pyetësorin e prindërve mendojnë se asnjëri nga të dy, as fitbeku me gojë dhe as fitbeku me

shkrim nuk janë motivues për nxënësit. Ndërsa, 32.0% ose 179 prindër mendojnë se edhe

fitbeku me shkrim edhe fitbeku me gojë ndikojnë pozitivisht në motivimin e nxënësve.

Këto të dhëna vizualisht janë paraqitur në grafikun më poshtë.



Figura 31. Grafiku për pyetjen e katërt të pyetësorit të prindërve, në bazë të opinionit të prindërve - cili lloj fitbeku është më i motivues për nxënësit

Tabela 97. Statistika përshkruese për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve informimi i tyre me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e pestë të pyetësorit për prindërit.

<i>5 Ndikimi i njohjes së kriterëve të vlerësimit në motivimin e nxënësve</i>					
		<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid	Ndikim shumë negativ	36	6.4	6.4	6.4
	Ndikim negativ	71	12.7	12.7	19.1
	As pozitiv as negativ	331	59.1	59.1	78.2
	Ndikim pozitiv	107	19.1	19.1	97.3
	Ndikim shumë pozitiv	15	2.7	2.7	100.0
	Total	560	100.0	100.0	

Tabela e mësipërme paraqet rezultatet e përgjigjeve të prindërve në pyetjen e pestë të pyetësorit për prindërit. Në këtë pyetje në total u përgjigjën 560 prindër. 6.4% ose 36 prindër mendojnë se informimi i nxënësve me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen ndikonë shumë negativisht në motivimin e tyre. Poashtu 12.7% ose 71 prindër mendojnë se informimi i nxënësve me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen ndikon negativisht në motivimin e nxënësve. Për numrin më të madhë të prindërve që u përgjigjën në këtë pyetje 59.1% ose 331 prindër, informimi i nxënësve me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen nuk ndikon as negativisht as pozitivisht në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër, 19.1% ose 107 prindër mendojnë se informimi i nxënësve me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve. Për më tepër, 2.7% ose 15 prindër mendojnë se informimi i nxënësve me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen ka ndikim shumë pozitiv në motivimin e nxënësve. Këto të dhëna janë paraqitur vizualisht në grafikun më poshtë.




Figura 32. Grafiku për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve informimi i tyre me kriteret e vlerësimit përpara se ato të vlerësohen, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e pestë të pyetësorit për prindërit.

Tabela 98. Statistika përshkuese për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve pjesëmarrja e tyre në përcaktimin e kritereve të vlerësimit, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e gjashtë të pyetësorit për prindërit

6 Ndikimi i pjesëmarrjes së nxënësve në përcaktimin e kritereve të vlerësimit në motivimin e nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim shumë negativ	39	7.0	7.0	7.0
	Ndikim negativ	72	12.9	12.9	19.8
	As pozitiv as negativ	310	55.4	55.4	75.2
	Ndikim pozitiv	115	20.5	20.5	95.7
	Ndikim shumë pozitiv	24	4.3	4.3	100.0
	Total	560	100.0	100.0	

Në tabelën më sipër janë paraqitur rezultatet e përgjigjeve të prindërve në pyetjen e gjashtë të pyetësorit për prindërit. Në këtë pyetje janë përgjigjur në total 560 prindër. Prej tyre 7.0% ose 39 prindër mendojnë se pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kritereve të vlerësimit ndikonë shumë negativisht në motivimin e nxënësve. 12.9% ose 72 prindër

poashtu mendojnë se pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit ndikon negativisht. Ndërsa grupi më i madhë i prindërve që u përgjigjën në këtë pyetje, 55.4% ose 310 prindër mendojnë se pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit nuk ndikon as pozitivisht as negativisht në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër 20.5% ose 115 prindër mendojnë se pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit ndikon pozitivisht. Për më tepër, 4.3% ose 24 prindër mendojnë se pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit ndikon shumë pozitivisht. Grafiku më poshtë paraqet këto të dhëna vizualisht.



Figura 33. Grafiku për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve pjesëmarrja e tyre në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e gjashtë të pyetësorit për prindërit.

Tabela 99. Statistika përshkuese për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve përdorimi i vetëvlerësimit, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e shtatë të pyetësorit për prindërit.

7 Ndikimi i vetëvlerësimit në motivim

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim shumë negativ	39	7.0	7.0	7.0
	Ndikim negativ	73	13.0	13.0	20.0
	As pozitiv as negativ	294	52.5	52.5	72.5

Ndikim pozitiv	135	24.1	24.1	96.6
Ndikim shumë pozitiv	19	3.4	3.4	100.0
Total	560	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet rezultatet e përgjigjeve të pyetjes së shtatë të pyetësorit të prindërve. Në këtë pyetje në total janë përgjigjur 560 prindër. Prej tyre 7.0% ose 39 prindër mendojnë se përdorimi i vetëvlerësimit në klasë ndikon shumë negativisht në motivimin e nxënësve. Poashtu 13.0% ose 73 prindër mendojnë se përdorimi i vetëvlerësimit në klasë ndikon negativisht në motivimin e nxënësve. Por, grupi më i madhë i prindërve që u përgjigjën në këtë pyetje, 52.5% ose 294 mendojnë se përdorimi i vetëvlerësimit në klasë nuk ndikon as negativisht as pozitivisht në motivimin e nxënësve. Nga ana tjetër, 24.1% ose 135 prindër mendojnë se përdorimi i vetëvlerësimit në klasë ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve. Për më tepër, 3.4% ose 19 prindër mendojnë se përdorimi i vetëvlerësimit në klasë ndikon shumë pozitivisht. Këto të dhëna janë të paraqitura vizualisht në grafikun më poshtë.




Figura 34. Grafiku për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve përdorimi i vetëvlerësimit, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e shtatë të pyetësorit për prindërit.

Tabela 100. Statistika përshkruese për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e tetë të pyetësorit për prindërit.

8.Ndikimi i vlerësimit të shokëve të klasës në motivimin e nxënësve

		<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid	Ndikim shumë negativ	47	8.4	8.4	8.4
	Ndikim negativ	73	13.0	13.0	21.4
	As pozitiv as negativ	284	50.7	50.7	72.1
	Ndikim pozitiv	139	24.8	24.8	97.0
	Ndikim shumë pozitiv	17	3.0	3.0	100.0
	Total	560	100.0	100.0	

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur rezultatet e përgjigjeve të prindërve në pyetjen e tetë të pyetësorit për prindërit. 560 prindër në total janë përgjigjur në këtë pyetje. 8.4% ose 47 prindër mendojnë se përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës ndikon shumë negativisht në motivimin e nxënësve. Poashtu, 13.0% ose 73 prindër mendojnë se përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës ndikon negativisht në motivimin e nxënësve. Për grupin më të madhë të prindërve që u përgjigjën në këtë pyetje 50.7% ose 284 prindër mendojnë se përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës nuk ka as ndikim pozitiv as ndikim negativ në motivimin e nxënësve. Ndersa, për 24.8% ose 139 prindër përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve. Për më tepër, 3.0% ose 17 nxënës mendojnë se përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës ka ndikim shumë pozitiv në motivimin e nxënësve. Grafiku më poshtë paraqet këto të dhëna vizualisht.




Figura 35. Grafiku për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve përdorimi i vlerësimit të shokëve të klasës, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e tetë të pyetësorit për prindërit.

Tabela 101. Statistika përshkruese për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve përdorimi i vlerësimit të nxënësve nga shokët e klasës së tyre, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e nëntë të pyetësorit për prindërit

9. Ndikimi i vlerësimit nga shokëve të klasës në motivimin e nxënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim shumë negativ	61	10.9	10.9	10.9
	Ndikim negativ	100	17.9	17.9	28.7
	As pozitiv as negativ	256	45.7	45.7	74.5
	Ndikim pozitiv	125	22.3	22.3	96.8
	Ndikim shumë pozitiv	18	3.2	3.2	100.0
	Total	560	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet rezultatet e përgjigjeve të pyetjes së nëntë të pyetësorit të

prindërve. Në këtë pyetje janë përgjigjur në total 560 prindër. Prej tyre, 10.9% ose 61

prindër mendojnë se përdorimi i vlerësimit të nxënësve jo nga mësuesja por nga shokët e

klasës ndikonë shumë negativisht në motivimin e nxënësve. Poashtu 17.9% ose 100 prindër

mendojnë se përdorimi i vlerësimit të nxënësve nga shokët e klasës së tyre ndikon

negativisht në motivimin e nxënësve. Grupi më i madhë i prindërve që u përgjigjën në këtë pyetje mendojnë se përdorimi i vlerësimit të nxënësve nga shokët e klasës së tyre nuk ndikon as pozitivisht as negativisht në motivimin e nxënësve. 22.3% ose 125 prindër mendojnë se përdorimi i vlerësimit të nxënësve nga shokët e klasës së tyre ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve. Poashtu 3.2% ose 18 prindër mendojnë se përdorimi i vlerësimit të nxënësve nga shokët e klasës së tyre ndikon shumë pozitivisht. Këto të dhëna janë paraqitur vizualisht në grafikun më poshtë.




Figura 36. Grafiku për ndikimin që mund të ketë në motivimin e nxënësve përdorimi i vlerësimit për nxënësit nga shokët e klasës së tyre, në bazë të përgjigjeve të prindërve në pyetjen e nënë të pyetësorit për prindërit

3.2.3.2. Diskutim për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve sipas mendimit të prindërve

Nga analizimi i të dhënave të pyetësorit të prindërve të paraqitura në tabelat më sipër vërehet se shumica e prindërve kanë zgjedhur të mos japin një opinion të prerë pozitiv ose negativ për çështjet e trajtuara në pyetësorin e prindërve rreth vlerësimit dhe ndikimit të tij në motivimin e nxënësve, por kanë qëndruar neutral në përgjigje duke zgjedhur mundësit e dhëna në përgjigjet si: nuk ka ndikim as negativ as pozitiv ose asnjëra prej mundësive të dhëna.

3.3. Analiza e vëzhgimeve në orët mësimore

3.3.1. Testim i hipotezës për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve për të nxënë, paraqitur përmes vëzhgimeve në orët mësimore

Vëzhgimi në orët mësimore është një nga metodat që u përdor për mbledhjen e të dhënave për këtë kërkim. Gjatë vëzhgimit në 21 orët mësimore u përdor çeklista me 5 pyetje për orën mësimore dhe 3 të tjera u plotësuan pas mbarimit të orëve mësimore. Çdo pyetje kishte mundësi për tu përgjigjur me po ose jo dhe në fund të çdonjërës nga pyetjet kishte vend të lënë për koment.

Nga 21 orët e vëzhguara në 17 prej tyre vlerësimi i nxënësve ishte pjesë e orës mësimore ndërsa në 4 prej tyre nxënësit nuk u vlerësuan. Në 17 orët mësimore vlerësimi u krye në mënyra të ndryshme, por kryesisht ishte vlerësim gojarisht dhe në 4 orët e tjera nxënësit nuk u vlerësuan pasi që ato orë ishin zhvillim i një njësie të re mësimore.

Në orët mësimore në të cilat u përdor vlerësimi, nxënësit u vlerësuan kryesisht gojarisht. Mësuesit/et u jepnin nxënësve komente si: shumë mirë, shkëlqyeshëm, këtu duhet të kesh kujdes, duhet dhe më shumë, më pëlqen mënyra si i lidh fjalit, ke bërë një përshkrim të bukur të pikturës, zgjedhje e saktë, etj.

Në 1 nga orët e vëzhguara mësuesi i dha nxënësve fitbek me shkrim për një ese të shkruar një orë më parë, dhe nxënësit duhej ta shkruajnë përsëri atë në bazë të komenteve me shkrim që u kishte dhënë mësuesi. Në 1 orë tjetër mësuesi i mbledhi punimet e nxënësve për ti vlerësuar dhe për ti dhënë atyre fitbek më shkrim. Në 2 nga orët e vëzhguara nxënësit i vlerësonin shokët e klasës në fletat për vlerësim të përgatitur nga mësuesja. Në pjesën e parë të 2 prej orëve të vëzhguara, mësuesi i dha nxënësve punimet e tyre bashë me fitbek të shkruar, u tha atyre ta lexojnë fitbek-un dhe nëse kanë diçka të paqartë në lidhje me

komentet, vërejtjet apo sugjerimet ta pyesin atë, dhe pastaj si detyrë shtëpie ta shkruajnë përsëri atë, në bazë të fibekut që kanë marrë me shkrim. Në pjesën e fundit të njërës nga orët mësimore, mësuesja kërkoi nga nxënësit të vlerësojnë vetëveten në bazë të fletave për vlerësim që i kishte pregatitur ai më parë. Gjithashtu mësuesit në formë të shkruar mbanin shënime për aktivitetin e nxënësve gjatë orës mësimore dhe për detyrat e shtëpisë.

Në tre nga orët e vëzhguara nxënësit ishin pjesëmarrës në vlerësim duke vlerësuar shokët e klasës dhe vetëveten me shkrim, ndërsa edhe gjatë orëve tjera nxënësit përfshiheshin në vlerësim duke u pyetur nga mësuesit se çfarë mendimi kishin për aktivitetin e shokëve të klasës në mësim, për punën dhe progresin e tyre në përgjithësi dhe për ndonjë përgjigje të dhënë në moment, gjithashtu mësuesi/ja pothuajse çdoherë pas përgjigjevetë të nxënësve i pyeste nxënësit e tjerë se a mendojnë se ajo është përgjigje e duhur dhe a kishin të shtojnë diçka për ta plotësuar përgjigjen.

Gjatë orëve të vëzhguara mësuesit/et nuk i vlerësuan nxënësit me nota, në shumicën e rasteve mbanin shënime në mënyrën e vet për detyrat e shtëpisë, nxënësit ishin të mësuar me kontrollimin e detyrave të shtëpisë, ishte formë rutinore, nxënësit kryesisht nuk reagonin në ndonjë mënyrë të dukshme për të shprehur ndonjë gëzim apo zemërim për vlerësimin e detyrave të shtëpisë, por kishte edhe raste të tjera edhe pse në numer më të vogël që nxënësit shprehnin emocione, shenja gëzimi por edhe zemërimi për vlerësimin e detyrave të shtëpisë. Vlerësim me notë nuk kishte gjatë orëve të vëzhgimit. Në shumicën e orëve nxënësit vlerësoheshin gojarishtë, nga komentet e dhëna gojarisht nga ana e mësuesit/es nxënësit reagonin në mënyra të ndryshme. Kur komenti nuk ishte ajo çka pritnin nxënësit të dëgjojnë ato e ulnin kokën dhe nuk e shikonin mësuesen në sy, ose e lëviznin kokën si për të thënë që është e qartë dhe ata e kuptojnë se çfarë dëshirojnë të thotë

mësuesi/ja, kur nxënësit pranonin një komet pozitiv atyre u shëndërrisnin sytë, buzëqeshnin dhe e shprehnin gëzimin që kishin në ato momente. Në rastet kur pas vlerësimeve pozitive mësuesi/ja u jepte edhe ndonjë sugjerim se ku duhej të përmirësoheshin, nxënësit dukej se nga gëzimi i vlerësimit pozitiv të thënë në fillim, ato thejshëm po lëviznin kokën për të pohuar se po e kuptojnë vërejtjen dhe do të përmirësohen në bazë të sugjerimeve të mësuesve, por më shumë jepnin përshtypje se nuk e kishin kuptuar se ku duhej të përmirësoheshin. Kur mësuesit i jepnin nxënësve shumë komente, vërejtje dhe sugjerimet për një detyrë në formë të fitbek-ut gojor, edhe nëse kuptoheshin në klasë nga nxënësit, dukej se nxënësit do ti harronin posa të dilnin prej klasë dhe sidomos nxënësit në moshë më të vogël, dhe ato që nuk janë shumë të interesuar për mësim.

Kryesisht nxënësit të cilët ishin nxënës të mirë në mësim, ndiheshin të gatshëm që të japin komente me gojë kur mësuesja i pyeste ato se çfarë mendimi kishin për përgjigjen e shokut të klasës dhe a kishin të shtojnë diçka për të njëjtën pyetje. Gjatë orës mësimore kur nxënësit e rishkruanin esenë e tyre në bazë të fitbek-ut me shkrim, edhe pse mund të kishte ndonjë nxënës që vetëm bënte sikur ishte i interesuar, shumica e nxënësve dukeshin të interesuar për të kuptuar komentet dhe sugjerimet e mësuesit/es. Vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë përgjithësisht nxënësit e pranonin në formën e një loje edukative, që përdoret në klasë për qëllime edukative, ndryshe nga orët e zakonshme mësimore, kishte edhe ndonji nxënës që nuk paraqiste interesim për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e shokëve të klasës, ose ndonjë nxënës që ishte paksa në siklet por shumica e nxënësve e shijonin shumë edhe vlerësimin për veten edhe për shokët e klasës. Në sytë e nxënësve edhe vetëvlerësimi edhe vlerësimi i shokëve të klasës dukeshin në formën e lojrave edukative, që përdoret në klasë për të arritur qëllimet e orës mësimore.

Të gjitha kurikulat, në një mënyrë apo një tjetër kishin vlerësimin e nxënësve si element të tyre. Në disa nga kurikualat i ishte dhënë më shumë vend vlerësimit të nxënësve duke përshkruar në mënyrë të detjauar mënyrën që do të aplikohet për vlerësimin e nxënësve ndërsa në disa të tjera i ishte kushtuar më pak vëmendje duke përshkruar më sipërfaqësisht mënyrën e vlerësimit.

Në 17 nga 21 planet ditore të mësuesve për orët e vëzhguara ishte i përmendur vlerësimi, në shumicën prej tyre, në pjesën për vlerësimin shkruhej vetëm se nxënësit vëzhgohen gjatë orës së mësimit dhe vlerësohen, nxënësit vlerësohen gojarisht, vlerësim me nota dhe bëhet kontrollimi i detyrave të shtëpisë. Ndërsa në disa plane ditore përmendeshin: vlerësimi i gjithë nxënësve, fitbeku gojor dhe me shkrim, vetëvlerësimi dhe vlerësim i ndërsjelltë.

Pas orës mësimore, mësuesit u pyetën se nëse ato e aplikojnë gjithmonë të njëjtën metodë për vlerësim, të gjithë mësuesit u përgjigjën se ato nuk e përdorin të njëjtën mënyrë për vlerësim por i vlerësojnë nxënësit sipas qëllimit që ka ora mësimore.

3.4. Analiza e studim rasti

Studim rasti është pjesë e temës së doktoraturës. Rezultatet e marra nga studim rasti që përfshiu 115 nxënës të shkollës fillore „Nuri Mazar” të cilët u vëzhguan katër muaj, gjatë orëve mësimore të gjuhës angleze, shërbejnë për të vërtetuar ose refuzuar hipotezën që vlerësimi formues ndikon në motivimin e nxënësve në klasë për të mësuar gjuhën angleze. Në fillim të dy variabëlat gjinia e nxënësve pjesëmarrës në studim rastin si dhe klasa në të cilën ndodhen këto nxënës janë analizuar në veçanti dhe pastaj ato janë paraqitur në tabela të kombinuara, ato janë të organizuara për klasat: gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë të ndara në bazë të gjinisë së nxënësve. Tabelat e kombinuara janë përdorur pasi janë paraqitur fillimisht tabelat e frekuencave. Tabelat e kombinuara paraqesin në një table të vetme të

dhënat për dy variabëlat, për këtë arsye ato konsiderohen si një mënyrë e mirë për të eksploruar korrelacionin midis variablëve.

Tabela 102. Statistika përshkruese për ndarja e nxënësve në grupe në bazë të gjinisë

Gjinia e pjesëmarrësve

	<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid vajzë	63	54.8	54.8	54.8
djalë	52	45.2	45.2	100.0
Total	115	100.0	100.0	

Nga tabela e mësipërme raportohet se në studim rastin kanë marr pjesë gjithsej 115 nxënës, prej tyre 54.8% ose 63 janë vajza ndërsa 45.2% ose 52 nga nxënësit pjesëmarrës në studim rastin janë djem. Përqindja e vajzave është më e madhe se përqindja e djemve.

Këto të dhëna vizualisht janë paraqitur në grafikun më poshtë.




Figura 37. Grafiku për ndarja e nxënësve në grupe në bazë të gjinisë

Grafiku i mësipërm paraqet në mënyrë vizuale pjesëmarrjen e nxënësve në studim rastin të ndarë sipas gjinisë.

Tabela 103. Statistika përshkruese për ndarjen e nxënësve në grupe në bazë të klasës në të cilën ndodhen nxënësit.

Klasa në të cilën ndodhen nxënësit

	<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid Klasa e	16	13.9	13.9	13.9
_____ gjashtë				

Klasa e shtatë	36	31.3	31.3	45.2
Klasa e tetë	30	26.1	26.1	71.3
Klasa e nentë	33	28.7	28.7	100.0
Total	115	100.0	100.0	

Nga tabela e mësipërme shohim se numri i përgjithshëm i nxënësve pjesëmarrës në studim rastin është 115 nxënës. Grupi më i vogël i nxënësve, të ndarë në grupe në bazë të klasës në të cilën ndodhen është grupi i nxënësve të klasës së gjashtë të cilët përbëjnë 13.9 % të nxënësve pjesëmarrës ose 16 nxënës. 31.3% ose 36 nxënës janë nxënës të klasës së shtatë. 26.1% ose 30 nxënës janë nxënës të klasës së tetë dhe 28.7% ose 33 nxënës janë nxënës të klasës së nentë. Këto të dhëna vizualisht janë paraqitur në grafikun më poshtë



Figura 38. Grafiku për ndarja e nxënësve në grupe në bazë të klasës në të cilën ndodhen nxënësit.

Grafiku i mësipërm paraqet pjesëmarrjen e nxënësve në studim rastin të ndarë sipas klasave në të cilat ndodhen nxënësit. Përqindja më e madhe e nxënësve pjesëmarrës në studim rastin është nga klasa e shtatë, ndërsa me përqindje më të vogël janë nxënësit e klasës së gjashtë.

Tabela 104. Tabelë e kombinuar për klasat në të cilat ndodhen nxënësit të ndara sipas gjinisë.

*Klasa në të cilën ndodhen nxënësit * Gjinia e pjesëmarrësve*
Crosstabulation

Count		Gjinia e pjesëmarrësve		
		Vajzë	Djalë	Total
Klasa në të cilën ndodhen nxënësit	Klasa e gjashtë	12	4	16
	Klasa e shtatë	17	19	36
	Klasa e tetë	13	17	30
	Klasa e nëntë	21	12	33
Total		63	52	115

Nga tabela e mësipërme shohim se në studim rastin kanë marr pjesë në total 115 nxënës. Të dhënat në këtë table janë ripërpunuar sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe gjinisë së tyre. Kjo table paraqet një tablo më të qartë të marrëdhënies midis këtyre dy variablëve. 16 nxënës janë nxënës të klasës së gjashtë dhe prej tyre 4 janë djem dhe 12 janë vajza. Nxënës të klasës së shtatë gjithsej janë 36 nxënës dhe prej tyre 19 janë djem dhe 17 janë vajza. Në klasën e tetë ka gjithsej 30 nxënës, prej tyre 17 janë djem dhe 13 janë vajza. Ndërsa në klasën e nëntë në total ka 33 nxënës dhe prej tyre 12 janë djem dhe 21 janë vajza. Në grafikun më poshtë këto të dhëna janë paraqitur vizualisht.




Figura 39. Grafiku për klasat në të cilat ndodhen nxënësit të ndara sipas gjinisë

Grafiku i mësipërm paraqet në mënyrë vizuale klasat në të cilat ndodhen nxënësit të ndarë në bazë të gjinisë së nxënësve. Përqindja e vajzave është më e vogël se e djemve në klasën e shtatë dhe në klasën e tetë ndërsa në klasën e gjashtë dhe në klasën e nëntë përqindja e vajzave është dukshëm më e madhe se përqindja e djemve në këto klasë.

Aplikimi i metodave mësimore mund të mos ndikojë njëllë në motivimin e të gjithë nxënësve, edhe aplikimi i vlerësimit formues u konsiderua se mund të mos ndikojë në mënyrë të njëjtë të të gjithë nxënësit. Për të parë se çfarë ndikimi mund të ketë aplikimi i vlerësimit formues të nxënësit me nivel të ndryshëm të motivimit, nxënësit që në fillim të studimit rastit, para aplikimit të vlerësimit formues, pra që në pjesën e parë të studimit rastit u ndanë në katër grupe, dhe atë në nxënës të demotivuar, nxënës pak të motivuar, nxënës të motivuar dhe nxënës shumë të motivuar. Të njëjtat kritere për nivelin e motivimit që u përdorën për ndarjen e nxënësve në grupe në pjesën e parë të studimit rastit u përdorën edhe për ndarjen e nxënësve nëpër grupe edhe në pjesën e dytë dhe të tretë të studimit rastit. Në këtë mënyrë, me analizimin e qëndrimeve të nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjeve të tyre në grupet e tjera shihet ndikimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve.

Për paraqitjen e grupeve të nxënësve në bazë të nivelit të motivimit të tyre, në secilën pjesë të studimit rastit, fillimisht janë përdor tabelat e frekuencave, pastaj janë përdor tabelat e kombinuara për nivelin e motivimit të nxënësve të ndarë në bazë të gjinisë së nxënësve pjesëmarrës në studim rastin, klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe gjithashtu suksesit të nxënësve.

Tabela 105. Statistika përshkruese për ndarja e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e parë të studim rasti.

Pjesa e parë e studim rasti- ndarja e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit

			Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nxënës të demotivuar	19	16.5	16.5	16.5	
	Nxënës pak të motivuar	55	47.8	47.8	64.3	
	Nxënës të motivuar	31	27.0	27.0	91.3	
	Nxënës shumë të motivuar	10	8.7	8.7	100.0	
	Total	115	100.0	100.0		

Tabela më sipër paraqet ndarjen e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e parë të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues. Në bazë të kriterëve të përcaktuara pjesa më e madhe e nxënësve pjesëmarrës në studim rastin bënë pjesë në grupin e nxënësve pak të motivuar ndërsa grupi me më pak nxënës ishte grupi i nxënësve shumë të motivuar. 16.5% ose 19 ishin nxënës të demotivuar, 47.8% ose 55 ishin nxënës pak të motivuar, 26.96% ose 31 nxënës ishin pjesë e grupit të nxënësve të motivuar dhe 8.70% ose 10 nxënës ishin pjesë e grupit të nxënësve shumë të motivuar. Këto të dhëna janë praqitur vizualisht në grafikun më poshtë.




Figura 40. Grafiku për ndarja e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e parë të studim rastit

Grafiku më sipër paraqet vizualisht se përqindja më e vogël e nxënësve në pjesën e parë të studim rastit janë të klasifikuar si nxënës shumë të motivuar, ndërsa grupi i nxënësve pak të motivuar është grupi më i madhë.

Tabela 106. Statistika përshkuese për ndarja e nxënësve nëpër grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e dytë të studim rastit.

Pjesa e dytë e studim rastit- ndarja e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit

				Valid	Cumulative
		Frequency	Percent	Percent	Percent
Valid	Nxënës të demotivuar	19	16.5	16.5	16.5
	Nxënës pak të motivuar	41	35.7	35.7	52.2
	Nxënës të motivuar	36	31.3	31.3	83.5
	Nxënës shumë të motivuar	19	16.5	16.5	100.0
	Total	115	100.0	100.0	

Në tabelën më sipër paraqitet ndarja e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre, në pjesën e dytë të studim rastit. Grupi i nxënësve i quajtur si grupi i nxënësve pak të motivuar edhe gjatë kësaj pjesë të studimit ishte grupi me më shumë nxënës. Ndërsa dy

grupet me më pak nxënës ishin grupi i nxënësve shume të motivuar dhe grupi i nxënësve të demotivuar. 16.5% ose 19 nxënës u klasifikuan në grupin e nxënësve të demotivuar, 35.6% ose 41 nxënës ishin pjesë e grupit të nxënësve pak të motivuar, të motivuar ishin 31.3% ose 36 nxënës dhe 16.5% ose 19 nxënës ishin në grupin e nxënësve shumë të motivuar. Këto rezultate janë paraqitur vizualisht në grafikun më poshtë.




Figura 41. Grafiku për ndarja e nxënësve nëpër grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e dytë të studim rastit

Grafiku më sipër paraqet në mënyrë vizuale ndarjen e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e dytë të studim rastit. Gjatë kësaj pjesë të studim rastit grupi më i madhë është grupi i nxënësve pak të motivuar, ndërsa në përqindje më të vogël në krahasim me grupet e tjera janë nxënësit e grupit të demotivuar dhe nxënësit e grupit shumë të motivuar. Të dy këto grupe gjatë kësaj pjese të studim rastit kanë numër të barabartë të nxënësve.

Tabela 107. Statistika përshkruese për ndarja e nxënësve nëpër grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e tretë të studim rastit.

Pjesa e tretë e studim rastit- ndarja e nxënësve në grupe në bazë të nivelit të motivimit

			<i>Frequency</i>	<i>Percent</i>	<i>Valid Percent</i>	<i>Cumulative Percent</i>
Valid	Nxënës	të	18	15.7	15.7	15.7
	demotivuar					
	Nxënës	pak të	22	19.1	19.1	34.8
	motivuar					
	Nxënës	të	41	35.7	35.7	70.4
	motivuar					
	Nxënës	shumë	34	29.6	29.6	100.0
	të motivuar					
	Total		115	100.0	100.0	

Tabela më sipër shfaq grupet e nxënësve të përcaktuar në bazë të nivelit të tyre të motivimit në pjesën e tretë të studim rastit, pas aplikimit të vlerësimit formues. Nga tabela shihet se grupi me numër më të madhë të nxënëve është grupi i nxënëve të motivuar dhe grupi me numër më të vogël të nxënësve është grupi i nxënëve të demotivuar. Në krahasim me dy pjesët e tjera të studim rastit vërehen ndryshime të numrit të nxënësve nëpër grupe. 15.7% ose 18 nxënës ishin pjesë e grupit të nxënëve të demotivuar, në grupin e nxënësve pak të motivuar ishin 19.1% ose 22 nxënës, 35.7% ose 41 nxënës prej tyre ishin pjesë e grupit të nxënësve të motivuar dhe 34 29.6% ose 34 nxënës pjesëmarës në studim rastin u klasifikuan në grupin e nxënësve shumë të motivuar. këto të dhëna vizualisht janë paraqitur në grafikun më poshtë.




Figura 42. Grafiku për ndarja e nxënësve nëpër grupe në bazë të nivelit të motivimit të tyre në pjesën e tretë të studim rastit

Nga grafiku i mësipërm shohim ndarjen e nxënësve në grupe në bazë të motivimit të tyre në pjesë e tretë të studim rastit. Nga paraqitja vizuale e të dhënave në këtë grafik vërejmë se grupi më i madhë është grupi i nxënësve të motivuar, dhe grupi me përqindje më të vogël është grupi i nxënësve të demotivuar.

3.4.1. Niveli i motivimit të nxënësve në të tre pjesët e studim rastit të ndarë në bazë të gjinisë së pjesëmarrësve në studim

Tabelat e kombinuara praqesin korrelacionin që ekziston midis të dy variablëve, nivelit të motivimit të nxënësve në të tre pjesët e studim rastit dhe gjinisë së pjesëmarrësve në studim rastin. Të dhënat e të dy variablëve, nivelit të motivimit të nxënësve në secilën pjesë të studim rastit dhe gjinisë së pjesëmarrësve në studim rastin janë ripërpunuar për të paraqitur një tablo më të qartë të nivelit të motivimit të nxënësve sipas gjinisë. Këto të dhëna janë paraqitur në të tre tabelat dhe tre grafiqet më poshtë.

Tabela 108. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë

Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit

** Gjinia e pjesëmarrësve Crosstabulation*

Count		<i>Gjinia e pjesëmarrësve</i>		
		<i>Vajzë</i>	<i>Djalë</i>	<i>Total</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	7	12	19
	Nxënës pak të motivuar	28	27	55
	Nxënës të motivuar	21	10	31
	Nxënës shumë të motivuar	7	3	10
Total		63	52	115

Tabela e mësipërme është tabelë e kombinuar që paraqet të dhëna për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit të ndarë në bazë të gjinisë së pjesëmarrësve në studim rastin. Numri i nxënësve pjesëmarrës në total është 115. 19 nxënës janë të klasifikuar në grupin e nxënësve të demotivuar dhe prej tyre 12 janë djem dhe 7 janë vajza. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka 55 nxënës në total dhe prej tyre 27 janë djem dhe 28 janë vajza. Grupi i nxënësve të motivuar përbëhet nga 31 nxënës dhe prej tyre 10 janë djem dhe 21 janë vajza. Ndërsa në grupi i nxënësve shumë të motivuar përbëhet nga 10 nxënës dhe prej tyre 3 janë djem dhe 7 janë vajza. Të njëjtat të dhëna janë paraqitur në përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 43. Grafiku për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë.

Grafiku i mësipërm paraqet nivelin e motivimit të nxënësve të ndarë sipas gjinisë. Nga grafiku më sipër shohim se vetëm në grupin e nxënësve të demotivuar përqindja e vajzave është më e vogël në krahasim me përqindjen e djemve. Në grupin e nxënësve pak të motivuar, përqindja e vajzave është më e madhe por dallimi në përqindje është i vogël. Ndërsa në dy grupet e tjera përqindja e vajzave është më e madhe në krahasim me përqindjen e djemve dhe dallimi midis të dy gjinive është më i madhë, në krahasim nga dallimi që është në grupin e nxënësve pak të motivuar.

Tabela 109. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë.

Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit

** Gjinia e pjesëmarrësve Crosstabulation*

Count		Gjinia e pjesëmarrësve		
		Vajzë	Djalë	Total
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë	Nxënës të demotivuar	7	12	19
	Nxënës pak të motivuar	21	20	41

të studim rastit	Nxënës të motivuar	22	14	36
	Nxënës shumë të motivuar	13	6	19
Total		63	52	115

Tabela më sipër është tabelë e kombinuar e cila parqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim rastin. 115 nxënës kanë marr pjesë në studim rastin. 19 prej tyre janë nxënës në grupin e nxënësve të demotivuar, 12 janë djem dhe 7 janë vajza. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka 41 nxënës dhe prej tyre 20 janë djem dhe 21 janë vajza. 36 nxënës bejnë pjesë në grupin e nxënësve të motivuar dhe prej tyre 14 janë djem dhe 22 janë vajza. Ndërsa në grupin e nxënësve shumë të motivuar ka 19 nxënës dhe prej tyre 6 janë djem dhe 13 janë vajza. Të njëjtat të dhëna janë paraqitur me përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 44. Grafiku për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë.

Grafiku më sipër paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim rastin. Të dhënat në grafik janë paraqit në përqindje. Përqindja e vajzave është më e vogël vetëm në grupin e nxënësve të demotivuar.

Në tre grupet e tjera përqindja e vajzave është më e madhe në krahasim me përqindjen e djemve edhe pse në grupin e nxënësve pak të motivuar dallimi midis dy gjinive nuk është shumë i madhë.

Tabela 110. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë.

Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit
** Gjinia e pjesëmarrësve Crosstabulation*

Count		Gjinia e pjesëmarrësve		
		Vajzë	Djalë	Total
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	7	11	18
	Nxënës pak të motivuar	11	11	22
	Nxënës të motivuar	20	21	41
	Nxënës shumë të motivuar	25	9	34
Total		63	52	115

Tabela më sipër është tabelë e kombinuar që paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë në grupe sipas gjinisë së pjesëmarrësve në studim rastin. Në total, 115 janë nxënës pjesëmarrës në studim rastin. 18 janë nxënës të cilët në pjesën e tretë të studim rastit u klasifikuan në grupin e nxënësve të demotivuar dhe prej tyre 11 janë djem dhe 7 janë vajza. Në grupin e nxënësve të pak të motivuar ka 22 nxënës dhe në bazë të gjinisë janë të ndarë në mënyrë të barabart, prej tyre 11 janë djem dhe 11 janë vajza. 41 janë nxënës të grupit të motivuar të nxënësve dhe prej tyre 21 janë djem dhe 20 janë vajza. Ndërsa në grupin e nxënësve shumë të motivuar ka 34 nxënës dhe prej tyre 9 janë djem dhe 25 janë vajza. Këto të dhëna janë paraqitur në përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 45. Grafiku për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit, të ndarë sipas gjinisë.

Grafiku më sipër paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë sipas gjinisë të pjesëmarrësve në studim rastin. Të dhënat në grafik janë të paraqitura në përqindje. Në grupin e nxënësve të demotivuar përqindja e vajzave është më e vogël se përqindja e djemve. Përqindja e vajzave dhe e djemve në grupin e nxënësve pak të motivuar është e barabart. Në grupin e nxënësve të motivuar përqindja e vajzave është më e vogël në krahasim me përqindjen e djemve, por dallimi në përqindje është i vogël. Ndërsa në grupin e nxënësve shumë të motivuar dallimi midis dy gjinive është i shumë i madhë, përqindja e vajzave është shumë më e madhe se përqindja e djemve të klasifikuar në këtë grup.

3.4.2. Niveli i motivimit të nxënësve në të tre pjesët e studim rastit të ndarë në bazë të klasës në të cilën ndodhen nxënësit.

Të dhënat e të dy variablëve, nivelit të motivimit të nxënësve në secilën pjesë të studim rastit dhe klasës në të cilën ndodhen nxënësit janë ripërpunuar për të paraqitur një tablo më të qartë të nivelit të motivimit të nxënësve sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Këto të dhëna janë paraqitur në të tre tabelat dhe tre grafiket më poshtë.

Tabela 111. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen.

*Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit * Klasa në të cilën ndodhen nxënësit Crosstabulation*

Count		Klasa në të cilën ndodhen nxënësit				
		klasa e gjashtë	klasa e shtatë	klasa e tetë	klasa e nëntë	Total
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	1	8	1	9	19
	Nxënës pak të motivuar	12	13	18	12	55
	Nxënës të motivuar	3	12	8	8	31
	Nxënës shumë të motivuar	0	3	3	4	10
Total		16	36	30	33	115

Tabela e mësipërme është tabelë e kombinuar që paraqetë nivelin e motivimit të nxënësve

në pjesën e parë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Në

grupin e nxënësve të demotivuar gjatë pjesës së parë të studim rastit në total janë

klasifikuar 19 nxënës dhe prej tyre 1 nxënës i klasës së gjashtë, 8 nxënës së klasës së shtatë,

1 nxënës i klasës së tetë dhe 9 nxënës të klasës së nëntë. Në grupin e nxënësve pak të

motivuar janë klasifikuar 55 nxënës dhe prej tyre 12 janë nxënës të klasës së gjashtë, 13

janë nxënës të klasës së shtatë, 18 janë nxënës të klasës së tetë, 12 janë nxënës të klasës së

nëntë. 31 nxënës janë pjesë e grupit të nxënësve të motivuar dhe prej tyre 3 janë nxënës të

klasës së gjashtë, 12 janë nxënës të klasës së shtatë, 8 nxënës janë nxënës të klasës tetë dhe

8 të tjerë janë nxënës të klasës së nëntë. Në grupin e nxënësve shumë të motivuar ka 10

nxënës në total dhe prej tyre asnjë nuk është nxënës i klasës së gjashtë, 3 janë nxënës të

klasës së shtatë, 3 janë nxënës të klasës së tetë dhe 4 janë nxënës të klasës së nëntë. Të njëjtat të dhëna janë paraqitur në përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 46. Grafiku për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit.

Grafiku më sipër paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Të dhënat në grafik janë paraqitur edhe në përqindje. Në grupin e nxënësve të demotivuar në përqindje më të vogël janë nxënësit e klasës së gjashtë dhe të shtatë, ndërsa në përqindje të madhe janë nxënësit e klasës së shtatë dhe në përqindje më të madhe janë nxënësit e klasës së nëntë. Në grupin e nxënësve pak të motivuar nuk dallon shumë përqindja e nxënësve nga klasa e gjashtë, shtatë dhe e nëntë ndërsa nxënësit e klasës së tetë janë në përqindje më të madhe. Në grupin e nxënësve të motivuar nxënësit e klasës së gjashtë janë me përqindje më të vogël, me përqindje të barabartë janë nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë dhe nxënësit e klasës së shtatë janë në përqindje më të madhe në këtë grup. Ndërsa asnjëpërqind i nxënësve të klasës së gjashtë nuk është pjesë e grupit të nxënësve të shumë të motivuar, me përqindje të barabartë janë

nxënësit e klasës së shtatë dhe klasës së tetë dhe me përqindje më të madhe janë nxënësit e klasës së nëntë.

Tabela 112. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit

*Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit * Klasa në të cilën ndodhen nxënësit Crosstabulation*

Count		Klasa në të cilën ndodhen nxënësit				Total
		Klasa e gjashtë	Klasa e shtatë	Klasa e tetë	Klasa e nëntë	
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	1	8	1	9	19
	Nxënës pak të motivuar	10	11	14	6	41
	Nxënës të motivuar	4	10	10	12	36
	Nxënës shumë të motivuar	1	7	5	6	19
Total		16	36	30	33	115

Tabela e mësipërme është tabelë e kombinuar e cila paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Në total 115 nxënës janë pjesëmarrës në pjesën e dytë të studim rastit. 19 janë nxënës të demotivuar dhe prej tyre 1 është nxënës i klasës së gjashtë, 8 janë nxënës të klasës së shtatë, 1 është nxënës i klasës së tetë dhe 9 janë nxënës të klasës së nëntë. 41 nxënës janë pjesë e grupit të nxënësve pak të motivuar dhe prej tyre 10 janë nxënës të klasës së gjashtë, 11 janë nxënës të klasës së shtatë, 14 janë nxënës të klasës së tetë dhe 6 janë nxënës të klasës së nëntë. Në grupin e nxënësve të motivuar në total ka 36 nxënës dhe prej tyre 4 janë nxënës të klasës së gjashtë, 10 janë nxënës të klasës së shtatë, 10 nxënës të tjerë janë nga klasa e tetë dhe 12 nga klasa e nëntë. 19 janë nxënës të grupit shumë të motivuar të nxënësve dhe prej tyre vetëm 1

nxënës është nga klasa e gjashtë, 7 janë nxënës të klasës së shtatë, 5 janë nxënës të klasës së tetë dhe 6 prej tyre janë nxënës të klasës së nëntë. Këto të dhëna janë paraqitur në përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 47. Grafik për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit

Nga grafiku më sipër vërejmë nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Të dhënat janë të paraqitura edhe me përqindje. Në grupin e nxënësve të demotivuar, përqindja më e vogël e nxënësve janë nga klasa e gjashtë dhe nga klasa e tetë, ndërsa përqindja më e madhe e nxënësve është nga klasa e nëntë. Nga ana tjetër, në grupin e nxënësve pak të motivuar përqindja më e ulët e nxënësve është nga klasa e nëntë dhe përqindja më e lartë është nga klasa e tetë. Në grupin e nxënësve të motivuar, përqindja më e ulët e nxënësve është nga klasa e gjashtë, përqindje e barabartë është për nxënësit e klasës së gjashtë dhe klasës së shtatë, ndërsa përqindja më e lartë nga nxënësit e klasës së nëntë. Në grupin e klasës së nëntë përqindja më e ulët është e

nxënësve të klasës së gjashtë ndërsa përqindje më të lartë në këtë grup kanë nxënësit e klasës së shtatë.

Tabela 113. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit.

*Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit * Klasa në të cilën ndodhen nxënësit Crosstabulation*

Count		Klasa në të cilën ndodhen nxënësit				Total
		Klasa e gjashtë	Klasa e shtatë	Klasa e tetë	Klasa e nëntë	
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	1	8	1	8	18
	Nxënës pak të motivuar	5	8	5	4	22
	Nxënës të motivuar	7	9	15	10	41
	Nxënës shumë të motivuar	3	11	9	11	34
Total		16	36	30	33	115

Tabela e mësipërme është tabelë e kombinuar që paraqet nivelin e motivimit të nxënësve

në pjesën e tretë të studim rastit sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Tabela paraqet se në total në pjesën e tretë të studim rastit ka patur 115 nxënës. 18 janë nxënës të grupit të nxënësve të demotivuar dhe prej tyre 1 është nxënës i klasës së gjashtë, 8 janë nxënës të klasës së shtatë, 1 është nxënës i klasës së tetë, 8 janë nxënës të klasës së nëntë. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka 22 nxënës dhe prej tyre 5 janë nxënës të klasës së gjashtë, 8 janë nxënës të klasës së shtatë, 5 janë nxënës të klasës së tetë dhe 4 janë nxënës të klasës së nëntë. 41 janë nxënës të grupit të motivuar të nxënësve dhe prej tyre 7 janë nxënës të klasës së gjashtë, 9 janë nxënës të klasës së shtatë, 15 janë nxënës të klasës tetë dhe 10 janë nxënës të klasës së nëntë. 34 janë nxënës të grupit shumë të motivuar të nxënësve dhe prej

tyre 3 janë nxënë të klasës së gjashtë, 11 janë nxënës të klasës së shtatë, 9 janë nxënës të klasës së tetë dhe 11 janë nxënës të klasës së nëntë. Këto të dhëna janë paraqitur në përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 48. Grafikun për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit

Grafiku më sipër paraqet vizualisht të dhënat e nivelit të motivimit të nxënësve sipas klasës në të cilën ndodhen nxënësit. Në grupin e nxënësve të demotivuar ka përqindje të barabartë të nxënësve të klasës së gjashtë dhe të klasës së tetë, kjo përqindje paraqet përqindjen më të ulët të pjesëmarrësve ndërsa përqindje më të madhe të nxënësve paraqesin nxënësit e klasës së shtatë dhe të klasës së nëntë, pjesëmarrja e të cilëve gjithashtu është e barabartë në këtë grup. Poashtu nxënësit nga klasa e shtatë janë në përqindje më të madhe edhe në grupin e nxënësve pak të motivuar, ndërsa në përqindje më të ulët janë nxënësit e klasës së nëntë. Në grupin e nxënësve të motivuar përqindje më të ulët paraqesin nxënësit e klasës së gjashtë ndërsa përqindje më të lartë paraqesin nxënësit e klasës së tetë. Në grupin e nxënësve shumë

të motivuar përqindje më të ulët poashtu paraqesin nxënësit e klasës së gjashtë ndërsa përqindje më të lartë kanë nxënësit e klasës së shtatë dhe nxënësit e klasës së nëntë.

3.4.3. Niveli i motivimit të nxënësve në të tre pjesët e studim rastit të ndarë në bazë të suksesit të nxënësve

Ripërpunimi i të dhënave të dy variablëve, nivelit të motivimit të nxënësve në secilën pjesë të studim rastit dhe suksesit të nxënësve është dhënë në tabela të kombinuara për të paraqitur një tablo më të qartë të korrelacionit midis këtyre dy variablëve. Këto të dhëna janë paraqitur në të tre tabelat dhe tre grafiqet më poshtë.

Tabela 114. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit të ndarë sipas suksesit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit.

*Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit * Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studim rastit Crosstabulation*

Count		Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studim rastit					
		Jo					
		<i>mjaftueshë</i>	<i>Mjaftueshë</i>		<i>Shumë</i>	<i>Shkëlqyesh</i>	<i>Total</i>
		<i>m</i>	<i>m</i>	<i>Mirë</i>	<i>mirë</i>	<i>ëm</i>	<i>l</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	19	0	0	0	0	19
	Nxënës pak të motivuar	20	25	9	1	0	55
	Nxënës të motivuar	1	3	8	16	3	31
	Nxënës shumë të motivuar	0	1	0	3	6	10
Total		40	29	17	20	9	115

Tabela më sipër është tabelë e kombinuar e cila paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit sipas suksesit të nxënësve në këtë pjesë. Në total 115 nxënës kanë qenë pjesëmarrës në pjesën e parë të studim rastit. 19 janë nxënës të grupit të nxënësve të demotivuar dhe të gjithë janë nxënës me sukses *jo mjaftueshëm* dhe asnjë prej

tyre nuk është nxënës me sukses tjetër. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka 55 nxënës dhe prej tyre 20 janë pjesë e grupit të nxënësve me sukses *jo mjaftueshëm*, 25 janë nxënës me sukses *mjaftueshëm* dhe 9 janë nxënës me sukses *mirë*, 1 është nxënës i grupit të nxënësve me sukses *shumë mirë* dhe asnjë nga nxënësit me sukses *shkëlqyeshëm* nuk është pjesë e grupit të nxënësve pak të motivuar. Në grupin e nxënësve të motivuar ka 31 nxënës dhe prej tyre vetëm 1 nxënës është nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 3 janë nxënës me sukses *mjaftueshëm*, 8 janë nxënës me sukses *mirë* dhe 16 janë nxënës me sukses *shumë mirë* dhe 3 janë nxënës me sukses *shkëlqyeshëm*. Në grupin e nxënësve shumë të motivuar në total ka 10 nxënës dhe prej tyre asnjë nuk është nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, vetëm një është nxënës me sukses *mjaftueshëm*, asnjë nuk është nga grupi i nxënësve me sukses *mirë*, 3 janë nxënës me sukses *shumë mirë* dhe 6 janë nxënës me sukses *shkëlqyeshëm*. Të njëjtat të dhëna janë paraqitur në përqindje në grafikun më poshtë.




Figura 49. Grafiku përshkruese për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studimit rastit të ndarë sipas suksesit të nxënësve në pjesën e parë të studimit rastit

Grafiku më sipër paraqet të dhëna vizuale për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit sipas suksesit të nxënësve në të njëjtën pjesë të studim rastit. Grupi i nxënësve të demotivuar ka vetëm nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, dhe asnjë përqind e këtij grupi nuk përbehet nga nxënës me sukses tjetër. Grup i nxënësve pak të motivuar përbehet nga një përqindje më e madhe e nxënësve me sukses të *mirë* dhe me përqindje shumë të vogël të nxënësve me sukses *shumë mirë* dhe asnjë përqind e nxënësve me sukses *shkëlqyeshëm*. Grupi i nxënësve të motivuar përbehet nga të gjithë grupet e nxënësve të ndarë në bazë të suksesit, dhe përqindja më e vogël është e nxënësve me sukses *jo mjaftueshëm* dhe përqindja më e madhe është e nxënësve me sukses *shumë mirë*. Grupi i nxënësve shumë të motivuar nuk ka asnjë përqind të nxënësve me sukses *jo mjaftueshëm* dhe *mirë*. Përqindja më e madhe e nxënësve të këtij grupi është me nxënës me sukses *shkëlqyeshëm*.

Tabela 115. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas suksesit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit

*Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit * Suksesi i nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit Crosstabulation*

Count		Suksesi i nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit					
		Jo					Total
		<i>mjaftueshe</i> <i>m</i>	<i>Mjaftueshe</i> <i>m</i>	<i>Mire</i>	<i>Shumë</i> <i>mirë</i>	<i>Shkëlqyesh</i> <i>ëm</i>	
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit	Nxënës të demotivuar	19	0	0	0	0	19
	Nxënës pak të motivuar	15	19	6	1	0	41
	Nxënës të motivuar	3	8	12	11	2	36

	Nxënës shumë të motivuar	0	3	1	9	6	19
Total		37	30	19	21	8	115

Tabela më sipër është tabelë e kombinuar e cila paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në

pjesën e dytë të studim rastit sipas suksesit të nxënësve gjatë kësaj pjese të studim rastit. Në total 115 nxënës kanë marrë pjesë në pjesën e dytë të studim rastit. 19 nxënës janë klasifikuar në grupin e nxënësve të demotivuar dhe të gjithë nxënësit e këtij grupi janë nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka 41 nxënës dhe prej tyre 15 janë nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 19 janë nxënës me sukses të *mjaftueshëm*, 6 janë nxënës me sukses të *mirë*, vetëm 1 është nxënës me sukses *shumë mirë* dhe asnjë nxënës në këtë grup nuk është nxënës me sukses të shkëlqyeshëm. 36 nxënës janë pjesë e grupit të nxënësve të motivuar, 3 prej tyre janë nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 8 janë nxënës me sukses të *mjaftueshëm*, 12 janë nxënës me sukses *mirë*, 11 nxënës janë me sukses *shumë mirë*, dhe vetëm 2 prej tyre janë nxënës me sukses të shkëlqyeshëm. 19 nxënës janë pjesë e grupit të nxënësve *shumë të motivuar* dhe prej tyre asnjë nuk është nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 3 janë nxënës me sukses *mjaftueshëm*, 1 nxënës është me sukses *mirë*, 9 nxënës janë me sukses *shumë mirë* dhe 6 janë nxënës me sukses *shkëlqyeshëm*. Këtë të dhëna në përqindje janë paraqitur në grafikun më poshtë.




Figura 50. Grafik për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit të ndarë sipas suksesit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit.

Grafiku më sipër paraqet në mënyrë vizuale nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit sipas suksesit të nxënësve po në pjesën e dytë të studim rastit. Grupi i nxënësve të demotivuar përbëhet plotësisht nga nxënësit me sukses *jo mjaftueshëm*. Grupi i nxënësve pak të motivuar ka një përqindje më të madhe të nxënësve me sukses *mjaftueshëm*, ndërsa përqindja më e vogël është e nxënësve me sukses *shumë të mirë*, për më tepër në këtë grup nuk ka asnjë përqind të nxënësve të shkëlqyeshëm. Grupi i nxënësve të motivuar ka nxënës nga gjithë grupet e nxënësve të ndarë në bazë të suksesit të tyre dhe prej tyre me përqindje më të madhe janë nxënësit me sukses *të mirë* dhe me përqindje më të vogël në këtë grup janë nxënësi me sukses *shkëlqyeshëm*. Në grupin e nxënësve shumë të motivuar përqindje më të vogël paraqesin nxënësit me sukses *mirë*, asnjë përqind e këtij grupi nuk janë nxënës me sukses *të jo mjaftueshëm* dhe përqindja më e madhe në këtë grup është e nxënësve shumë të motivuar.

Tabela 116. Tabelë e kombinuar për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë sipas suksesit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit.

*Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit * Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit Crosstabulation*

Count		Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit					
		Jo					
		<i>mjaftueshe</i>	<i>Mjaftueshe</i>		<i>Shumë</i>	<i>Shkëlqyesh</i>	<i>Tota</i>
		<i>m</i>	<i>m</i>	<i>Mirë</i>	<i>mirë</i>	<i>ëm</i>	<i>l</i>
Niveli i	Nxënës të	14	4	0	0	0	18
motivimit të	demotivuar						
nxënësve	Nxënës pak	4	11	5	1	1	22
gjatë pjesës	të motivuar						
së tretë të	Nxënës të	1	22	11	5	2	41
studim rastit	motivuar						
	Nxënës	0	4	1	11	18	34
	shumë të						
	motivuar						
Total		19	41	17	17	21	115

Tabela e mësipërme është tabelë e kombinuar që paraqet nivelin e motivimit të nxënësve në

pjesën e tretë të studim rastit sipas suksesit të nxënësve po në pjesën e tretë të studim rastit.

Nga tabela vërejmë se numri në total i pjesëmarrësve është 115. Në grupin e nxënësve të

demotivuar ka 18 nxënës dhe prej tyre 14 janë nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 4 janë

nxënës me sukses *mjaftueshëm* dhe asnjë nxënës në këtë grup nuk është me sukses *mirë*,

shumë mirë ose *shkëlqyeshëm*. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka në total 22 nxënës

dhe prej tyre 4 janë nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 11 nxënës me sukses *mjaftueshëm*, 5

nxënës me sukses *mirë*, 1 nxënës me sukses *shumë mirë* dhe 1 tjetër me sukses

shkëlqyeshëm. Grupi i nxënësve pak të motivuar përbëhet nga 41 nxënës dhe prej tyre

vetëm 1 është nxënës me sukses *jo mjaftueshëm*, 22 janë nxënës me sukses *mjaftueshëm*, 11

janë nxënës me sukses *mirë*, 5 janë nxënës me sukses *shumë mirë*, 2 janë nxënës me sukses

shkëlqyeshëm. Në grupin e nxënësve shumë të motivuar ka në total 34 nxënës dhe asnjë prej tyre nuk është me sukses *jo mjaftueshëm*, 4 janë nxënës me sukses *mjaftueshëm*, 1 është nxënës me sukses *mirë*, 11 janë nxënës me sukses *shumë mirë* dhe 18 janë nxënës me sukses *shkëlqyeshëm*. Të njëjtat të dhëna në përqindje janë paraqitur në grafikun më poshtë.




Figura 51. Grafik për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit të ndarë sipas suksesit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit.

Grafiku më sipër paraqet në mënyrë vizuale nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit sipas suksesit të nxënësve po në pjesën e tretë të studim rastit. Në grupin e nxënësve të demotivuar ka vetëm nxënës me sukses *jo mjaftueshëm* dhe nxënës me sukses *mjaftueshëm*, dhe prej tyre përqindja më e madhe është e nxënësve me sukses *jo mjaftueshëm*. Në grupin e nxënësve pak të motivuar ka përqindje më të vogël të nxënësve me sukses *shumë mirë* dhe *shkëlqyeshëm*, ndërsa përqindje më të madhe ka të nxënësve me sukses *mjaftueshëm*. Në grupin e nxënësve të motivuar ka një përqindje të vogël të nxënësve me sukses *mirë*, asnjë përqindje me sukses *jo mjaftueshëm* dhe përqindja më e

madhe është e nxënësve me sukses *mjaftueshëm*. Grupi i nxënësve shumë të motivuar nuk ka asnjë përqindje të nxënësve me sukses *jo mjaftueshëm*, një përqindje të vogël të nxënësve me sukses *mirë* dhe përqinja më e madhe e nxënësve janë nxënës me sukses *shkëlqyeshëm*.

3.4.4. Testimi i hipotezës

3.4.4.1. Testimi i hipotezës, vlerësimi formues ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve për të nxënë, përmes paraqitjeve të frekuencave për qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në një grup tjetër

Për të testuar hipotezën nëse *vlerësimi formues ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve për të nxënë gjuhën angleze*, u analizuan lëvizjet e nxënësve nëpër grupet në të cilat ishin klasifikuar në bazë të nivelit të tyre të motivimit. Pas aplikimit të vlerësimit formues nxënësit kishim mundësi të qëndrojnë në të njëjtin grup ose të lëvizin në një grup tjetër.

Tabela më poshtë paraqet në përgjithësi këto lëvizje të nxënësve.

Tabela 117. Statistika përshkruese për qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në grupet tjera pas aplikimit të vlerësimit formues.

Qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në një grup tjetër

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Qëndrim në të njëjtin grup	56	48.7	48.7	48.7
	lëvizje e nxënësve në një grup më lartë	59	51.3	51.3	100.0
Total		115	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet gjendjen e nxënësve nëpër grupe duke krahasuar pjesën e parë dhe të tretë të studimit rastit. Krahasimi i ndarjes në nxënësve nëpër grupe para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues paraqet si rezultat nxënës të cilët nuk kanë lëvizur por kanë qëndruar në

të njëjtin grup dhe lëvizje të nxënësve të tjetër, të cilët nuk kanë qëndruar në të njëjtin grup por kanë lëvizur në një grup më lartë. Të dhënat në table paraqesin qëndrim në të njëjtin grup, pothuajse të gjysmës së nxënësve pjesëmarrës në studim rastin dhe lëvizje në një grup më lart të pjesës tjetër të nxënësve. Aplikimi i vlerësimit formues ka ndikuar që 48.7% ose 56 nxënës të qëndrojnë në të njëjtin grup dhe 51.3% ose 59 të lëvizin në një grup më lartë. Këto rezultate në mënyrë vizuale paraqiten në grafikun më poshtë.




Figura 52. Grafiku për qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në grupet tjera pas aplikimit të vlerësimit formues.

Nga grafiku më sipër shohim se përqindja më e madhe e nxënësve, pas aplikimit të vlerësimit formues kanë lëvizur në një grup më lart.

3.4.4.2. Testimi i nënhipotezës, se vlerësimi formues ndikon në mënyrë të njëjtë te të gjithë nxënësit, përmes paraqitjeve të frekuencave për qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në një grup tjetër

Për të vërtetuar nënhipotezën nëse vlerësimi formues ndikon në të njëjtën mënyrë në

motivimin e të gjithë nxënësve u analizuan lëvizjet e nxënësve nëpër grupe ku ishin

klasifikuar në bazë të nivelit të tyre të motivimit, dhe për paraqitjen e këtyre të dhënave u

përdorën tabelat për shpërndarjen e frekuencave dhe paraqitjet grafik.

Tabela 118. Qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në grupet tjera pas aplikimit të vlerësimit formues të parqitura në mënyrë të detajuar.

Qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në një grup tjetër

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Qëndrim në të njëjtin grup-me mundësi për të lëvizur në grupet më lart dhe pamundësi për të zbritur më poshtë	18	15.7	15.7	15.7
	Qëndrim në të njëjtin grup-me mundësi për të lëvizur në grupet më lart ose më poshtë	28	24.3	24.3	40.0
	qëndrim në të njëjtin grup-me mundësi për të shkuar në grupet më poshtë dhe pamundësi për tu ngjitur më lart	10	8.7	8.7	48.7
	ndryshim grupi - lëvizje në një grup më lart	59	51.3	51.3	100.0
	Total	115	100.0	100.0	

Tabela më sipër paraqet rezultatet më të detajuara nga krahasimi i grupeve në pjesën parë, para aplikimit të vlerësimit formues dhe në pjesën e tretë të studim rastit, pas aplikimit të

vlerësimit formues. Pasi nxënësit ishin të ndarë në katër grupe dhe atë në nxënës të demotivuar, nxënës, pak të motivuar, nxënës të motivuar dhe nxënës shumë të motivuar, nxënësit që bënë pjesë në dy grupet, dhe atë në grupin e nxënësve pak të motivuar dhe në grupin e nxënësve të përcaktuar si nxënës të motivuar, pas aplikimit të vlerësimit formues, kishin tre mundësi: të qëndrojnë në të njëjtin grup, mundësi për lëvizje në grupet më poshtë por gjithashtu kishin mundësi që pas aplikimit të vlerësimit formues të klasifikoheshin edhe në grupet më lart. Ndërsa dy grupet tjera, pas aplikimit të vlerësimit formues, kishin vetëm nga dy mundësi. Nxënësit e grupit të demotivuar kishin mundësi të qëndrojnë në të njëjtin grup ose të ngjiteshin në grupet më lart, por nuk kishin mundësi që të zbrisnin më poshtë sepse nuk kishte grup tjetër nën grupin e nxënësve të demotivuar. Grupi i nxënësve shumë të motivuar, gjithashtu kishte vetëm dy mundësi, të qëndrojnë tek i njëjti grup ose të zbresin në grupet më poshtë, por nuk kishin mundësi për tu ngjitur më lart sepse nuk kishte grup tjetër sipër grupit të nxënësve shumë të motivuar. Nga tabela vihet re se aplikimi i vlerësimit formues ka ndikuar që 15.7 % ose 18 nxënës të qëndrojnë në të njëjtin grup, ato kanë patur mundësi për tu ngjitur në grupet më lartë por nuk kanë patur mundësi të zbresin më poshtë. Rezultatet tregojnë se 24.3 % ose 28 nxënës kanë qëndruar në të njëjtin grup edhe pse ato kishin mundësi për të lëvizur poshtë ose lart. 8.7 % ose 10 nxënës qëndruan në të njëjtin grup ato kishin mundësi për të zbritur në grupet më poshtë, por nuk kishin mundësi të ngjiten më lart. Vlerësimi formues pati ndikim pozitiv për 51.3 % ose 59 nxënës pjesëmarrës në studim rastin të cilët në pjesën e tretë të studim rasti, pra pas aplikimit të vlerësimit formues, ndodheshin të klasifikuar në një grup më lart në krahasim me pozitën e tyre në fillim të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues. Tabela më sipër nuk

paraqet asnjë të dhënë për ndikim negativ të vlerësimit formues, pasi që nuk ka asnjë nxënës që pas aplikimit të vlerësimit formues të ketë zbritur në grupet më poshtë.

Nga tabelat më sipër për përshkrimin e grupeve në të tre pjesët e studim rastit, vërehet se aplikimi i vlerësimit formues nuk ka patur pothuajse fare ndikim pozitiv për grupin e nxënësve të quajtur si grupi i nxënës të demotivuar, 19 nxënës ishin të klasifikuar në këtë grup që në pjesën e parë të studim rastit, edhe pas aplikimit të vlerësimit formues në këtë grup u klasifikuan 15.7 % ose 18 nxënës, pra vetëm për 1 nxënës nga 19 nxënës, vlerësimi formues ka ndikuar pozitivisht dhe ka bërë që ky nxënës të ndryshoj grupin dhe të klasifikohet në grupin e nxënësve pak të motivuar. Për 18 nxënësit e tjerë të grupit vlerësimi formues nuk ka patur ndikim pozitiv as ndikim negativ, ato kanë qëndruar në po të njëjtin grup. Për grupin e nxënësve të demotivuar qëndrimi në të njëjtin grup mund të ketë ndodhur për shkak të fakti se grupi i nxënësve të demotivuar është grupi i nivelit më të ulët të përcaktuar për këtë studim rasti. Ndoshta niveli i motivimit të këtyre 18 nxënësve do të kishin zbritur edhe më poshtë, por nuk kishte grup tjetër nën grupin e nxënësve të demotivuar të cilët ishin të përcaktuar si grupi i nivelit më të ulët.

Nga krahasimi i grupeve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues vërehet se aplikimi i vlerësimit formues pati një ndikim shumë pozitiv për nxënësit e klasifikuar fillimisht në grupin e nxënësve pak të motivuar. Para aplikimit të vlerësimit formues në këtë grup ishin përcaktuar 47.8% ose 55 nxënës kurse pas aplikimit të vlerësimit formues në këtë grup kishte vetëm 19.1 % ose 22 nxënës, dhe atë 21 janë nxënësit e grupit pak të motivuar dhe 1 është nxënësi i grupit të demotivuar që pas aplikimit të vlerësimit formues u klasifikua në grupin e nxënësve pak të motivuar. Më shumë se gjysma e tyre, 29.6 % ose 34 nxënës kanë ndryshuar grupin, janë klasifikuar në grupin e nxënësve të motivuar. Aplikimi i vlerësimit

formues mund të konsiderohet se nuk ka patur as efekt pozitiv por as edhe efekt negativ për 21 nxënësit e tjerë të grupit të cilët kanë qëndruar në të njëjtin grup dhe nuk janë ngjitur në grupin e nxënësve të motivuar por as nuk kanë zbritur në grupin e nxënësve të demotivuar. Vlerësimi formues nuk ka patur ndikim negativ për asnjë nxënës të cilët në pjesën e parë të studim rastit ishin të klasifikuar në grupin e nxënësve pak të motivuar sepse pas aplikimit të vlerësimit formues asnjë prej tyre nuk kishte zbritur në grupin më poshtë, në grupin e nxënësve të demotivuar.

Aplikimim i vlerësimit formues ka patur ndikim pozitiv edhe për grupin e nxënësve të motivuar. Nga 27.0% ose 31 që para aplikimit të vlerësimit formues u klasifikun në grupin e nxënësve të motivuar prej tyre 20.8 % ose 24 kanë kaluar në grupin e nxënësve shumë të motivuar. Vlerësimi formues nuk ka patur ndikim për asnjë nxënës të grupit të motivuar të nxënësve sepse asnjë prej tyre nuk ka zbritur në grupin e nxënësve pak të motivuar. Ndërsa për 7 nxënës nuk ka patur as ndikim pozitiv as negativ sepse ato kanë qëndruar në grupin e nxënësve të motivuar edhe para edhe pas aplikimit të vlerësimit formues.

Nga krahasimi i nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues shihet se në grupin e nxënësve shumë të motivuar fillimisht janë përcaktuar 8.7% ose 10 nxënës dhe asnjë nga këto nxënës nuk ka zbritur në grupet më poshtë dmth aplikimi i vlerësimit formues nuk ka ndikuar negativisht për asnjë nga këto nxënës që prej në pjesën e parë të studim rastit ishin pjesë e grupit të nxënësve shumë të motivuar. Për më tepër për këto 10 nxënës mund të thuhet që vlerësimi formues nuk ka ndikuar as negativisht as pozitivisht. Nxënësit nuk kishin mundësi për të lëvizur në grupet më sipër pasi që grupi i nxënësve shumë të motivuar ishte grupi më i lart, në të cilin ato ishin kualifikuar që në fillim të studim rastit, pra para aplikimit të vlerësimit formues.

Rezultatet e njëjta janë të paraqitura në mënyrë vizuale në grafikun më poshtë.




Figura 53. Grafiku për qëndrimet e nxënësve në të njëjtin grup dhe lëvizjet e tyre në grupet tjera pas aplikimit të vlerësimit formues të paraqitura në mënyrë të detajuar.

Nga të dhënat e paraqitura në mënyrë vizuale në grafikun më sipër shohim se përqindja më e madhe e nxënësve kanë lëvizur në një grup më lart. Ndërsa përqindja më e vogël e nxënësve janë pjesë e grupit të nxënësve të cilët kanë qëndruar në të njëjtin grup të cilët kanë patur mundësi për të shkuar në grupet më poshtë dhe nuk kanë patur mundësi për të shkuar në grupet më lartë.

3.4.5. Testimi i hipotezës

3.4.5.1 Testimi i ndikimit të vlerësimit formues në motivimin e nxënësve, përmes përdorimit të testit të Wilcoxon-it

Për të anlaizuar mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve në të tre pjesët e studim rastit dhe për krahasimin e nivelit të motivimit të nxënësve gjatë të tre pjesëve të studim rastit u përdor testi i Wilcoxon-it.

Tabela 119. Tabela e rënditjeve të nxënësve në bazë të testit të Wilcoxon, rënditjet e nxënësve në pjesën e parë dhe të dytë të studim rastit.

Ranks

		<i>N</i>	<i>Mean Rank</i>	<i>Sum of Ranks</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit	Negative Ranks	0 ^a	.00	.00
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit	Positive Ranks	23 ^b	12.00	276.00
	Ties	92 ^c		
	Total	115		

a. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit < Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit

b. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit > Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit

c. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit = Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit

Tabela më sipër paraqet krahasimin e të dhënave në shifra për nivelin e motivimit të

nxënësve në pjesë e parë dhe të dytë të studim rastit. Nga tabela vërehet numri total i

nxënësve pjesëmarrës në të dy pjesë e studim rastit që është 115 nxënës. Niveli i motivimit

të nxënësve në pjesën e dytë të studim rastit minus niveli i motivimit të nxënësve në pjesë e

parë të studim rastit paraqet rënditjet e nxënësve. 0 nga 115 nxënësit pjesëmarrës ka në

radhën negative dmth asnjë nga nxënësit nuk ka patur nivel më të ulët të motivimit në

pjesën e dytë në krahasim me nivelin e motivimit në pjesën e parë të studim rastit. 23

nxënës janë në radhën pozitive dmth 23 nxënës në pjesën e dytë të studim rastit kanë patur

nivel më të lartë të motivimit në krahasim me nivelin e tyre të motivit në pjesën e parë të

studim rastit. Ndërsa 92 nxënës paraqesin nivel të njëjtë të motivimit në të dy pjesët e

studim rastit.

Tabela 120. Të dhënat statistikore në bazë të testit Wilcoxon

<i>Test Statistics^a</i>	
	<i>Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit - Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit</i>
Z	-4.796 ^b
Asymp. Sig. (2-tailed)	.000

a. Wilcoxon Signed Ranks Test

b. Based on negative ranks.

Hipoteza zero e cila testohet është:

Ho: nuk ka ndryshim në vlerën mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë dhe të dytë të studim rastit

Hipoteza alternative paraqitet si rrjedhim i hipotezës zero.

Ha: ka ndryshim në vlerën mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë dhe të dytë të studim rastit.

Nga të dhënat statistikore në tabelën më sipër shohim që $Z = -4.79$, e bazuar në rradhët negative dhe p – vlerën, $p = 0$. Nëse $p < 0$, hipoteza zero refuzohet. Në rastin tonë $0 < 0.05$, pra hipoteza zero hidhet poshtë dhe themi se ka ndryshim midis vlerës mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e parë dhe të dytë të studim rastit.

Tabela 121. Tabela e rënditjeve të nxënësve në bazë të testit Wilcoxon, rënditjet e nxënësve në pjesën e dytë dhe të tretë të studim rastit.

<i>Ranks</i>		<i>N</i>	<i>Mean Rank</i>	<i>Sum of Ranks</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit	Negative Ranks	0 ^a	.00	.00
- Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit	Positive Ranks	36 ^b	18.50	666.00
	Ties	79 ^c		
	Total	115		

a. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit < Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit

b. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit > Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit

c. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit = Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit

Nga tabela e mësipërme vihet re krahasimi i të dhënave në shifra për nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e dytë dhe të tretë të studim rastit. Tabela paraqet numrin total të nxënësve pjesëmarrës në të dy pjesët e studim rastit që është 115 nxënës. Niveli i motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit minus niveli i motivimit të nxënësve në pjesë e dytë të studim rastit paraqet rënditjet e nxënësve. 0 nga 115 nxënësit pjesëmarrës ka në radhën negative dmth asnjë nga nxënësit nuk ka patur nivel më të ulët të motivimit në pjesën e tretë në krahasim me nivelin e motivimit në pjesën e dytë të studim rastit. 36 nxënës janë në rradhën pozitive dmth 36 nxënës në pjesën e tretë të studim rastit kanë patur nivel më të lartë të motivimit në krahasim me nivelin e tyre të motivit në pjesën e dytë të

studim rastit. Ndërsa 79 nxënës paraqesin nivel të njëjtë të motivimit edhe në pjesën e dytë edhe në pjesën e tretë të studim rastit.

Tabela 122. Të dhënat statistikore në bazë të testit Wilcoxon

<i>Test Statistics^a</i>	
	<i>Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit - Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë të studim rastit</i>
Z	-6.000 ^b
Asymp. Sig. (2-tailed)	.000

a. Wilcoxon Signed Ranks Test

b. Based on negative ranks.

Hipoteza zero e cila testohet është:

Ho: nuk ka ndryshim në vlerën mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë dhe të tretë të studim rastit

Hipoteza alternative paraqitet si rrjedhojë e hipotezës zero.

Ha: ka ndryshim në vlerën mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve gjatë pjesës së dytë dhe të tretë të studim rastit

Nga të dhënat statistikore në tabelën më sipër shohim që $Z = -6.00$, e bazuar në rradhët negative dhe p – vlerën, $p = 0$. Nëse $p < 0$, hipoteza zero refuzohet. Në rastin tonë $0 < 0.05$,

pra hipoteza zero hidhet poshtë, dhe themi se ka ndryshim midis të vlerës mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e parë dhe të dytë të studim rasti.

Tabela 123. Tabela e rënditjeve të nxënësve në bazë të testit Wilcoxon, rënditjet e nxënësve në pjesën e parë dhe të tretë të studim rasti

<i>Ranks</i>		<i>N</i>	<i>Mean Rank</i>	<i>Sum of Ranks</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti	Negative Ranks	0 ^a	.00	.00
- Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti	Positive Ranks	59 ^b	30.00	1770.00
	Ties	56 ^c		
	Total	115		

a. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti < Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti

b. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti > Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti

c. Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti = Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti

Tabela më sipër paraqet krahasimin e të dhënave në shifra për nivelin e motivimit të

nxënësve në pjesë e parë dhe të tretë të studim rasti. Nga tabela vërehet numri total i

nxënësve pjesëmarrës në të dy pjesë e studim rasti që është 115 nxënës. Niveli i motivimit

të nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti minus niveli i motivimit të nxënësve në

pjesën e parë të studim rasti paraqet rënditjet e nxënësve. 0 nga 115 nxënës pjesëmarrës

ka në radhën negative dmth asnjë nga nxënës nuk ka patur nivel më të ulët të motivimit

në pjesën e tretë në krahasim me nivelin e motivimit në pjesën e parë të studim rasti. 59

nxënës janë në radhën pozitive dmth 59 nxënës në pjesën e tretë të studim rasti kanë patur

nivel më të lart të motivimit në krahasim me nivelin e tyre të motivit në pjesën e parë të studim rastit. Ndërsa 56 nxënës paraqesin nivel të njëjtë të motivimit në të dy pjesët e studim rastit.

Tabela 124. Të dhënat statistikore në bazë të testit Wilcoxon

<i>Test Statistics^a</i>	
	<i>Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit - Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit</i>
Z	-7.681 ^b
Asymp. Sig. (2-tailed)	.000

a. Wilcoxon Signed Ranks Test

b. Based on negative ranks.

Hipoteza zero e cila testohet është:

Ho: nuk ka ndryshim në vlerën mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë dhe të tretë të studim rastit

Hipoteza alternative paraqitet si rrjedhojë e hipotezës zero.

Ha: ka ndryshim në vlerën mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë dhe të tretë të studim rastit

Nga të dhënat statistikore në tabelën më sipër shohim që $Z = -7.681$, e bazuar në rradhët negative dhe p – vlerën, $p = 0$. Nëse $p < 0$, hipoteza zero refuzohet. Në rastin tonë $0 < 0.05$,

pra hipoteza zero hidhet poshtë, dhe themi se ka ndryshim midis të vlerës mesatare të nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e parë dhe të tretë të studim rasti.

Tabela 125. Përmbledhje e testit të hipotezës për nivelin e motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë dhe të tretë të studim rasti

Hypothesis Test Summary				
	Null Hypothesis	Test	Sig.	Decision
1	The median of differences between Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues and Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues equals 0.	Related- Samples Wilcoxon Signed Rank Test	.000	Reject the null hypothesis.

Asymptotic significances are displayed. The significance level is .05.

Nga tabela e mësipërme vihet re se mediana e ndryshimit midis nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues dhe pjesës së tretë të studim rasti, pra pas aplikimit të vlerësimit formues është e barabartë me zero. Tabela gjithashtu paraqet edhe p- vlerën, $p = 0.00$, dhe vendimin që hipoteza zero refuzohet pasi që $0.00 < 0.05$. Për më tepër niveli i domethësnies statistikore është 0.05.

3.4.6. Testimi i hipotezës

3.4.6.1. Testimi i ndikimit të vlerësimit formues në motivimin e nxënësve, përmes përdorimit të *paired sample t-test*

Paired sample t test u përdor për të analizuar ndikimin e vlerësimit formues në nivelin e motivimit të nxënësve duke krahasuar nivelin e tyre të motivimit në pjesën e parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues dhe në pjesën e tretë të studimit, pas aplikimit të vlerësimit formues. Në këtë mënyrë u krahasuan mesataret e rezultateve të marra për nivelin e motivimit të nxënësve nga i njëjti grup i pjesëmarrësve në studim, në dy raste, para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues për të parë më qartë ndryshimin mes të dy rasteve.

Pyetja kerkimore:

A ka ndryshim të dallueshëm në nivelin e motivimit të nxënësve për të mësuar gjuhën e huaj, para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues?

Hipoteza zero e cila testohet është

Ho: mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues = mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues.

Dmth nuk ka ndryshim domethënës midis mesatares së nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues dhe mesatares të nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues.

Hipoteza alternative paraqitet si rrjedhojë e hipotezë zero.

Ha: mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues $\neq$ mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues.

Dmth ka ndryshim domethënës midis mesatares së nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues dhe mesatares së nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues

Variabli i pavarur është koha nga gjendja fillestare deri në gjendjen pas aplikimit të vlerësimit formues.

Variabli i varur është niveli i motivimit të nxënësve i matur në të dy rastet para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 126. Mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues.

<i>Paired Samples Statistics</i>				
		<i>Std.</i>	<i>Std.</i>	<i>Error</i>
<i>Mean</i>	<i>N</i>	<i>Deviation</i>	<i>Mean</i>	

Pair 1	Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues	5.6348	115	3.92994	.36647
	Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues	9.8000	115	4.67205	.43567

Nga tabela më sipër shohim se mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve në bazë të pikëve të grumbulluara në pjesën e parë të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues 5.63 dhe mesatarja e nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti 9.80 janë numra të ndryshëm.

Tabela 127. Korrelacioni midis nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues.

<i>Paired Samples Correlations</i>		
	<i>N</i>	<i>Correlation Sig.</i>

Pair 1	Niveli i 115	.869	.000
	motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues & Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues		

Nga table më sipër shohim se ka korelacion pozitiv 0.86 dmth nxënësi që ka patur rezultate të larta në pjesën e parë të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues, edhe pas aplikimit të vlerësimit formues paraqet përsëri rezultate të larta në motivim.

Tabela 128. Ndryshimi i mesatareve, devijimi standard dhe p vlera

<i>Paired Samples Test</i>								
<i>Paired Differences</i>								
				95% Interval Difference Lower	Confidence of the Upper	T	df	Sig. (2- tailed)
Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean						

Pair	Niveli	i -	2.31293	.21568	-4.59248	-3.73795	-	114	.000
1	motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues - Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues	4.16522						19.312	

Në tabelën më sipër paraqitet ndryshimi i mesatareve që është -4.165 devijimin standard

2.313

$t = -19.31$ me shkallë lirie $df = 114$

dhe p -vlera (sig 2 tailed) = 0

$0 < 0.05$ e kundërshtojmë hipotezën zero pasi në rastë se $p < 0.05$ hipoteza zero

kundërshtohet dhe në rastin tonë $p = 0$

Pra niveli i motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues kishte ndryshim të madhë.

3.4.7. Diskutim për rezultatet e testimit të hipotezës dhe nënhipotezës të studimit

Për testimin e hipotezës së studimit, vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e

nxënësve për të nxënë në gjuhën angleze, u përdorën tabelat e frekuencave, paraqitjet

grafike, testi Wilcoxon dhe paired sample t-test. Në bazë të të gjitha metodave për

analizimin e të dhënave u vërtetua hipoteza e studimit, se vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve për të nxënë në gjuhën angleze.

Ndërsa tabelat e frekuencave dhe paraqitja grafike e të dhënave për lëvizje e nxënësve nga një grup në grupin tjetër gjatë pjesëve të studim rasti u përdorën për të testuar nënhipotezën e studimit, nga analizimi i këtyre të dhënave refuzohet nënhipoteza, se vlerësimi formues ka të njëjtin ndikim në motivimin e të gjithë nxënësve. Vlerësimi formues ndikon në mënyra të ndryshe te nxënësit, për disa nxënës vlerësimi formues është shumë motivues ndërsa për disa të tjerë nuk ka kurfarë ndikimi në motivimin e tyre. Nga krahasimi i të dhënave para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues vërehet se për grupin e nxënësve të demotivuar vlerësimi formues nuk ka patur ndikim në motivimin e tyre, për nxënësit e dy grupeve tjera pak të motivuar dhe të motivuar, për disa nxënës nuk ka patur ndikim dhe për shumicën e tyre ka patur ndikim pozitiv, ndërsa për grupin e nxënësve shumë të motivuar vlerësimi formues ka patur ndikim pozitiv.

3.4.8. Testimi i pyetjes kërkimore # 5

3.4.8.1. Testimi i korrelacionit midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre, në bazë të përdorimit të koeficientit të korrelacionit të Pearson-it

Ekzistojnë disa faktor që mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve, një prej tyre mund të jetë edhe mosha e nxënësve. Për këtë arsye për të parë korrelacionin që mund të ekzistojë midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre u përdor koeficienti i korrelacionit të Pearson-it.

Pyetja kërkimore që ngrihet në këtë rast është:

Çfarë korrelacioni ekziston midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre në pjesën e parë të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues?

Hipoteza zero e cila testohet në këtë rast është

Ho: nuk ekziston korrelacion statistikisht domethënës midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Hipoteza alternative e cila paraqitet si rrjedhojë e hipotezës zero

Ha: ekziston korrelacion statistikisht domethënës midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 129. Korrelacioni midismoshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit pra para aplikimit të vlerësimit formues.

<i>Correlations</i>		<i>Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit, para aplikimit të vlerësimit formues</i>		<i>Mosha e nxënësve</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit, para aplikimit të vlerësimit formues	Pearson Correlation	1	.024	
	Sig. (2-tailed)		.795	
	N	115	115	
Mosha e nxënësve	Pearson Correlation	.024	1	
	Sig. (2-tailed)	.795		
	N	115	115	

Tabela më sipër parqet korrelacionin midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues. Koeficienti i korrelimit në tabelën më sipër është

0.024. Koeficienti i korrelacionit paraqet drejtimin e lidhjes që në rastin tonë është pozitiv sepse koeficienti është pozitiv dmth me rritjen e njërit variabël rritet edhe tjetri, dhe forcën e lidhjes që në rastin tonë është shumë e dobët pasi koeficienti korrelacionit është shumë afër 0 (zeros). Midis dy variablëve nuk ka asnjë lidhje statistikore, në rastet kur rezultati është 0 (zero), në rastin tonë lidhja midis dy variablëve konsiderohet si e dobët sepse koeficienti i korrelacionit në këtë rast është 0.024 dhe afërsia e rezultatit me vlerën 0 (zero) tregon forcën e lidhjes.

Pra korrelacioni midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre është korrelacion pozitiv dhe shumë i dobët.

Nga tabela më sipër për testimin e hipotezës shohim p-vlerën në këtë rast është $p=0.795$ i cili flet për mungesë të dukshme të domethënies statistikore.

Besueshmëria që mardhënia është statistikisht domethënëse zvoglohet me rritjen e vlerës së probabilitetit.

Nëse $p > 0.05$

Dhe në rastin tonë $p = 0.795$

Pra $0.795 > 0.05$

E kthyer kjo 0.795 në përqindje është 79.5% , dmth 79.5 % të rasteve lidhja midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve nuk ka lidhje statistikisht domethënëse sepse në 79.5% të rasteve mardhënia ndërmjet variablave konsiderohet si pasojë e shansit të rastit.

Hipoteza zero qëndron dhe nuk mund të pranojmë hipotezë alternative sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të thënë se ka korrelacion statistikisht domethënës në mes moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Këto të dhëna vizualisht janë paraqitur në grafikun më poshtë.




Figura 54. Grafiku i korrelacionit në mes moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues.

Nga grafiku më sipër shihet se në mes moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre në pjesën e parë të studim rastit ka një korrelacion të dobët pozitiv që prej poshtë majtas shkon lart djathtas.

Koeficienti i korrelacionit të Pearson-it u përdor për të analizuar korrelacionin midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve edhe në pjesën e tretë të studim rastit pra pas aplikimit të vlerësimit formues. Në këtë mënyrë shihet dallimin që ekziston në mes korrelacionit të moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues.

Pyetja kërkimore që shtrohet për të parë korrelacionin midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre pas aplikimit të vlerësimit formues është:

Çfarë korrelacioni ekzistonte në mes moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim tastit pas aplikimit të vlerësimit formues?

Hipoteza zero që testohet është

Ho: nuk ekziston lidhje statistikisht domethënëse midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Hipoteza alternative si rrjedhojë e hipotezës zero.

Ha: ekziston lidhje statistikisht domethënëse në mes moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Hipoteza alternative është 2 tailed hypothesis që shkon në dy kahje.

Tabela 130. Korrelacioni midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues.

<i>Correlations</i>			
		<i>Mosha e nxënësve</i>	<i>Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studimit, pas aplikimit të vlerësimit formues</i>
Mosha e nxënësve	Pearson Correlation	1	.008
	Sig. (2-tailed)		.933
	N	115	115
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studimit, pas aplikimit të vlerësimit formues	Pearson Correlation	.008	1
	Sig. (2-tailed)	.933	
	N	115	115

Tabela më sipër paraqet korrelacionin në mes moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre në pjesën e tretë të studimit pra pas aplikimit të vlerësimit formues. Koeficienti i korrelimit në tabelën më sipër është 0.008. Koeficienti i korrelacionit paraqet drejtimin e

lidhjes që në rastin tonë është pozitiv sepse koeficienti është pozitiv dhe forcën e lidhjes që në rastin tonë është shumë e dobët pasi koeficienti korrelacionit është shumë afër 0 (zeros). Midis dy variablëve nuk ka asnjë lidhje statistikore në rastet kur rezultati është 0 (zero), në rastin tonë lidhja midis dy variablëve konsiderohet si e shumë e dobët sepse koeficienti i korrelacionit në këtë rast është 0.008 dhe afërsia e rezultatit me vlerën 0 (zero) tregon forcën e lidhjes.

Pra korrelacioni midis dy variablëve, moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre është korrelacion pozitiv dhe shumë i dobët.

Nga tabela më sipër për testimin e hipotezës shohim p-vlerën, që në këtë rast është $p=0.933$ e cila flet për mungesë të dukshme të domethënies statistikore.

Besueshmëria që marrdhënia është statistikisht domethënëse zvoglohet me rritjen e vlerës së probabilitetit.

Nëse $p > 0.05$

Dhe në rastin tonë $p = 0.933$

Pra $0.933 > 0.05$

E kthyer kjo 0.933 në përqindje është 93.3% dmth 93.3 % të rasteve lidhja në mes moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve nuk ka lidhje statistikisht domethënëse sepse në 93.3% të rasteve marrëdhënia ndërmjet variablave konsiderohet si pasojë e shansit të rastit.

Hipoteza zero qëndron dhe nuk mund të pranojmë hipotezë alternative sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të thënë se ka korrelacion statistikisht domethënës në mes moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Grafiku më poshtë paraqet vizualisht të njëjtin rezultat.




Figura 55. Korrelacioni midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues

Grafiku më sipër paraqet një korrelacion shumë të dobët por korrelacioni është pozitiv sepse shohim se nga poshtë majtas shkon lart djathtas.

Krahasimi i analizës së korrelacionit të dy variablëve, moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve edhe para edhe pas aplikimit të vlerësimit formues është korrelacion pozitiv dhe shumë i dobët.

3.4.8.2. Testimi i korrelacionit midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues në bazë të përdorimit të regresionit

Analizimi i marrëdhënies midis dy variablëve, moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre u bë me anë të regresionit.

Ekuacioni për regresionin është $Y = a + b * X + e$, nëpërmjet këtij ekuacioni mund ta parashikojm nivelin e motivimit të nxënësve kur e dimë moshën e tyre.

Hipoteza zero e cila testohet në këtë rast është

H_0 : marrëdhënia midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues është zero.

Pra nuk ka një marrëdhënie të mbështetur statistikisht midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre.

Për hipotezën zero, b - koeficienti i regresionit / përhapja (slop) konsiderohet të jetë i barabart me zero, $b = 0$

Ndërsa për hipoteza alternative $b \neq 0$ rrjedhimisht hipoteza alternative thotë që ekziston një marrëdhënie e mbështetur statistikisht midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 131. Variabëli i varur i paraqitur përmes regresionit

<i>Variables Entered/Removed^a</i>			
Model	<i>Variables Entered</i>	<i>Variables Removed</i>	<i>Method</i>
1	Mosha e nxënësve ^b		. Enter

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues

b. All requested variables entered.

Tabela e parë nga regresioni na jep variabëlin e pavarur moshën e nxënësve që përdoret

për të parashikuar variabëlin e varur që në rastin tonë është niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 132. Koeficienti i korrelacionit R dhe R- katrori i paraqitur përmes regresionit

<i>Model Summary</i>				
Model	<i>R</i>	<i>R Square</i>	<i>Adjusted R Square</i>	<i>Std. Error of the Estimate</i>
1	.024 ^a	.001	-.008	3.94610

a. Predictors: (Constant), Mosha e nxënësve

Tabela më sipër paraqet koeficientin e korrelacioit R që është 0.02 dhe më me rëndësi na

paraqet gjithashtu edhe R- katrori është 0.001 e kthyer në përqindje është 0 % dmth për

asnjë përqind të nxënësve mosha nuk është domethënëse për nivelin e motivimit të tyre. Pra niveli i motivimit të nxënësve shpjegohet nga faktorë të tjerë.

Tabela 133. Testi Anova i paraqitur përmes regresionit

ANOVA^a

Model		<i>Sum of Squares</i>	<i>df</i>	<i>Mean Square</i>	<i>F</i>	<i>Sig.</i>
1	Regression	1.056	1	1.056	.068	.795 ^b
	Residual	1759.605	113	15.572		
	Total	1760.661	114			

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studimit rasti, para aplikimit të vlerësimit

formues

b. Predictors: (Constant), Moshë e nxënësve

Tabela më sipër paraqet P vlerën 0.795

Nëse $p > 0.05$ nuk mund ta refuzojmë hipotezën zero, dhe në rastin tonë $0.795 > 0.05$ dmth hipoteza zero qëndron, pra nuk ka marrëdhënie statistikisht domedhënëse midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 134. Të dhëna statistikore për koeficientin α

Coefficients^a

Model		<i>Unstandardized Coefficients</i>	<i>Standardized Coefficients</i>	<i>t</i>	<i>Sig.</i>
1	(Constant)	4.556		1.096	.275
	Moshë e nxënësve	.084	.024	.260	.795

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studimit rasti, para aplikimit të vlerësimit formues

Tabela më sipër paraqet ndërprerësin (B), për koeficientin e regresionit kjo na tregon se

kur moshë është 0 niveli i motivimit është 4.556 nuk është vlerë domethënëse në jetën reale por në regresion është fillimi i analizës kur moshë është 0.

0.084 na tregon se sa ndikon moshë te niveli i motivimit të nxënësve, dmth për çdo vit rritje në moshë ka 0.084 njësi rritjeje në nivelin e motivimit të nxënësve.

P vlera është 0.795

Pra vlera është e njëjtë me P vlerën e paraqitur në tabelën Anova 0.795

$0.795 > 0.05$ pra hipoteza zero qëndron dmth ka mungesë të dukshme të domethënies statistikore.

3.4.8.3. Testimi i korrelacionit midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre pas aplikimit të vlerësimit formues në bazë të përdorimit të regresionit

Analizimi i marrëdhënies midis dy variablëve, moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre u bë me anë të regresionit.

Ekuacioni për regresionin është $Y = a + b \cdot X + e$, nëpërmjet këtij ekuacioni mund ta parashikojm nivelin e motivimit të nxënësve kur e dimë moshën e tyre.

Hipoteza zero e cila testohet në këtë rast.

H_0 : marrëdhënia midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre është zero.

Pra nuk ka një marrëdhënie të mbështetur statistikisht midis moshës së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre

Për hipotezën zero, b - koeficienti i regresionit / përhapja (slop) konsiderohet të jetë i barabart me zero, $b = 0$

Ndërsa për hipoteza alternative $b \neq 0$ rrjedhimisht hipoteza alternative thotë që ekziston një marrëdhënie e mbështetur statistikisht midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 135. Variabëli i varur i paraqitur përmes regresionit

<i>Variables Entered/Removed^a</i>			
	<i>Variables Entered</i>	<i>Variables Removed</i>	<i>Method</i>
1	Mosha e nxënësve ^b	.	Enter

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues

b. All requested variables entered.

Tabela e parë nga regresioni na jep varilabëlin e pavarur moshën e nxënësve që përdoret për të parashikuar variabëlin e varur niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 136. Koeficienti i korrelacionit R dhe R- katrori i paraqitur përmes regresionit

<i>Model Summary</i>				
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.008 ^a	.000	-.009	4.69253

a. Predictors: (Constant), Moshë e nxënësve

Tabela më sipër paraqet koeficientin e korrelacionit R që është 0.008 dhe më me rëndësi na paraqet gjithashtu edhe R- katrori është 0.00 e kthyer në përqindje është 0 dmth për asnjë përqind të nxënësve moshë nuk është domethënëse për nivelin e motivimit të tyre. Pra niveli i motivimit të nxënësve shpjegohet nga faktorë të tjerë.

Tabela 137. Testi Anova i paraqitur përmes regresionit

<i>ANOVA^a</i>						
Model		Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	.156	1	.156	.007	.933 ^b
	Residual	2488.244	113	22.020		
	Total	2488.400	114			

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues

b. Predictors: (Constant), Moshë e nxënësve

Tabela më sipër paraqet P vlerën 0.933

Nëse $p > 0.05$ nuk mund ta refuzojmë hipotezën zero, dhe në rastin tonë $0.933 > 0.05$ dmth hipoteza zero qëndron, pra nuk ka marrëdhënie statistikisht domethënëse midis moshës dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 138. Të dhëna statistikore për koeficientin a

<i>Coefficients^a</i>					
		<i>Unstandardized Coefficients</i>		<i>Standardized Coefficients</i>	
Model		<i>B</i>	<i>Std. Error</i>	<i>Beta</i>	<i>T</i>
1	(Constant)	9.386	4.945		1.898
	Mosha e nxënësve	.032	.386	.008	.084
					.933

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studimit rastit, pas aplikimit të vlerësimit formues

Tabela më sipër paraqet ndërprerësin (B), ose a për koeficientin e regresionit kjo na tregon

se kur mosha është 0 niveli i motivimit është 9.38 nuk është vlerë domethënëse në jetën

reale por në regresion është fillimi i analizës kur mosha është 0.

0.032 na tregon se sa ndikon mosha te niveli i motivimit të nxënësve, dmth për çdo vit rritje

në moshë ka 0.032 njësi rritjeje në nivelin e motivimit të nxënësve.

P vlera është 0.933

Pra vlera është e njëjtë me P vlerën e paraqitur në tabelën Anova 0.933

0.933 > 0.05 pra hipoteza zero qëndron dmth ka mungesë të dukshme të domethënies

statistikore.

3.4.9. Testimi i pyetjes kërkimore # 6

3.4.9.1. Testimi i korrelacionit në mes suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre, në bazë të koeficientit të korrelacionit të Pearson-it

Përveç moshës së nxënësve e analizuar më sipër, suksesit të nxënësve mund të jetë

gjithashtu një faktor që mund të ndikojë në motivimin e nxënësve. Koeficienti i

korrelacionit të Pearson-it u përdor për të analizuar korrelacionin midis nivelit të motivimit

të nxënësve dhe suksesit të tyre.

Pyetja kërkimore e cila ngrihet në këtë rast është:

Çfarë lidhje ekziston në mes suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues?

Hipoteza zero e cila testohet është:

Ho: nuk ekziston lidhje statistikisht domethënëse në mes suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Hipoteza alternative që paraqitet si rrjedhojë e hipotezës zero.

Ha: ekziston lidhje statistikisht domethënëse në mes suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 139. Korrelacioni midis suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues.

<i>Correlations</i>		Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues	
		Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studim rasti,para aplikimit të vlerësimit formues	
Niveli i	Pearson	1	.800**
motivimit të	Correlation		
nxënësve gjatë	Sig. (2-tailed)		.000
pjesës së parë	N	115	115
të studim rasti,			
para aplikimit			
të vlerësimit			
formues			
Suksesi i	Pearson	.800**	1
nxënësve në	Correlation		
pjesën e parë të	Sig. (2-tailed)	.000	

studim	N	115	115
rastit,para			
aplikimit të			
vlerësimit			
formues			

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tabela më sipër paraqet korrelacionin në mes suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues. Koeficienti i korrelacionit në tabelën më sipër është 0.80. Koeficienti i korrelacionit paraqet drejtimin e lidhjes që në rastin tonë është pozitiv sepse koeficienti është pozitiv dmth me rritjen e njërit variabël, rritet edhe tjetri. Pra me rritjen e suksesit të nxënësve rritet edhe niveli i motivimit të tyre. Koeficienti i korrelacionit paraqet gjithashtu edhe forcën e lidhjes që në rastin tonë është e fortë pasi koeficienti korrelacionit është shumë afër +1. Midis dy variablëve ka një korrelacion të përkryes pozitiv në rastet kur rezultati është +1, në rastin tonë lidhja midis dy variablëve konsiderohet si e fortë sepse koeficienti i korrelacionit në këtë rast është 0.80 dhe afërsia e rezultatit me vlerën + 1 tregon forcën e lidhjes.

Pra korrelacioni midis sy variablëve, suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre është korrelacion pozitiv dhe i fortë.

Nga tabela më sipër për testimin e hipotezës shohim koeficientin e domethënies statistikore (Sig.) në këtë rast është 0.0 i cili flet për domethënie statistikore, për më tepër, mund të thuhet se korrelacioni është domethënës në nivelin 0.01

Besueshmëria që mardhënia është statistikisht domethënëse rritet me zvogëlimin e vlerës së probabilitetit.

Nëse $P < 0.05$ hipoteza zero nuk qëndron

Dhe në rastin tonë $p = 0.0$

$Pra\ 0.0 < 0.05$

E kthyer kjo 0.0 në përqindje është 0 % , dmth 0 % të rasteve marrëdhënia ndërmjet variablëve konsiderohet si pasoj e shansit të rastit.

Hipoteza zero nuk qëndron dhe mund të thuhet se ekziston korrelacion statistikiisht domethënës midis suksesit dhe motivimit të nxënësve.

Grafiku më poshtë paraqet vizualisht të njëjtin rezultat




Figura 56. Grafiku korrelacioni në mes suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre në pjesën e parë të studim rastit, pra para aplikimit të vlerësimit formues.

Grafiku më sipër paraqet një korrelacion të fortë pozitiv midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre.

Për të parë dallimin që ekziston midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues u përdor përsëri koeficienti i korrelacionit të Pearson-it për të analizuar korrelacionin midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre edhe në pjesën e tretë të studim rastit, pra pas aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 140. Korrelacioni në mes suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve pas aplikimit të vlerësimit formues

Correlations

		<i>Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit, pas aplikimit të vlerësimit formues</i>	<i>Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit,pas aplikimit të vlerësimit formues</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rastit, pas aplikimit të vlerësimit formues	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	1 115	.713** .000 115
Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rastit,pas aplikimit të vlerësimit formues	Pearson Correlation Sig. (2-tailed) N	.713** .000 115	1 115

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tabela më sipër paraqet korrelacionin në mes suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre pas aplikimit të vlerësimit formues. Koeficienti i korrelimit në tabelën më sipër është 0.713. Koeficienti i korrelacionit paraqet drejtimin e lidhjes që në rastin tonë është pozitiv sepse koeficienti është pozitiv dmth me rritjen e njërit variabël rritet edhe tjetri. Koeficienti i korrelacionit paraqet dhe forcën e lidhjes që në rastin tonë është e fortë pasi koeficienti korrelacionit është shumë afër +1. Midis dy variablëve ka një korrelacion të përkryer pozitiv në rastet kur rezultati është +1 , në rastin tonë lidhja midis dy variablëve

konsiderohet si e fortë sepse koeficienti i korrelacionit në këtë rast është 0.800 dhe afërsia e rezultatit me vlerën + 1 tregon forcën e lidhjes.

Pra korrelacioni midis dy variablëve, suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre është korrelacion pozitiv dhe i fortë.

Nga tabela më sipër për testimin e hipotezës shohim koeficientin e domethënies statistikore (Sig.) në këtë rast është 0.00 i cili flet për domethënie statistikore, për më tepër, mund të thuhet se korrelacioni është domethënës në nivelin 0.01

Besueshmëria që mardhënia është statistikisht domethënëse rritet me zvogëlimin e vlerës së probabilitetit.

Nëse $P < 0.05$ hipoteza zero refuzohet

Dhe në rastin tonë $p = 0.0$

Pra $0.0 < 0.05$

E kthyer kjo 0.0 në përqindje është 0 % , dmth 0 % të rasteve marrëdhënia ndërmjet variablave konsiderohet si pasoj e shansit të rastit.

Hipoteza zero nuk qëndron dhe mund të thuhet se ekziston korrelacion statistikisht domethënës në mes suksesit dhe motivimit të nxënësve.

Grafiku më poshtë paraqet vizualisht të njëjtin rezultat.




Figura 57. Grafiku i korrelacionit në mes suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre në pjesën e tretë të studim rasti, pra pas aplikimit të vlerësimit formues.

Grafiku më sipër paraqet një korrelacion të fortë pozitiv midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre.

Krahasimi i analizës së korrelacionit të dy variablëve, suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve edhe para edhe pas aplikimit të vlerësimit formues është korrelacion pozitiv dhe i fortë.

3.4.9.2. Testimi i korrelacionit midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues, në bazë të përdorimit të regresionit

Analizimi i marrëdhënies midis dy variablëve, suksesit të nxënësve dhe nivelin të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues u bë edhe me anë të regresionit.

Ekuacioni për regresionin është $Y = a + b * X + e$, nëpërmjet këtij ekuacioni mund ta parashikojm nivelin e motivimit të nxënësve kur e dimë suksesin e tyre.

Hipoteza zero e cila testohet në këtë rast është:

H_0 : marrëdhënia midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre para aplikimit të vlerësimit formues është zero

Pra nuk ka një mardhënie të mbështetur statistikisht midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre

Për hipotezën zero, b - koeficienti i regresionit / përhapja (slop) konsiderohet të jetë i barabart me zero, $b = 0$

Ndërsa për hipoteza alternative $b \neq 0$ rrjedhimisht hipoteza alternative thotë që ekziston një marrëdhënie e mbështetur statistikisht midis suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve para aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 141. Variabëli i varur i paraqitur përmes regresionit

<i>Variables Entered/Removed^a</i>			
Model	<i>Variables Entered</i>	<i>Variables Removed</i>	<i>Method</i>
1	Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studimit rastit ^b	.	Enter

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studimit rastit, para aplikimit të vlerësimit formues

b. All requested variables entered.

Tabela e parë nga regresioni na jep variabëlin e pavarur suksesin e nxënësve që përdoret për të parashikuar variabëlin e varur, niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studimit rastit, para aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 142 Koeficienti i korrelacionit R dhe R- katrori i paraqitur përmes regresionit

<i>Model Summary</i>				
Model	<i>R</i>	<i>R Square</i>	<i>Adjusted R Square</i>	<i>Std. Error of the Estimate</i>
1	.800 ^a	.640	.637	2.36870

a. Predictors: (Constant), Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studimit rastit

Tabela më sipër paraqet koeficientin e korrelacioit R që është 0.80 dhe më me rëndësi na paraqet gjithashtu edhe R- katrori është 0.64 e kthyer në përqindje është 64.0 %,pra për

64.0% të nxënësve suksesi është domethënës për nivelin e tyre të motivimit dhe 36.0 % e ndryshimit në nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e parë të studim rastit shpjegohet nga faktorët tjerë.

Tabela 143. Të dhënat e testit Anova

ANOVA ^a						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	1126.647	1	1126.647	200.802	.000 ^b
	Residual	634.014	113	5.611		
	Total	1760.661	114			

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit, para aplikimit të vlerësimit formues

b. Predictors: (Constant), Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studim rastit

Tabela më sipër paraqet P vlerën që është 0.00

Nëse $p < 0.05$ mund ta refuzojmë hipotezën zero, dhe në rastin tonë $0.00 < 0.05$ dmth hipoteza zero refuzohet, pra ekziston marrëdhënie statistikisht domedhënëse midis suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 144. Të dhëna statistikore për koeficientin α

Coefficients ^a					
		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	
Model		B	Std. Error	Beta	T Sig.
1	(Constant)	-.004	.455		-.008 .993
	Suksesi i nxënësve në pjesën e parë të studim rastit	2.367	.167	.800	14.170 .000

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rastit, para aplikimit të vlerësimit formues

Tabela më sipër paraqet ndërprerësin (B), për koeficientin e regresionit kjo na tregon se kur suksesi i nxënësve është 0, niveli i motivimit është -0.004 nuk është vlerë domethënëse në jetën reale por në regresion është fillimi i analizës kur suksesi i nxënësve është 0.

2.367 tregon se sa ndikon suksesi i nxënësve në nivelin e motivimit të tyre, dmth për çdo notë rritje në suksesin e nxënësve ka 2.367 njësi rritjeje në nivelin e motivimit të nxënësve.

P vlera është 0.00

Pra vlera është e njëjtë me P vlerën e paraqitur në tabelën Anova 0.00

$0.00 < 0.05$ pra hipoteza zero nuk qëndron.

3.4.9.3. Testimi i korrelacionit midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre pas aplikimit të vlerësimit formues, në bazë të përdorimit të regresionit

Analizimi i marrëdhënies midis dy variablëve, suksesit të nxënësve dhe nivelin të motivimit të tyre u bë edhe me anë të regresionit.

Ekuacioni për regresionin është $Y = a + b \cdot X + e$, nëpërmjet këtij ekuacioni mund ta parashikojmë nivelin e motivimit të nxënësve kur e dimë suksesin e tyre.

Hipoteza zero e cila testohet në këtë rast është:

H_0 : korrelacioni midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre është zero

Pra nuk ka një korrelacion të mbështetur statistikisht midis suksesit të nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre.

Për hipotezën zero, b - koeficienti i regresionit / përhapja (slop) konsiderohet të jetë i barabart me zero, $b = 0$

Ndërsa për hipoteza alternative $b \neq 0$ rrjedhimisht hipoteza alternative thotë që ekziston një korrelacion i mbështetur statistikisht midis suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 145. Variabëli i varur i paraqitur përmes regresionit

<i>Variables Entered/Removed^a</i>			
Model	<i>Variables Entered</i>	<i>Variables Removed</i>	<i>Method</i>
1	Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti ^b		. Enter

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të

studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues

b. All requested variables entered.

Tabela e më sipër na jep variabëlin e pavarur, suksesin e nxënësve e që përdoret për të parashikuar variabëlin e varur, niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues.

Tabela 146. Koeficienti i korrelacionit R dhe R- katrori i paraqitur përmes regresionit.

<i>Model Summary</i>				
Model	<i>R</i>	<i>R Square</i>	<i>Adjusted R Square</i>	<i>Std. Error of the Estimate</i>
1	.713 ^a	.508	.504	3.28993

a. Predictors: (Constant), Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti

Tabela më sipër paraqet koeficientin e korrelacioit R që është 0.713 dhe më me rëndësi, tabela paraqet gjithashtu edhe R- katrori që është 0.508 e kthyer në përqindje është 50.8 %, pra për 50.8% e nxënësve suksesi është domethënës për nivelin e tyre të motivimit dhe 49.2 % e ndryshimit në nivelin e motivimit të nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti shpjegohet nga faktorët tjerë.

Tabela 147. Testi ANOVA

<i>ANOVA^a</i>					
Model	<i>Sum of Squares</i>	<i>df</i>	<i>Mean Square</i>	<i>F</i>	<i>Sig.</i>

1	Regression	1265.331	1	1265.331	116.905	.000 ^b
	Residual	1223.069	113	10.824		
	Total	2488.400	114			

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues

b. Predictors: (Constant), Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti

Tabela më sipër paraqet P vlerën që është 0.00

Nëse $p < 0.05$ mund ta refuzojmë hipotezën zero, dhe në rastin tonë $0.00 < 0.05$. Hipoteza zero refuzohet, pra ekziston marrëdhënie statistikisht domedhënëse midis suksesit dhe nivelit të motivimit të nxënësve.

Tabela 148. Të dhëna statistikore për koeficientin a

<i>Coefficients^a</i>		<i>Unstandardized Coefficients</i>		<i>Standardized Coefficients</i>	<i>T</i>	<i>Sig.</i>
Model		<i>B</i>	<i>Std. Error</i>	<i>Beta</i>		
1	(Constant)	2.936	.705		4.165	.000
	Suksesi i nxënësve në pjesën e tretë të studim rasti	2.429	.225	.713	10.812	.000

a. Dependent Variable: Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues

Tabela më sipër paraqet ndërprerësin (B), ose a për koeficientin e regresionit kjo na tregon

se kur suksesi i nxënësve është 0 niveli i motivimit është 2.936 nuk është vlerë

domethënëse në jetën reale por në regresion është fillimi i analizës kur suksesi i nxënësve është 0.

2.429 tregon se sa ndikon suksesi i nxënësve për nivelin e motivimit të tyre, dmth për çdo notë rritje në suksesin e nxënësve ka 2.429 njësi rritjeje në nivelin e motivimit të nxënësve.

P vlera është 0.00

Pra vlera është e njëjtë me P vlerën e paraqitur në tabelën Anova 0.00

$0.00 < 0.05$ pra hipoteza zero nuk qëndron.

3.4.10. Testimi i pyetjes kërkimore #7

3.4.10.1 Testimi i korrelacionits midis gjinisë së nxënësve dhe nivelit të motivimit të tyre, përmes përdorimit të Testi t

Një factor tjetër, që mund të ndikojë në nivelin e motivimit të nxënësve, përveç dy

faktorëve të analizuar më sipër, moshës dhe suksesit, është edhe gjinia. Për të parë nëse

ekziston ndryshim domethënës midis mesatares së nivelit të motivimit të djemve dhe

mesatares së nivelit të motivimit të vajzave u përdor *testi t*, përkatësisht (Independent samples t test) sepse variabëli gjinia është variabël i pavarur.

Pyetja kërkimore që shtrihet në këtë rast është:

A ekziston dallim statistikisht domethënës midis mesatares së nivelit të motivimit të djemve dhe vajzave?

Hipoteza zero e cila tetsohet është:

H_0 : mesatarja e nivelit të motivimit të djemve para aplikimit të vlerësimit formues = mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave para aplikimit të vlerësimit formues. Dmth mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve nuk janë statistikisht të ndryshme.

Hipoteza alternative është:

H_a : mesatarja e nivelit të motivimit të djemve $\neq$ mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave.

Dmth mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve janë statistikisht të ndryshme.

Tabela 149. Mesatarja e nivelit të motivimi të vajzave dhe djemve para aplikimit të vlerësimit formues.

<i>Group Statistics</i>					
	Gjinia e pjesëmarrësve	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Niveli i	Vajza	63	6.4286	3.92968	.49509

motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues	Djem	52	4.6731	3.74543	.51940
--	------	----	--------	---------	--------

Nga tabela më sipër shohim se mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave 6.42 dhe mesatarja e motivimit të djemve 4.67 nuk nuk është e njëjtë. Në pjesën e parë të studim rasti, pra para aplikimit të vlerësimit formues mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave është më e lartë se mesatarja e nivelit të motivimit të djemve. Për të parë nëse ndryshimi mesatare të nivelit të motivimit të vajzave dhe djemve është statistikisht domethënës do të analizohen rezultatet e paraqitura në tabelën më poshtë.

Tabela 150. Tabela e t testit

<i>Independent Samples Test</i>									
<i>Levene's Test for Equality of Variances</i>					<i>t-test for Equality of Means</i>				
								<i>95% Confidence Interval of the Difference</i>	
		<i>F</i>	<i>Sig.</i>	<i>T</i>	<i>Df</i>	<i>Sig. (2-tailed)</i>	<i>Mean Difference</i>	<i>Std. Error Difference</i>	
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së parë të studim rasti, para aplikimit të vlerësimit formues	Equal variances assumed	.631	.429	2.43	113	.016	1.75549	.72089	.32728 3.18371
	Equal variances not assumed			2.44	110.64	.016	1.75549	.71756	.33355 3.17744

Tabela më sipër paraqet F testin 0.631 dhe p-vlerën për këtë F test që është 0.42. Për çdo $p > 0.05$ mund të supozojmë për mospërputhje të barabarta (Equal variances assumed). Në

rastin tonë, pasi që koeficienti i domethënies statistikore për këtë test është $0.429 > 0.05$ mund të supozojm për mospërputhje të barabarta dhe përdorim rezultatet e paraqitura në rreshtin e parë. Pra *t testi* është 2.43 dhe koeficienti i domethënies statistikore për këtë *t test* është $p = 0.016$

Nëse $p < 0.05$ refuzohet hipoteza zero, dhe në këtë rast $0.01 < 0.05$

Pra refuzohet hipoteza zero që mesatarja e nivelit të motivimit të djemve është e barabartë me mesataren e nivelit të motivimit të vajzave, mund të thuhet që mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve janë statistikisht të ndryshme.

Testi t (independent samples t test) u përdor edhe në pjesën e tretë të studim rastit, pra pas aplikimit të vlerësimit formues për të analizuar dallimin midis mesatareve të nivelit të motivimit të të dy gjinive. Krahasimi i rezultateve të të dy t testeve, para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues paraqesin dallimin që ekziston midis mesatareve të dy gjinive dhe nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues.

Pyetja kërkimore që shtrohet në këtë rastë është:

A ekziston dallim statistikisht domethënës midis mesatares së nivelit të motivimit të djemve dhe vajzave?

Hipoteza zero e cila tetsohet është:

H_0 : mesatarja e nivelit të motivimit të djemve pas aplikimit të vlerësimit formues = mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave pas aplikimit të vlerësimit formues. Pra mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve nuk janë statistikisht të ndryshme.

Hipoteza alternative është:

H_a : mesatarja e nivelit të motivimit të djemve $\neq$ mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave.

Pra mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve janë statistikisht të ndryshme.

Tabela 151. Mesatarja e nivelit të motivimi të vajzave dhe djemve.

<i>Group Statistics</i>					
	Gjinia e pjesëmarrësve	<i>N</i>	<i>Mean</i>	<i>Std. Deviation</i>	<i>Std. Error Mean</i>
Niveli i motivimit të nxënësve gjatë pjesës së tretë të studim rasti, pas aplikimit të vlerësimit formues	Vajza	63	10.6349	4.48762	.56539
	Djem	52	8.7885	4.73343	.65641

Nga tabela më sipër shohim se mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave 10.63 dhe mesatarja e nivelit të motivimit të djemve 8.788 nuk është e njëjtë. Pas aplikimit të vlerësimit formues, mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave është më e lartë se mesatarja e nivelit të motivimit të djemve. Për të parë nëse ndryshimi i mesatareve të nivelit të motivimit të vajzave dhe djemve është statistiki domethënës do të analizohen rezultatet e paraqitura në tabelën më poshtë.

Tabela 152. Tabela e t testit

<i>Independent Samples Test</i>										
<i>Levene's Test for Equality of Variances</i>						<i>t-test for Equality of Means</i>				
		<i>F</i>	<i>Sig.</i>	<i>T</i>	<i>df</i>	<i>Sig. (2-tailed)</i>	<i>Mean Difference</i>	<i>Std. Error Difference</i>	<i>95% Confidence Interval of the Difference</i>	
									<i>Lower</i>	<i>Upper</i>
Niveli i motivimit të nxënësve	Equal variances assumed	1.022	.314	2.14	113	.034	1.84646	.86189	.13890	3.55402
				2						

gjatë pjesës	Equal	2.13	106.51	.035	1.84646	.86633	.12896	3.56395
së tretë të	variances	1	8					
studim	not assumed							
rastit, pas								
aplikimit të								
vlerësimit								
formues								

Tabela më sipër paraqet F testin 1.02 dhe p-vlerën për këtë F test që është 0.31. Për çdo $p >$

0.05 mund të supozojmë për mospërputhje të barabarta (Equal variances assumed). Në

rastin tonë, pasi që koeficienti i domethënies statistikore për këtë F test është $1.02 > 0.05$

mund të supozojm për mospërputhje të barabarta dhe përdorim rezultatet e paraqitura në

rreshtin e parë. Pra t testi është 2.14 dhe koeficienti i domethënies statistikore për këtë t test

është $p = 0.034$

Nëse $p < 0.05$ refuzohet hipoteza zero, në këtë rast $0.034 < 0.05$

Pra refuzohet hipoteza zero që supozon se mesataret e nivelit të motivimit të nxënësve nuk

janë statistikisht të ndryshme dhe mund të thuhet që mesataret e nivelit të motivimit të

nxënësve janë statistikisht të ndryshme.

Nga krahasimi i mesatareve të nivelit të motivimit të nxënësve vërehet se mesatarja e

nivelit të motivimit të nxënësve në pjesë e parë të studim rastit janë më të ulta në krahasim

me mesataret e nivelit të motivimit të tyre në pjesën e tretë të studim rastit. Pra pas

aplikimit të vlerësimit formues, ka një rritje të nivelit të motivimit të nxënësve. Por edhe

para edhe pas aplikimit të vlerësimit formues mesataret e nivelit të motivimit të vajzave dhe

djemve janë të ndryshme.

Krahasimi i mesatareve të nivelit të motivimit të djemve dhe vajzave para dhe pas aplikimit

të vlerësimit formues, paraqet ndryshimin në mes mesatareve të nivelit të motivimit të

djemve dhe vajzave para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues. Nga tabelat e mësipërme shohim se edhe para edhe pas aplikimit të vlerësimit formues, mesatarja e nivelit të motivimit të vajzave është më e lartë se mesatarja e nivelit të motivimit të djemve.

KAPITULLI IV: PËRFUNDIMET

Përfundimet për këtë studim u realizuan në bazë të të dhënave të mbledhura me anë të metodave të ndryshme. Ndikimi i vlerësimit formues në motivimin e nxënësve për të mësuar u pa nga disa pikëpamje. Mësues, nxënës dhe prindër mbushën pyetësorët e përgatitur për këtë studim. Pasiqë mësuesit dhe nxënësit janë direkt të përfshirë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ato u intervistuan për të dhënë në mënyrë më të zgjeruar mendimin e tyre. Mbledhja e të dhënave në teren u bë edhe përmes vëzhgimeve gjatë orëve mësimore. Ndërsa për të parë ndikim e vlerësimit formues në motivim e nxënësve për të mësuar një gjuhë të huaj, në këtë rast gjuhën angleze u realizua studim rasti. Krahasimi i nivelit të motivimit të nxënësve para dhe pas aplikimit të vlerësimit formues paraqet ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve.

4.1. Përfundimet nga intervistat

4.1.1 Përfundime për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve sipas përgjigjeve të mësuesve të intervistuar

Mësuesit dhe nxënësit u përgjigjën në pyetje të ngjashme. U intervistuan 88 mësues dhe 150 nxënës. Për tu paraqitur në mënyrë sa më të qartë në përgjigjet e mësuesve dhe nxënësve u përdor kodimi i përgjigjeve. Nga përgjigjet e mësuesve në intervistat e realizuara vërejmë se shumica e mësuesve e konsiderojnë vlerësimin si një mjet shumë delikat, i cili mund të ndikojë në motivimin e nxënësve, ato thonë se nëse mësuesit do të përdorin vlerësimin me qëllim për motivimin e nxënësve ato duhet të kenë shumë kujdes sepse vlerësimi në të njëjtën kohë mund të ketë edhe ndikim pozitiv edhe ndikim negativ. Nga ana tjetër vetëm një numër i vogël i të intervistuarve nuk e shohin vlerësimin si ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në motivimin e nxënësve. Në bazë të përgjigjeve të

mësuesve nuk mund të përgjithësohet ndikimi i vlerësimit formues, nuk mund të thuhet në mënyrë të prerë se vlerësimi ndikon pozitivisht apo negativisht. Mësuesit shprehen se vlerësimi nuk ndikon te të gjithë nxënësit në të njëjtën mënyrë, ajo varet nga nxënësit, nga niveli i motivimit që ato kanë paraprakisht, poashtu edhe nga ajo se çfarë vlerësimi marrin ato. Pra, fillimisht nxënësit duhet të jenë disi të motivuar që faktorët e tjerë që mund të përdorin mësuesit të ndikojnë më shumë në motivimin e tyre, sepse nëse ato nuk do të jenë të motivuar, vlerësimi formues nuk do të ndikojë në motivimin e tyre, sepse nxënësit nuk do të paraqesin inters për vlerësimin, sepse nuk kanë kurrfarë intesimi për mësim. Vlerësimi nuk luan ndonjë rol në motivimin e nxënësve të demotivuar, ndërsa për nxënësit e tjerë që mund të jenë pak të motivuar, të motivuar apo shumë të motivuar vlerësimi mund të ndikojë edhe pozitivisht edhe negativisht varësisht se çfarë vlerësimi marrin ato, nëse marrin një vlerësimin që atyre ju pëlqen ose një notë të mirë ajo i motivon ato për të mësuar më tepër, por nga ana tjetër një vlerësim më i ulët nga ai që kanë pritur nxënësit mund ti demotivojë ato, por ndodh edhe e kundërta një notë e dobët mund të jetë shkas për ti bërë nxënësit që të punojnë më shumë për të arritur suksesin e dëshiruar. Faktorët që mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve janë të shumë dhe atë janë edhe faktor brenda shkollës edhe faktor jashtë saj. Vlerësimi formues si një nga faktorët që mund të ndikojë në motivimin e nxënësve mund të ketë edhe ndikim negativ edhe ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve gjë që varet edhe nga faktor të tjerë si: nga mënyra se si e aplikon mësuesi/ ja këtë llojë vlerësimi ashtu edhe nga mënyra se si e pranon nxënësi vlerësimin

4.1.2 Përfundime për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve sipas përgjigjeve të nxënësve të intervistuar

Për këtë studim u intervistuan 150 nxënës të cilët u përgjigjën në pesë pyetjet e intervistës.

Kodimi u përdor për ti paraqitur në mënyrë sa më të qartë analizat e përgjigjeve të nxënësve. Në bazë të përgjigjeve të nxënësve mund të përfundohet se vlerësimi ndikon në motivimin e nxënësve por nuk mund të vihet në një përfundim të prerë se vlerësimi ndikon pozitivisht ose negativisht, pra hipoteza e studimit pranohet pjesërisht. Shumica e nxënësve thonë se vlerësimi i ka bërë të ndihen edhe mirë edhe keq, disa të tjerë thonë se vlerësimi ka patur vetëm ndikim pozitiv ndërsa ka edhe nga ato, edhe pse në numër më të vogël, që nuk e konsiderojnë vlerësimin fare të rëndësishëm për motivimin e tyre. Vlerësimi nga shohët e klasës, nga ana e nxënësve shihet me një sy më pozitivë në krahasim me vlerësimin e marrë nga mësuesi/ja. Të vlerësojnë shokët e klasës është konsideruar si më e pranueshme nga nxënësit sesa të vlerësohen nga shokët e klasës dhe sidomos kur shokët e klasës që i vlerësojnë ato nuk janë të mirë në mësim. Për disa nxënës nuk ka asgjë me interes as në vlerësimin e shokëve të klasës dhe as në vlerësimin nga shokët e klasës. Edhe pse për disa nxënës nuk është me rëndësi pjesëmarrja në përcaktimin e kritereve të vlerësimit për shumicën prej tyre ajo është një kënaqësi shumë e madhe, që i bënë të rëndësishëm në klasë dhe i vendon ato përpara një përgjegjësie që duhet respektuar. Poashtu informimi me kriteret e vlerësimit para se ato të vlerësohen ndikon shumë pozitivisht te shumica e nxënësve të cilët i bënë të ndihen të sigurt në vetëvete. Ekzistojnë edhe faktorë mbrenda shkollës edhe jashtë saj që ndikojnë në motivimin e nxënësve dhe vlerësimi është një prej tyre.

Nga analizimi i intervistave të mësuesve dhe nxënësve arrihet në përfundim se, hipoteza e studimit, se vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve qëndron pjesërisht, pasi që në bazë të përgjigjeve të të intervistuarve thuhet se vlerësimi formues ndikon në motivimin e nxënësve, por nuk qëndron pjesa tjetër, pra nuk mund të thuhet se ai ndikon pozitivisht pasi që shumica e të intervistuarve thonë se vlerësimi formues mund të ndikojë edhe pozitivisht edhe negativisht në motivimin e nxënësve. Ndërsa nënhipoteze e studimit, se vlerësimi formues ka të njëjtin ndikim në motivimin e të gjithë nxënësve refuzohet, pasi që sipas të intervistuarve, vlerësimi formues mund të ketë ndikim shumë pozitiv në motivimin e disa nxënësve mirëpo nga ana tjetër ai mund të mos ketë aspak ndikim ose për më tepër mund edhe të ketë ndikim negativ në motivimin disa nxënësve të tjerë.

4.2. Përfundimet nga pyetësorët

Pyetësorët si një nga instrumentet për mbledhjen e të dhënave për këtë kërkim u plotësuan nga mësues, nxënës dhe prindër. Rezultatet nga këto pyetësor u paraqitën në tabela me anë të programit kompjuterik SPSS.

4.2.1. Përfundime për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në bazë të përgjigjeve të mësuesve në pyetësor

Pyetësorët e mësuesve u plotësuan nga 188 mësues. Të dhënat e këtyre pyetësorëve u paraqitën fillimisht në tabela që japin statistikën përshkruese. Pastaj të dhënat paraqiten në tabela të kombinuara sipas grupeve të mësuesve të klasifikuar në bazë të eksperiencës së tyre si mësues. Nga të dhënat e pyetësorëve shihet se të gjithë mësuesit u përgjigjën në të gjitha pyetjet e pyetësorit. Nga rezultatet e tabelave mund të përfundohet se shumica e mësuesit mendojnë se vlerësimi formues ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve.

4.2.1.1 Përfundime për korrelacionin midis eksperiencës në punë të mësuesve dhe opinionit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësore

Për të parë nëse ekziston një korrelacion në mes eksperiencës në punës të mësuesve dhe përgjigjeve tyre në pyetjet e pyetësorit u përdor Kendall's tau. Nga rezultatet e testeve jo parametrike Kendall's tau për pyetjet e pyetësorit të mësuesve shihet se koeficientët e korrelacionit janë numra negativ të cilët nuk ndryshojnë shumë në mes tyre, - 0.50, - 0.53, - 0.48, - 0.47, - 0.49, -0.50, - 0.44. Në mes eksperiencës në punë të mësuesve dhe përgjigjeve në të gjitha pyetjet e pyetësorit të mësuesve ekziston një korrelacion negativ që do të thotë se me rritjen e njërit variabël, zvogëlohet variabëli tjetër, dhe forca e korrelacionit është mesatare. Pra me rritjen e eksperiencës në punë të mësuesve, zvogëlohet mendimi pozitiv për pyetjet e bëra. Mësuesit me më pak vite eksperiencë pune mendojnë se vlerësimi ka shumë ndikim në motivimin e nxënësve.

4.2.2. Përfundime për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve, sipas përgjigjeve të nxënësve në pyetësor

Pyetësori i nxënësve u plotësua nga 572 nxënës. Fillimisht të dhënat u paraqitën në tabela që japin statistikën përshkuese, dhe në bazë të të dhënave të tabelave, shumica e nxënësve pohojnë se vlerësimi formues ka patur ndikim në motivimin e tyre, gjë që vërteton hipotezën kryesore.

4.2.2.1. Përfundime për korrelacionin midis gjinisë dhe opinionit të nxënësve për çështjet e trajtuara në pyetësor

Tabelat e kombinuara praqesin fillimin e analizës së të dhënave, ato tregojnë raportin në mes djemve dhe vajzave në përgjigjet e tyre për pyetjet e pyetësorit. Nga tabelat e kombinuara mund të përfundohet se nuk ka ndryshim të madhë midis përgjigjeve të nxënësve të të dy gjinive.

Mann-Whitney U test u përdor për të gjetur nëse ekziston dallim statistikisht domethënës midis mendimit të djemve dhe vajzave në përgjigjet e tyre për pyetjet e pyetësorit. Për $N_1 = 316$, $N_2 = 256$, P vlera që paraqitet për të gjitha përgjigjet e pyetësorit është më e madhe se 0.05 dmth nuk ekziston diferencë statistikisht domethënëse në mesataret e mendimit të djemve dhe vajzave për të gjitha çështjet e trajtuara në pyetjet e pyetësorit.

4.2.2.2. Përfundime për korrelacionin midis klasës dhe opinionit të nxënësve për çështjet e trajtuara në pyetësor

Në bazë të tabelave të kombinuara që praqesin fillimin e analizës së të dhënave si dhe korrelacionin midis klasës në të cilën ndodhen dhe përgjigjeve të nxënësve në pyetësor, nuk ka ndonjë ndryshim të madhë në përgjigjet e nxënësve të ndarë në grupe në bazë të klasës.

Kendall's tau u përdor për të testuar të njëjtin korrelacion, korrelacionin që ekzistonë në mes klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe përgjigjeve në pyetjet e pyetësorit, në shumicën e rasteve, në 9 nga 11 mundësit e paraqitjes së korrelacionit të klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe mendimit të tyre për çështjet e trajtuara në pyetësor, ka një korrelacion të dobët pozitiv, dhe në dy raste paraqitet korrelacion i dobët por negativ, pra me rritjen e njërit variabël zvogëlohet variabëli tjetër. Pëveç njërit rast dhe atë, korrelacionit të klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe mendimit të nxënësve për ndikimin që mund të ketë pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kritereve të vlerësimit në motivimin e nxënësve, ku $p = 0.001$, ka korrelacion statistikisht domethënës midis klasës në të cilën ndodhen nxënësit dhe mendimit të nxënësve për ndikimin që mund të ketë pjesëmarrja e nxënësve në përcaktimin e kritereve të vlerësimit në motivimin e nxënësve, në të gjitha rastët e tjera, për

të gjithë pyetjet tjera të pyetësorit, $p > 0.05$ dmth nuk ka korrelacion statistikisht domethënës.

4.2.3. Përfundime për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve sipas përgjigjeve të prindërve në pyetësor

Pyetësori i prindërv u plotësua nga 560 prindër. Nga analizimi i të dhënave të pyetësorit të prindërve, vërehet se prindërit kanë qëndruar në mënyrë neutral për çështjet e trajtuara në pyetësor. Shumica e prindërve në të gjitha pyetjet kanë parë si më të arsyeshme, nga mundësitë e dhëna për të zgjedhur, të zgjedhin: *as ndikim pozitiv as ndikim negativ*, dhe në pyetjen e tretë dhe të katërt, kanë zgjedhur mundësinë *asnjëra* nga mundësitë e trajtuara në ato pyetje. Këto përgjigje tregojnë një mospërcaktim të prindërve për të mbajtur një qëndrim pozitiv apo negativ ndaj temave të trajtuar në pyetjet e pyetësorit. Kjo gjë që mund të ndodhë ngase ato mund të mos jenë të informuar për ndikimin që mund të ketë vlerësimin më motivimin e fëmijëve të tyre ose thejstë nga dëshira e tyre për të mos anuar nga asnjëra anë. Si rrjedhojë, në bazë të pyetësorit të prindërve, hipoteza e këtij studimi, se vlerësimi formues ndikon në motivimin e nxënësve nuk qëndron, poashtu nuk qëndron as nën hipoteza që vlerësimi formues ka të njëjtin ndikim në motivimin e të gjithë nxënësve.

4.3. Përfundime për ndikimin e vlerësimit formues në motivimin e nxënësve në bazë të vizitave gjatë orëve mësimore

Për të parë nga afër aplikimin e vlerësimit në klasë si dhe ndikimin e tij në motivimin e nxënësve, u vëzhguan 21 orë mësimore. Në bazë të të dhënave të marra në orët e vëzhguara mund të përfundohet se në shumicën e orëve të vëzhguara dhe atë në 17 prej 21 orëve vlerësimi ishte pjesë e orës mësimore. Por, vlerësimi i nxënësve bëhej kryesisht gojarisht, në krahasim me fitbek-un e dhënë gojarisht, fitbeku me shkrim, vetëvlerësimi

